


Shpend Sollaku Noé:

Letërsia, plaga ime e hershme
apo një copë trung i mbërthyer
me thonj, mes vorbullash të një
lumi të harbuar

Pjesë nga libri pothuaj autobiografik
“Në klesidër rëra ka mbetur e pakët”



In Memoriam
DHIMITËR ANAGHOSTI

Nga
Josif Papagjoni
Ylli Pango

(fq. 8)

SHËNIME PËR LIBRAT

Mbi romanin *Lakimi* të Durim Taçit

ROMANI “LAKIMI”:
NJË SKICË PËR LEXIM

Nga Gazmend Krasniqi

(fq. 4)

Libri me poezi
“Në meshën e ullinjve”
i Arben Iliazit
Nga Ymer Çiraku

(fq. 6)

Gjekë Marinaj, “Paradigma e parajsës”,
poezi, “Faik Konica”

RRËFIM MBI
DASHURINË SI THEMEL
I POEZISË

Nga Shefqet Dibrani

(fq. 7)

Gani Bytyçi, “Lejleku”, roman për
fëmijë e të rinj, “Faik Konica”

Fryma e letërshkrimit për
lejlekun, simbol i lidhjes së
mërgimtarëve me atdheun


Nga Prend Buzhala

(fq. 12)

Emocionet e
një fotografi

Sprovë nga Qerim Vrioni

(fq. 11)



Sadik Bejko në shtegtimin letrar “Ad Infinitum”

Prof. dr. Bardhosh Gaçe

Libri “Ad infinitum”, i “sigluar” si një gjendje e brendshme dhe meditim e autorit
Lështë një udhëtim me hapa të ngadaltë nëpër bujtinat dhe kullat e afërta dhe
të largëta të kulturës popullore shqiptare, pasi studiuesit i pëlqen të qëndrojnë gjatë
si bujtës, të grindet me gurët e kangjellat e frëngjive, që i duken të vogla për të
parë përtej kohës reale, të hakërrehet mbi “hieroglifet” që krijohen nga vizatimet e
kumteve për vajet e gazet, për vdekjen e kreshnikëve, ai do të flasë të meditojë, të
shohë nën diell e hënë, nën tokë e mbi tokë plagë, gjëma, teshtima e kollë të thata
nëpër kohë, pse shpirti krijues lë shenjat e veta nëpër kohë, shenja që s’i zhduk apo
rropos dot qoftë dhe apokalipsi.

Tani që Inteligjenca Artificiale është e aftë të përmbledhë
me shpejtësi gjithçka, nga librat e vetëndihmës e deri
te romanet e mëdhenj, ne duhet t’i kujtojmë vetes pse
lexojmë në radhë të parë.

Çfarë ndodh nëse
askush nuk lexon

Nga Spencer Klavan

(fq. 22)

“Fitova një çmim që nuk
e desha kurrë”: Laureatja
e çmimit “Nobel”,
Annie Ernaux, i hap
zemrën Sally Rooney-t

Në një bisedë me romancieren e *Njerëz normalë*, fituesja
e nderit më të madh në botën e librave shpjegon pse nuk
ndihet më në gjendje të shkruajë.

(fq. 17)



BIBLIOTEKË

Mehmet Kraja

(fq. 16)

Boshti sillet rreth tokës

Kiki Dhimula

(fq. 9)

Dy poezi

Përktheu Armela Hysi

Istref Haxhillari

(fq. 13)

Akuarel

Petro Çerkezi

(fq. 14)

Baladë për tim vëlla

Xhevair Lleshi

(fq. 15)

Shkallët e ëndrrës

Jente Posthuma

(fq. 18)

Çfarë do të doja

të mos e mendoja

Përktheu Andreas Dushi

Arbër Selmani

(fq. 19)

Fëmija im dhe i Carlos

Thomas Stearns Eliot

(fq. 20)

Eeldrop dhe Appleplex

Përktheu Skënder Buçpapaj

Kate Chopin

(fq. 21)

Puthja

Përktheu Artemisa Kuznetsov

Arben Meksi

(fq. 23)

Karikatura e së shtunës

Shtysë për botimin e këtyre shënimeve të hershme u bë një mesazh prej mikut tim të çmuar, studiuesit të shquar, autorit të shumë librave të rëndësishëm historikë, avokatit Xhafer Sadiku. Ai më dërgoi një fotokopje të një dokumenti, firmosur më 5 shtator 1978, të gjetur në fondin 511 të Ministrisë së Arësimit. Midis spekulimeve dhe padrejtësive të rënda për të drejtat e studimit, që në ato vite shkaktuan drama, pse jo edhe tragjedi mes të rinjve të talentuar në të gjithë Shqipërinë – sidomos në rrethet Lushnje, Fier dhe Berat, por edhe në Tiranë – përmendesha edhe unë. Në të, ndërmjet shkëlqesh të tjera të Lushnjes, në krye të faqes 2 shkruhet :... Në një rast tjetër i është dhënë e drejtë studimi në degën e letërsisë ..., me mesataren 8,4 dhe ishte lënë Shpend Sallaku, me mesatare 9,8 dhe prirje në letërsi, ashtu siç vërtetohet edhe nga dokumentat përkatëse...

Në krye të këtij dokumenti të drejtuar Manush Myftiut, nga grupi i Ministrisë së Arësimit dhe Kulturës të ngritur për vërtetimin në bazë të këtyre fakteve të rënda, theksohet që në Kryeministri, gjatë gushtit të vitit 1978, kishin arritur 213 ankesa për abuzime me të drejtat e studimit për në shkollën e lartë, sidomos në rrethet e sipërpërmendura.

Ishte hera e parë që një dokument shtetëror pranonte si të vërteta abuzime të bëra në kurrizin tim por edhe të sa e sa nxënësish të shkëlqyer dhe të talentuar të marrë më qafë prej burokracisë. Ajo lloj burokracie nuk i qëndronte besnike as institucioneve superiore, siç ishte Kryeministria apo edhe Komiteti Qendror i PPSH-së. Pas këtij sinjalizimi prej avokat Sadikut, m'u desh të rishfletoj një libër timin pothuaj biografik rreth asaj periudhe, por edhe të vuaj sërishmi ato rrethana, ngjarje dhe thika pas shpine...

... Pas dy vitesh “stazhi” – punë fizike të detyruar –, (njëri në moçalin e kënetës në Ndërrenas, tjetri në të ashtuquajturën “Dambë” të Kombinatit Metalurgjik të Elbasanit – një lloj rezervuari matanë Paprit, për të derdhur helmet e metalurgjisë), prisja, si shumë të tjerë, daljen e të drejtës së studimit për në universitet. Në lutjen që shqyrtohej nga komiteti ekzekutiv ne mund të kërkonim të vazhdonim studimet e larta në tri degë. Pastaj ata vendosnin se ku do të shkoje, edhe pa i përfillur fare parapëlqimet tona. Sigurisht, parimi kryesor që ata zbatonin ishte ai i partishmërisë. Bijtë e drejtuesve komunistë ishin të parët që përfitonin. Brenda përfituesve pastaj fillonte diferencimi në bazë të peshës së prindërve në gjirin e partisë. Këto gjëra atëherë bëheshin hapur dhe unë, edhe pse do të kisha parapëlqyer degët ku e shihja veten më të aftë si juridiku, arkitektura dhe letërsia, isha i ndërgjegjshëm që dy degët e para i merrnin bijtë e nomenklaturës. Por, duke patur parasysh se kisha filluar të botoja shkrime edhe në organe kombëtare që në moshën katërmëdhjetëvjeçare, mendoja se, të paktën për gjuhë e letërsi, do të më lejonin të studioja. Nuk kisha konkurrent të nivelit tim dhe, nëse nuk e meritoja unë letërsinë, kë tjetër mund të dërgonin në atë fakultet?

Shpalljen e të drejtave të studimit në xhamllëkun e gjimnazit unë e mora vesh nga një fqinjë, po ashtu edhe verdiktin: «Kishin dalë bursat, Shpendi. Emrin tënd nuk e pashë!»

Do t'i ketë shpëtuar emri im, mendova, edhe pse parandjenjat e zeza po më mbysnin. Vrapova për tek xhamllëku. Mes mizërisë së gjimnazistëve aspirantë për në universitet, të afërmeve të tyre dhe hijëbërësve kureshtarë, duke zgjatur kokën e duke përdorur bërrylat, arrita të lexoj një herë të gjitha listat, fakultet për fakultet, duke u përqendruar sidomos në shkencat shoqërore. Emri im nuk ishte. Mbase më ka shpëtuar, mendova, mbase më kanë përfshirë në ndonjë fakultet tjetër, në ato që bijtë e tyre shpërfillin, për shembull në atë të agronomisë, apo të shkollës për oficerë, apo ... Një kockë të tillë ndoshta edhe ma kanë hedhur. Por jo, nuk ishte as atje emri im. I lexova edhe njëherë të tretë, dhe

Shpend Sollaku Noé: Letërsia, plaga ime e hershme apo një copë trung i mbërthyer me thonj, mes vorbullash të një lumi të harbuar.

*Pjesë nga libri pothuaj autobiografik
“Në klesidër rëra ka mbetur e pakët”*

rezultati që i njëjtë. Pastaj u kujtova për nja dy shokë të mi, për një shoqe klase, për një fqinjë...të gjithë nxënës të shkëlqyer. Edhe emri tyre mungonte.

I hoqa këmbët zvarrë deri tek porta e daljes nga oborri i gjimnazit. Nuk më bëhej të shkoja në shtëpi. Ktheva kokën pas për herë të fundit. Nuk munda të mos vërej cinizmin e buzëqeshjes së dikujt që kish babin në komitet, gati të më thoshte: E sheh, unë mbarova me gjashta, dhe po shkoj të studioj në Tiranë. Ty të rrofshin dhjetat, aktiviteti e botimet!

– Mos u mërzi, Shpend, provoje edhe vitin që vjen, më tha një zë ngushëllues. Ishte Jani, një minoritar grek dhe shok i mirë jashtëshkollor. Shoqërohesha me të sepse kish një humor të lindur. Në atë periudhë të zymtë ishte një dhunti e rrallë, dhe unë kisha një nevojë patologjike për të qeshur. Por atë ditë edhe Janit i vinte të qante. E ndoqa pas. Hymë tek Klubi i Ditkës, apo “Famijari”, siç

e quanin lushnjarët. Dhe që hera e parë që piva një alkol të fortë, fernet e pastaj ponxh portokalli. Qe edhe hera e parë që ndeza një cigare të ofruar nga miku im simpatik.

Pa asaj dite unë nisa të jem tjetër njeri. Kishte vdekur edhe shpresa e fundit që ata të pushtetit mund të merrnin në konsideratë zotësinë e dikujt. I kishin hedhur nëpër hislla të gjitha veprimtaritë e mia në shërbim të kolektivitetit lushnjar, pjesëmarrjen që fëmijë nëpër konkurse, festivale, estradë, teatër, koncerte, dominimin në dy seminareve kombëtarë për letërsinë e të rinjve, studimin sitematik dhe të paepur në dymbëdhjetë vjet shkollë me rezultate të shkëlqyera.

Pas asaj dite arritën edhe kohët më të vështira për mua. Fillimisht nuk hoqa dorë nga vazhdimi i kërkimit të të drejtës për të studjuar. Flitej që kishte edhe rezerva, për të kënaqur ankimet më të bujshme. Mblodha të gjithë shkrimet e botuara, dëftesat shkollore, dëshmitë e veprimtarive kryesore dhe u



nisa për në Tiranë. Të paktën të drejtën për të vazhduar për letërsi nuk mund të ma mohojnë, mendoja. Asnjë nga ata që kishin marrë të drejtën e studimit nuk kish patur të dhënat e mia. Nuk prisja rivalë më të denjë në atë lëndë.

Për ndonjë ndihmë në fushën e letërsisë, të gjithë letrarët i drejtoheshin Lidhjes së Shkrimtarëve në Tiranë. Ashtu bëra. Me dosjen nën sqetull u paraqita tek Dritëro Agolli. Ai më priti mirë, pa me vëmendje edhe materialet që kisha me vete, dhe më tha: Ke të drejtë. Nëse nuk të çojnë ty për letërsi, kë tjetër? Dhe shpejt shkroi një rekomandim për mua, drejtuar Komitetit Ekzekutiv të Lushnjes.

Unë nuk u mjaftova me kaq. Takova edhe Ismail Kadarenë. Edhe ai më dha rekomandimin e tij.

U ktheva me plot shpresë në qytetin tim. Kërkova që të nesërmen një takim me sekretaren e Komitetit Ekzekutiv të rrethit të Lushjes, që mbulonte të drejtat e studimit.


Ajo më priti me këmbët e para. Kur i thashë që kisha ardhur t'i shtoja dokumentave të mia edhe rekomandimet e Dritëroit dhe Ismailit, ajo jo vetëm që nuk pranoi t'i merrte, por edhe shtoi: E kush i njeh këta re! Mua nuk m'u durua pa i thënë: – Mirë, si shkrimtarë edhe mund të mos i njohësh, por si detyrë partie po, janë më lart se ty. Dritëroi është anëtar i Komitetit Qendror, ndërsa Ismaili zëvendës president i Frontit Demokratik, direkt pas shoqes Nexhmije.

Ajo bëri një gjest duke më treguar derën.

Të nesërmen u ktheva përsëri tek Dritëroi. I shkova në shtëpi asaj here, në Rugën e Dibrës. Hymë në studion e tij. Ai më pa të errët në fytyrë, dhe kërkoi të më largojë nga mendimet e liga. Dëgjo këto vargje më tha, janë të Robert Bërnsit. Po provoj ta shqipëroj. Dhe filloi të më recitonte diçka nga skocezi i madh. Janë përkthime të shkëlqyera, i thashë, pa u shtirur aspak. Eh, poet i madh Bërnsi, më thotë Dritëroi, pastaj shtoi: Si vajti me ata të Lushnjes? Unë ia shpjegoja shkurt sesi më kishin trajtuar edhe asaj here në Komitetin Ekzekutiv. Ashtu të priti? – më tha, pasi dëgjoji përshkrimin tim. – Atëherë po të jap një rekomandim për shokun Enver! – Jo i thashë, nuk dua t'i shkruaj atij. – Mos u bëj merak, – më tha dhe ngriti telefonin. Foli me dikë, uli receptorin dhe shtoi: – Sapo rashë dakord që të të presë një miku im në Komitetin Qendror. Quhet Petrit Shijaku. Ai do të të dëgjojë me vëmendje e do të të ndihmojë. Është sekretar i shokut Enver. Shko, dëgjomë mua, po të vë në dispozicion makinën time dhe shoferin.

Makina ish ajo Fiat Polski që mund t'ju kujtohet, ngjyre kafe apo bezhë e errët. Prej shoferit kujtoj që ishte zeshkan e fjalëpakë. Petrit Shijaku më priti në një zyrë në të cilën kalohej nga hyrja e Komitetit Qendror të Rinisë. Më dëgjoji me vëmendje dhe tha: – Shkruaji një letër të shkurtër shokut Enver. Unë u stepa. – Mos u tremb, më tha, ajo letër do më mbetet mua, më duhet që t'u bëj presion atyre të Lushnjes. Unë mbusha rreth një faqe, në një fletë të grisur prej një fletoreje nga ato me vrma majtas, dhe ia dorëzoja. Me kaq përfundoi takimi im me Petrit Shijakun.

U largova për në Lushnje si i çliruar



T'i rrëfehesh vetvetes e të tjerëve

nga ndonjë barrë. Kisha bërë gjithçka të mundur. Më tej se Enver Hoxha nuk mund të ankoheshe!

Në javët që pasuan unë i isha dorëzuar plotësisht fatit. Rrija si i mpirë, vetëm, nëpër klubet e qytetit. Lashë mustaqe dhe mjekërr, nuk më vinte të shkruaja, nuk ndiqja as muzikën, pa të cilën më parë nuk mund t'i shtyja ditët. Vazhdoja të pija alkolikë, edhe pse pa u dehur, dhe cigarja më ishte bërë e zakonshme nëpër gishta. Deri sa një ditë, kur po ktheja gotën e dytë të ponxhit tek Klubi i Ditkës, më thonë se jashtë më kërkonte vëllai im i madh, Fatmiri. Dola menjëherë. Duhej të kish ndodhur diçka e pazakontë. Dhe ashtu kish qenë vërtetë. – Më thirri zëvendëskryetari i Komitetit Ekzekutiv, Vlash Gjoka, – më thotë vëllai, – më tha që ty të ka dalë e drejta e studimit atje ku doje, për letërsi. Të kanë pranuar jashtë kritereve.

Unë s'u besoja veshëve.
– Është e vërtetë, – shtoi Fatmiri. – Tani u qetësove?

Unë ama nuk besoja. Seç kisha një tjetër parandjenjë të zezë nga e cila e kisha të vështirë të çlirohesha.

Prapaskanat e aprovimit të të drejtës time i mora vesh pak më vonë. Edhe pas ndërhyrjes së Petrit Shijakut, që kish shkruar në emër të Enver Hoxhës, shefi i arësimit dhe sekretarja e komitetit ekzekutiv kishin thënë një «Jo!» të prerë, por Vlash Gjoka ua kish prerë vullin: – Jeni të çmendur? Për Shpendin ka urdhër nga lart, vetë i Madhi!

Vetëm atëherë ata ishin detyruar të firmosnin.

Deri në dhjetor të vitit 1978 ditët e mia ishin të mbushura me udhëtime për t'u regjistruar në fakultet, kërkime programesh e dispensash. Edhe në ditën Vitin të Ri i isha vënë studimit që herët. Menjëherë pas festave fillonte sezoni i provimeve. Vitin e parë e nisa me korrespondencë, por më kishin premtuar që, nëse dilja me mesatare të mirë në vitin e parë, të tjerët mund t'i ndiqja si student i rregullt. Mesataren unë as që e diskutoja, prandaj mendova se më në fund ia kisha hedhur, çështje muajsh.

Por ndodhi ajo që nuk e prisja as unë dhe askush tjetër prej atyre që më gjendeshin pranë.

Ditën e 6 Janarit të vitit 1979, sapo u ktheva nga Tirana, hyj në shtëpi dhe djathtas, në dhomën time, shoh që ishin grumbulluar plot të afërm, midis të cilëve shquajta dajat e mi, Hajdarin dhe Zenelin. U tremba dhe kërkova të di arësyen e atij grumbullimi. Shihe këtë, më thotë me zë të prerë njëra nga motrat, duke më treguar një copë letër të daktilografiuar. Unë e lexova më një frymë. I gjithë trupi filloi të më dridhet. Duhet të paraqitesha të nesërmen, në orën dhjetë, në Degën Ushtarake të Lushnjes, për të kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak!

–Nuk mund të jetë e mundur,– i them Fatmirit, vëllait të madh.

–Me siguri ka ndonjë gabim në këtë mes,– përpiqet ai të më japë shpresë. – Nuk mund të të ngrenë ushtar, e kemi biseduar me ta. Po ashtu edhe ligji është me ty.

Kështu tha, por pashë që ishte më i shqetësuar se unë.

Të nesërmen në mëngjes Fatmiri më shoqëroi në Degën Ushtarake. Gjithë esenca e dialogut të tij me ata oficerë të akullt, konsistoi në kundërshtimin e Thirrjes, pasi po ata vetë i kishin dhënë fjalën tim vëllai që të ma shtynin një vit ushtinë, ngaqë isha edhe student. Përgjigjia e tyre qe e prerë: – E pamundur, kemi urdhër nga lart, pastaj Partia ka nevojë për një djalë të përgatitur. Shkoni direkt tek stadiumi, pas një gjysëm ore nisen kamionët ushtarakë. Nëse nuk paraqitesh,– m'u drejtuan mua,– do të të dënojmë për dezertim!


Nuk më mbeti veçse të dorëzohesha. Triumvirati i kuq i Lushnjes, parti, pushtet dhe Degë Ushtarake, ishte organizuar që, atë të drejtë studimi të rrëmbyer me thonj, të ma digjnin nëpërmjet shërbimit ushtarak.

Nuk po e zgjas sesi më ngarkuan në një nga kamionët me sponde të zinj, nuk mund të harroj që oficerët që u bënin apelin rekrutëve mbanin pallto të gjata e të errëta. Kur i pa, Fatmirit iu mbushën sytë me lotë.

- 2 -

Në një rast tjetër i është dhënë e drejta e studimit në degën e letërsisë ~~XXXXXX~~ me mesatare të notës 8.4 dhe ishte lënë Shpend Sallaku me mesatare 9.8 dhe me prirje për letërsi është shtu siç vërtetohet nga dokumentat përkatëse, ~~XXXXXXXXXX~~

Dokumenti i Ministris së Arsimit, e zmadhura, pjesa e sipërme.



Po ky dokumenti i Ministrisë së Arsimit, i plotë

Ishin oficerë të Flotës Ushtarake Detare. Kjo për mua do të thoshte: lamtumirë liri, për tre vjet të tërë. Vetë Fatmiri e kish bërë ushtinë në marinë, në kohën e tij për katër vjet. Edhe atëherë kish patur nevojë Partia për një njeri të përgatitur? Edhe atëherë rastësisht Fatmiri kish qenë i detyruar të vazhdonte universitetin pas katër vjet ushtrie? Të shtoj edhe njëzet e shtatë muajt e shërbimit ushtarak të vëllait tonë Xheladin në Maqellarë të Peshkopisë, në kufi, ne po i jepnim Partisë (atdheut?) nëntë vjet e tre muaj ushtri: më shumë se një nizam rezervistësh!

Nëntë muajt e parë të ushtisë i kalova në Shkollën e Instruksionit në Pashaliman. Do përgatitesha si radiometrist e akustik – dmth specialist për radiollokacionin e anijeve mbijuese si edhe atë të nëndetseve. Duhej të studioja shumë, ndryshe askush nuk kish për të më dhënë leje! Duhej edhe të mos humbisja shprehinë e të shkruarit. Sapo kishin thënë se ishte ndaluar të vazhdoje shkollën në ushtri, me një urdhër të posaçëm të Mehmet Shehut. Prandaj duhej ndryshuar strategji. Sjellje korrekte, studim i fortë i lëndëve ushtarake dhe fshehurazi, ato të universitetit. Po ashtu duheshin gjetur

sa më shumë pretekste për të ikur me leje. Njëri nga ato pretekste, që më bën edhe sot për të qeshur, qe një telegram i një kushëriri: Xhaferri vdiq stop varrimi nesër ora dhjetë stop. Xhaferri, siç më kujtohet, ishte qeni i Xhemal Kruijës, djalit të dajes. Kur më pyetën në komandë se çfarë e kisha të vdekurin, unë pa një e pa dy u thashë: –E kam dajë.

–Të rroni vetë, –më thanë, por unë i kisha sytë tek fletëleja që mbanin në dorë.

Truke të tilla vdekjesh apo martesash të rreme i kam përdorur shpesh gjatë ushtisë, që të mund të ndodhesha në orar ditën e provimeve. Sidoqoftë, kur ato nuk mjaftonin, më është dashur edhe të iki pa laje, duke patur mbulimin e shokëve marinarë. Ato ikje pa leje ishin të rrufeshme, vajtje-ardhje, sa jepja provimin dhe kthehesha menjëherë pa kthyer dot në shtëpi për të parë të mitë. Po as kjo lloj strategjie nuk mjaftonte. Nuk i mbuloja dot të gjitha provimet. Prandaj u detyrova të “shpik” një truk tjetër. Menjëherë pasi jepja një provim, i kërkoja sekretarisë proces-verbalet për të dhënë provimet e sezonit të ardhshëm. Në fakt hyja menjëherë tek provimi tjetër. Dhe me këtë lloj truku jepja shpesh edhe dy apo tre provime në ditë. Sipas radhës së provimeve, unë mund t'i jepja

ato në të gjitha filialet. Kam dhënë shumicën e tyre në Elbasan, më ka ndodhur edhe të jap një në Berat: Drejtshkrimin e Gjuhës Shqipe. Një ditë ma kuptuan “djallëzinë”: Ishte profesori Mustafa Karapinjalli ai që ma zbuloi.

Data 26.06.1979. Atë ditë, sipas radhës, u paraqita në provimet e Historisë së PPSH-së (me profesorët Kolë Tollumi e Mihal Naska, mora nëntë), në atë të Teorisë së letërsisë (me Musa Vyskhën e Qamil Buxhelin, ku mora dhjetë) dhe në atë të Leksikologjisë e Fonetikës (me Mustafa Karapinjallin e Rolanda Kapajn, ku mora tetë).

Kur profesor Karapinjalli shkruajti datën e dhënies së provimit në librezë, vuri re se po atë ditë kisha dhënë edhe dy provime të tjera. – I ke dhënë sot edhe këta të dy? – më pyeti. – Po, i thashë, por i kam të rregullta proces-verbalet. – Ah, e dinë ata të drejtorisë këtë gjë! Sidoqoftë, ti qofsh! Të lumtë! Kështu filloi njohja me të mirin Mustafa, i cili më vonë u bë kunati im.

Në fakt duhet t'ia dija për nder të madh kryesekretares së universitetit, Bardha Barçit, që më furnizonte me

(Vijon në faqen 5)

Emërtimi i lëndës	Emri e mbiemri i pedagogut	e dhënies	Nota	Firma
Historia e P.P.S.H.	Kolë Tollumi, M. Naska	26.6.79	9 (dhjetë)	M. Naska
e letërsisë	M. Vyskhën, Q. Buxhel	26.6.79	10 (dhjetë)	Q. Buxhel
Teoria e letërsisë	M. Vyskhën, Q. Buxhel	26.6.79	8 (tetë)	Q. Buxhel
Fonetikë e leksikologji	T. Tollumi, M. Naska	27.8.79	8 (tetë)	M. Naska
Letërsia e tregut	B. Barçit	22.9.79	7 (shtatë)	B. Barçit
Praktikum p.f.	Q. Buxhel, Karapinjalli	4.1.80	8 (tetë)	Q. Buxhel

Libreza e notave

Hyrje

Ky tekst është një përpjekje për të kërkuar rrugën e leximit të romanit *Lakimi* të Durim Taçit jo vetëm si një rrëfim letrar, por edhe si një akt estetik dhe ideologjik që fton lexuesin kritik në dialog të thellë. Duke ndjekur gjurmët e një protagonisteje që refuzon të shkruajë dhe zgjedh të interpretojë, kjo analizë synon të hedhë dritë mbi mënyrën se si pushteti, gjuha dhe trupi ndërthuren në një betejë të heshtur për autorësi. Më shumë se një analizë strukturore, ky shkrim rihap pyetjen mbi atë që e bën një zë të dëgjueshëm: dhe një rrëfim të drejtë.

Ky tekst synon të mbrojë idenë se romani *Lakimi* i Durim Taçit është një përpjekje e guximshme për të rikthyer dinjitetin e formës së romanit kompleks dhe polifonik, duke ndërthurrur në mënyrë organike elemente të thrillerit psikologjik, dramës filozofike dhe romanit feminist. Se ai kërkon jo vetëm vëmendjen e lexuesit, por edhe angazhimin e tij të thellë interpretativ. Se romani nuk ofron një botë të ndërtuar sipas rregullave tradicionale narrative; përkundrazi, ai e zhyt lexuesin në një realitet të pasigurt, të shumëfishtë dhe shpesh të turbullt, ku e vetmja qartësi vjen përmes dyshimit dhe përplasjes së zërave.

I. Shkrimi si pushtet

Në thelb të romanit qëndron një kritikë e thellë ndaj shkrimit si instrument pushteti: një ide me rrënjë të forta në mendimin feminist dhe epistemologjik. Elira, protagoniste dhe arkeologe, refuzon të shkruajë. Ky refuzim nuk është thjesht një rebelim personal, por një akt simbolik rezistence ndaj një sistemi dijesor patriarkal që ka përjashtuar dhe shtypur zërin e gruas përmes kontrollit mbi gjuhën dhe rrëfimin. Në një botë ku pushteti është strukturuar rreth aktit të të shkruarit, refuzimi i Elirës për të shkruar përbën një mosbindje të thellë dhe të qëllimshme.

Në një nga momentet më të ngarkuara simbolikisht të romanit, gjatë një kumtese, Elira shpalos një ide tronditëse mbi historinë e dijes, e cila bëhet thelbi i romanit në fjalë: ajo argumenton se alfabeti, si sistem shkrimi, ka kontribuar në zhvendosjen nga kultura e oralitetit matriarkal në një sistem hierarkik dhe patriarkal. Leonard Shlain, në librin e tij *The Alphabet Versus the Goddess*, artikulon një tezë të ngjashme, sipas së cilës

Mbi romanin *Lakimi* të Durim TaçitROMANI “LAKIMI”:
NJË SKICË PËR LEXIM

Nga Gazmend Krasniqi

shkrimi alfabetik promovon mënyra lineare, logjike dhe mashkullore të të menduarit, duke dëmtuar perceptimet intuitive, holistike dhe femërore. Sipas tij, shpikja e alfabetit ka ndikuar negativisht në statusin e grave në shoqëri duke përfunduar mendimin logjik, linear dhe patriarkal në dëm të mendimit vizual, intuitiv dhe femëror. (Kjo ide përfundohet nga teoritë e Goettner-Abendroth dhe mendimit epistemik të Spivak, të cilat e lexojnë historinë jo vetëm si një rrjedhë ngjarjesh politike e sociale, por si një rrëfim të kapur nga një formë mendësie që ka përjashtuar gratë, trupin, ndjeshmërinë dhe oralitetin). Elira, në këtë kontekst, nuk është vetëm një personazh në konflikt me burrat në jetën e saj; ajo është një figurë rezistence kundër një kulture të tërë që ka ndërtuar dijen dhe gjuhën mbi përjashtimin e saj.

Si vepron ajo? Nuk shkruan, por interpreton. Interpretimi nuk është një akt më pak i fuqishëm se shkrimi. Trupi i saj bëhet medium, zëri i saj mjet komunikimi. Ajo mishëron një performancë politike dhe epistemike në frymën e teorive të Hélène Cixous, e cila fton gratë të shkruajnë me trupin e tyre (écriture féminine), dhe Judith Butler, sipas së cilës identiteti gjinor është performancë sociale, jo thelb i natyrshëm.

Elira nuk është viktimë pasive e një rrëfimi të huaj, por aktore që përpiqet të rimarrë autorësinë e jetës së saj, jo përmes fjalëve të shkruara, por përmes aktit trupor dhe kuptimit që sfidon strukturat tradicionale të dijes.

II. Narrativa si strukturë kontrolli

Sigurisht, e gjithë sfida e mësipërme jepet përmes gjuhës së romanit. Romani operon në disa nivele rrëfimi dhe luan me kufijtë mes realitetit dhe trillimit. Elira është një personazh brenda një rrëfimi që nuk e ka shkruar vetë – një grua e cila është në mes të rrëfimeve të burrit të saj Arbenit, dashnorit Roberto dhe historisë kulturore që e rrethon. Ajo nuk është vetëm e “përfshirë” në histori, por aktivisht “përshkruar” nga të tjerët.

Roberto e kolonizon përvojën e Elirës përmes shkrimit. Ai e përkthen jetën e Elirës në metaforë – një formë e sofistikuar sundimi. Elira nuk ka të drejtë të ekzistojë në versionin e vet të historisë: ajo duhet të kalojë përmes filtrit të rrëfimit mashkullor. Ky fenomen përkon me atë që Gayatri Spivak e ka quajtur “dhunë epistemike”: përjashtimi i një zëri nga historia përmes mënyrës se si ajo histori tregohet.



Metafiksioni që përdor romani – ndërthurja e rrëfimeve të ndërprera, kujtimeve fragmentare, komunikimeve digjitale dhe ndërhyrjeve të një zëri autorial të padukshëm – krijon një tekst të hapur, ku lexuesi duhet të rindërtojë tërësinë përmes copëzave. Por kjo nuk është vetëm një teknikë narrative; është një deklaratë estetike dhe politike: nuk ekziston një e vërtetë unike, por shumë rrëfime që konkurrojnë për të dominuar kuptimin.

III. Gjinia dhe dhuna narrative

Në romanin *Lakimi* marrëdhëniet gjinore nuk trajtohen vetëm si çështje personale, por si struktura pushteti. Arbeni, burri i Elirës, përfaqëson autoritetin patriarkal klasik: i heshtur, por gjithmonë i pranishëm, konservator dhe kërcënues kur sfidohet. Roberto, nga ana tjetër, përfaqëson pushtetin më të sofistikuar: ai është i kulturuar, i ndjeshëm, por kontrollues përmes gjuhës, narrativës dhe artit.

Në këtë aspekt, romani reflekton qartë frymën foucault-iane: pushteti nuk është vetëm represiv, por edhe disiplinues. Ai vepron përmes normave, përcaktimit të së vërtetës dhe rrëfimit. Elira përjashtohet nga autorësia e historisë, por mbetet objekt i saj: një trup i përshkruar, interpretuar, klasifikuar, por kurrë me zotërim të plotë të zërit të vet. Dhuna është e natyralizuar përmes rrëfimeve që duken të pafajshme.

IV. Fragmentariteti si estetikë dhe strategji rezistence

Struktura fragmentare dhe e shpërbërë e romanit nuk është thjesht zgjedhje stilistike, por një gjest i vetëdijshëm kundër rrëfimit linear dhe koherent patriarkal, sipas idesë së hedhur më lart. Fragmentet pasqyrojnë jo vetëm pasigurinë emocionale të Elirës, por edhe natyrën e shpërbërë të kujtesës, gjinisë dhe subjektivitetit, siç e shohin vëzhgimet e sotme.

Elira është një figurë që lakon: jo vetëm gjuhën, por edhe identitetin, trupin dhe historinë. *Lakimi* është një gramatikë e subjektivitetit (personazhit) që shmang rregullin dhe skematizimin. Ky lakim është një mënyrë për të mos u reduktuar nga rrëfimi i tjetrit: një mënyrë për të thënë “jo” përmes zhvendosjes, jo përballjes së drejtpërdrejtë.

Stili i Taçit është i ngjeshur, herë-herë i errët, i pasur me imazhe shqisore dhe krahasime të ngarkuara, me tonalitete që lëviz ndërmjet poezisë dhe groteskut. Kjo përkon me fragmentaritetin tematik të romanit dhe përforcon atmosferën e një

Nga autori fitues i Çmimit Kombëtar në Letërsi 2021

DURIM TAÇI

LAKIMI

roman



bote të papërmbledhur në një zë të vetëm.

Gjuha e romanit është ironike, inteligjente, herë lirike dhe herë e mprehtë si thikë, duke përzier gjuhën narrative me atë akademike. Një mjet struktural modernist për t’u shënuar është monologu i brendshëm, i cili nxjerr krye që në paragrafët e parë të romanit, duke përcaktuar karakterin epistemologjik: pra cilat janë natyra, burimi dhe kufijtë e njohjes. Taçi është më se solid në përdorimin e kësaj teknike narrative.

V. Personazhi i Elirës dhe figura e burrave

Elira, një personazh i thellë, i përçarë, por me vetëdije për konfliktet e veta, është një grua që kërkon të kuptojë jo vetëm veten, por edhe mënyrën se si bota e ka ndërtuar si “grua”. Arkeologe, intelektuale, një grua në krizë identiteti dhe martesor, mes një të kaluare patriarkale dhe një të tashme, ajo kërkon pavarësi dhe kuptim. Refuzon të shkruajë (akt rebelimi simbolik), dhe komunikon me zë, duke qëndruar në oralitetin e kulturave matriarkale të hershme. Në rrugën e saj emocionale dhe erotike, ajo lëviz mes marrëdhënieve me Robertson dhe Bitorin, duke treguar lirshmërinë dhe kompleksitetin e ndjenjave të saj. Në këtë mënyrë, Elira është një figurë feministe që rishkruan - ironikisht pa shkrim - historinë personale dhe kolektive të gruas. Ajo nuk është as heroinë, as viktimë, por një subjekt që lëviz në kufijtë e njohjes dhe refuzon të përmbahet në një rol të vetëm.

Marrëdhëniet e saj me Arbenin dhe Robertson janë përballje me forma të ndryshme të përjashtimit. Arbeni, burri i përditshëm, në heshtje të gjatë, shfaqet i dhunshëm dhe kërcënuet në momente krize. Ai mishëron burrin patriarkal që është i padukshëm, por frikësues. Roberto, i butë dhe krijues, është një pushtues në formën e tij më kulturore dhe narrative. Ai hyn në jetën e Elirës përmes shkrimit dhe në emër të dashurisë manipulon rrëfimin e saj, duke e shndërruar në personazh dhe mohuar autorësinë e saj mbi vetërrëfimin.

Në vend të përfundimit

Lakimi është më shumë se një rrëfim mbi një grua në krizë: është një reflektim letrar dhe filozofik mbi pushtetin e shkrimit, mbi mënyrën se si përkufizohet e vërteta dhe kush ka të drejtë ta thotë atë. Në këtë roman, shkrimi është jo vetëm akt krijimi, por edhe mjet kontrolli mbi realitetin.

Përballë kësaj, Elira kërkon një mënyrë tjetër për të qenë: jo përmes shkrimit, por përmes interpretimit, përmes trupit, përmes zërit që nuk kërkon të shkruhet, por të dëgjohet.

Romani i Durim Taçit sfidon format tradicionale të rrëfimit dhe fton lexuesin në një përvojë ku qartësia nuk është e menjëhershme, por kërkohet reflektim dhe bashkëpjesëmarrje. *Lakimi* është një kontribut i rëndësishëm në letërsinë e sotme shqipe: një roman që flet jo vetëm mendjes, por edhe ndjeshmërisë, jo vetëm si estetikë, por si akt kritik ndaj mënyrës se si ndërtojmë botën përmes fjalëve.

Në thelb, ky është një roman për të drejtën për të rrëfyer vetveten: një të drejtë që nuk i është dhënë Elirës, por që ajo përpiqet ta rimarrë, jo me mjete tradicionale, por përmes një zëri intuitiv, kritik dhe tronditës. Në këtë përpjekje, lexuesi ftohet të bëhet jo vetëm dëshmitar, por edhe pjesëmarrës në dekonstruktimin e një kulture rrëfimi të dhunshme dhe përjashtuese.

(Vijon nga faqja 3)

verbalet e duhura, duke më kriuar, pa e ditur, mundësinë të jepja sa më shumë provime kur mundesha dhe të rekuperoja datat e humbura nga pamundësia për t’u shkëputur nga Pashalimani. Në fund të fundit shkoja shumë i përgatitur dhe notat ishin të gjitha të vërteta. Në përgjithësi shumë të mira. Edhe në ditët kur jepja dy apo tre provime njëherësh. Ndodhte edhe që hiqja dorë nga dhjeta, prej nxitimit në dhënien e një provimi, kur, ndërsa jepja njërin, mezi prisja të hyja tek tjetri. Një nga ato raste tipike ishte data 31.03.1979. U ngrita të përgjigjesha i pari në provimin e Hyrjes në Gjuhësi, pak minuta pasi kisha hyrë në sallë. Nxitova të mbaroja punë sa më shpejt. Pas atij provimi doja të hyja patjetër të jepja Pedagogjinë. Në katedër ishin Sali Tabaku dhe Rolanda Kapaj. Pas përgjigjes, profesor Tabaku më tha: – Nëse më thua edhe një sand’hi, dhjetën e kë të merituar. Atëherë, mendova, nëntën e kam në xhep. Prandaj, pa një e pa dy, iu përgjigja: – Nuk më kujtohet. Ata firmosën nëntën në librezë dhe unë fluturova tek dera. Atje u ndala për një sekondë dhe u dhashë shembuj për sand’hinë. – Gjynah, tha Tabaku, mund të kishe marrë dhjetën. Por unë nxitova të hyja tek salla ku jepej Pedagogjia. Iu përgjigja profesorëve Tomor Araniti dhe Reshit Koburja i qetë dhe regjistrova edhe atje një tetë të çmuar në librezën e notave.

Kur mbarova shkollën e Pashalimanit, më kishin caktuar në nëndetësen numër katër. Na kishin shpënë shpesh atje, për t’u ambientuar. Në atë kohë ajo ishte duke bërë kallumë, siç i thoshin pastrimit të ndryshkut në pjesën e poshtëme, atë më të ndryshkur prej kripës, pra kallumës. Nuk po zgjatëm seç hiqnin marinarët e shkretë, sesi u sëmurej lëkura nga ndryshqet, por nga ajo periudhë më kanë mbetur në mendje dy gjëra që nuk i kam harruar ende: dëshira ime e çmendur për të mos përfunduar në atë nëndetëse dhe xhirimi i filmit “Ballë për ballë”.

Xhirimi i atij filmi, sipas romanit të Ismail Kadaresë “Dimri i madh”, qe vërtetë një mbushje me oksigjen për ne që nuk po ambientoheshim dot me jetën e kapanoneve të Shkollës së Instruksionit. Shumë prej nesh i morën si figurantë për të mbushur radhët e togave të marinarëve që ecnin me hap rreshtor, të vendosur për t’u përballuar me socialimperialistët sovjetikë në bazën e nëndetsve të Pashalimanit. Deri sa mbaruan xhirimet, u prish rregulli normal i stërvitjes, dhe kjo qe një tjetër dhuratë nga qielli. Muri rrethues i shkollës u plotësua me statuja të sjella, siç na thanë, nga Apollonia. Për ne figurantët prunë uniforma sovjetike, të një lloj stofi super, me kopsa mjaft të bukura. Në mes të fushës së futbollit u ngrit një kodër e vogël me dërrasa të mbërthyer mbi trarë druri. Sipër dërrasave vunë pllaka bari dhe, në kulmin e sopit, vunë një varr: Varri i Pashait. Ç’mбай mend nga ai xhirim i bekuar njëzëri nga rekrutët? Aktorin



Arben Imami që zinte hundën me dorë nga era e qelbur e çorapeve të palara, kur iu desh të flinte në njërin nga kapanonet e ushtrisë. Po ashtu mbaj mend që Stavri Shkurtit herë pas here i ngecte këmba tek të çarat e kodrës prej dërrase. Gjithashtu kujtoj mundimin e oficerëve dhe të regjisë në ndërrimin e numrave të nëndetëseve dhe në rreshtimin e tyre. Katër ishin ato të shkretat, ata donin t’i bënin të dukeshin shumë. Prandaj ndërronin numrat dhe i montonin nëpër studio sikur ishin më tepër. Po ashtu filmoheshin disa herë katërat, dragaminat etj. Ishte një film propagandistik që duhej të dëshmonte forcën e ushtrisë tonë.

Ç’ishte njëherazi për të qeshur e për të qarë? Vjedhja e kopsave të bukura të uniformave sovjetike nga figurantët marinarë, mu në mes të xhirimit të filmit. Regjizorët Shkëlqim Çashku dhe Piro Milkani u bënë si të çmendur. Xhirimet u ndërpreën deri sa në Ndërmarrjen Artistike “Migjeni” u riprodhuan përafërsisht gjithë ato kopsa që ishin vjedhur. Mua më vunë disa herë si figurant. Një herë isha roje me kallash mbi një karakoll. Në fakt, poshtë, ai karakoll ishte dyqan që shiste ëmbëlsira. Gjatë xhirimit unë haja kuleçë pesëlekësh dhe, kur mbllaçitesha, i ktheja shpinën kamerës. Më kishin zgjedhur edhe në skenat e Llogarasë, afër Kadri Roshit, kisha edhe ndonjë batutë. Për tre ditë rresht në Qafë pati mjegulla e nuk mund të xhirohej. Ditën e tretë bëri diell. Por lozte edhe Lushnja në Vlorë. Unë hoqa dorë prej xhirimit, për të parë ndeshjen. Dhe i thashë ndihmës-regjizorit që nuk vij. – Po pse mor bir, – më tha Kadriu, me të cilin i kishim gati skenat, pse e humbet këtë shans! – Ashtu kot, i thashë.

Atë vit në Tiranë festohej 35 vjetori i Çlirimit të Atdheut. Hoxha pretendonte një paradë madhështore. Më kishin zgjedhur edhe mua me marinarët që do parakalonin para udhëheqjes. Nuk doja të shkoja në atë paradë. E para sepse e urreja, e dyta, sepse mund të humbisja shumë data provimesh. Ky rrezik ishte dhe po të më mbanin të shërbeja në nëndetëse. Njëherë për njëherë duhet t’i shmangesha paradës. Dhe mendova ta bëj në këtë mënyrë: Duke mos qenë “i denjë”. Prishja rreshtin, ecja keq, nuk e shtrija mirë këmbën, por ata nuk po më skartonin akoma. Nisa edhe të tallesha me shokët e kuadratit, por ata më mbanin akoma; po ashtu mbetesh edhe kontigjent i nëndetësës “Katër”. Në njërin nga netët e shërbimit, një nga ato netët e frikshme, zbraz një karikator të tërë kundër një hijeje që nuk iu përgjigj thirrjes time «Ndal kush kalon!». Kishte qenë një kalë që kulloste për qejf të vet afër depos së silurave!

Kaq u desh për të mos qenë i denjë as për në paradë, as për nëndetëse. Por rashë nga shiu në breshër. Pë të më disiplinuar më transferuan në Sazan!

Ishulli i Sazanit, që në vështrimin e parë, më la përshtypjen e një vendi internimi. Ditën e parë, pasi mora vesh që do të isha efektiv i

njërës prej dragaminave të vogla, gjeta kohën të ngjitesha në kodrën në të djathtë të bazës së marinës. Kërkova të orientohej. Për shkak të mjegullës, mora me mend ku duhej të binte Vlorë, ku Karaburun. Kusuri ishte vetëm ujë, nga të gjitha anët. Bobo, i thashë vetes, kush i shtyn gjallë njëzet e shtatë muaj në këtë humbëtitirë. Sepse, sensacioni i parë që provova, ishte pikërisht ai i humbjes së jetës në mes të atyre shkëmbinjve të egër. Mendimi që, atje as koka dhe as liria nuk vlente asnjë dyshkë, m’u përforcua më vonë nga vetëvrasjet, nga gjyqet në kinemanë e ishullit, apo edhe në Vlorë, për përdhunime rekrutësh, për vjedhjen e uniformës të ndonjë oficeri dhe largimin me të pa leje nga ishulli, për rrahje kolektive mes ushtarësh ose marinarësh apo gjëmash të tjera, në një përqindje shumë më të lartë sesa në Tokën e Madhe, siç quhej rëndom Shqipëria matanë detit.

Sensacioni i dytë, i menjëhershëm, që se, prej ishullit, nuk mund të largohesha dot pa leje, ishte e pamundur, kështuqë addio provime të univesitetit. Do të përpiqesha, si edhe më parë, t’i “martoja” apo t’i “vdisja” të gjithë të afërmit, apo qentë e macet, nga e para, siç kisha bërë në Pashaliman. Në krahasim me bazën e nëndetëseve, sidoqoftë, mbylleshin të gjitha mundësitë që dikush mund të vinte e të më sillte literaturën për të studiuar. Atje ma kishin zgjidhur problemin nëna ime dhe hallë Xhema, por ishulli nuk ishte si postbloku i Pashait, pak më tej Orikumit.

Në Sazan i provova shumicën e anijeve, sidomos për ndëshkimet e shumta që më akordonin; provova edhe hapjen e tuneleve, dhe, sidomos, shërbimin e gjatë në planshet, dymbëdhjetë orë në çdo njëzetekatërorësh.

Koha për të studiuar reduktohej në minimum. Por unë nuk u dorëzoja. Lexoja në dhjetë minutëshat e pushimeve të pakta, pastaj edhe në shërbim, me një sy tek libri poshtë tavolinës dhe tjetrin që përgjonte se mos afrohej ndonjë oficer apo ushtar llafazan. Njëkohësisht, sapo më jepej rasti, pa rënë në sy, shkruaja vargje e mbaja shënime.

Fakt është që, kur isha në vitin e tretë të ushtrisë, unë i kisha shlyer të gjitha provimet e universitetit dhe më mbetej vetëm diploma. Kisha arritur edhe në Sazan të siguroja fletëlejet, me të gjitha llojet e trukeve, kisha arritur edhe të ikja pa leje e të mos ndëshkohesha, pasi nuk arrinin të më zinin në flagrancë.

Më në fund, fare e papritur, qe ardhja në Sazan i një njoftimi të pabesueshëm. Sipas rregullave të atëhershme, pasi kisha mbaruar të gjitha provimet, unë duhet të bëja stazhin në një shkollë afër vendit ku banoja. Sekretaria, pa u thelluar mirë ia kishte nisur shkollës së Sazanit. Sigurisht që atje nuk më lejuan. Stazhin unë kërkova ta bëj porsa u lirova në Lushnje, në janarin e vitit 1982. Kur u paraqita në seksionin e arësimit të Lushnjes për këtë gjë, ata mbetën të shtangur. Kujtuan se e kisha djegur të drejtën e studimit, të zhvatur nga Tirana, por asnjëherë me bekimin e tyre!

Nuk po e zgjat shumë me faktet pas vitit 1982, pasi ato janë pasqyruar gjerësisht si në shkrimet e mia, në intervistat e dhëna prej meje, apo dhe në artikujt apo vlerësimet e të tjerëve për mua. Pengu më i madh i periudhës së ushtrisë? Që pjesa më e madhe e krijimeve të atyre viteve, përfshirë këtu edhe materiale të miat të mëvonshme, kanë humbur gjatë vitit të çmendur shqiptar 1997, kur shtëpia ime në Lushnje ish bërë tabelë qitjeje për kallashnikovë dhe dorëshkrimet e mia qenë zhdukur!

M’u desh të përshkruaj vetëm një përqindje të vogël të vuajtjeve që iu injektuan brezit tim: me artistë që i shtynë drejt vetëshkatërrimit, matematicienë të lindur të dërguar në Shkollën e Bashkuar për oficerë, djem hiper të aftë që iu desh të braktisnin vendin për të mos përfunduar burgjeve. Prej ngjarjeve dramatiko-tragjike të përshkruara më sipër lindën mekanizmat që vunë në lëvizje strukturat e romanit tim “Filius hostis ose i biri i armikut” të botuar vitet e fundit në Itali.



Pas disa disa botimeve të viteve më parë të disa librave me poezi, me drama (disa prej të cilave janë vënë në skenë nga trupa të ndryshme tetarore), autori i tyre Arben Iliazi, për një kohë të gjatë nuk u duk sërish me botime të tjera në fushë të krijimtarisë letrare, ndonëse ai dëshmonte për lexuesin e kohës se ishte një talent me të ardhme. Më pas, vijnë vite kur firma e tij ndeshet dendur në shumë shkrime publicistike të gazetave të njohura të kohës, ku ai punoi prej shumë vitesh, disa herë dhe si kryeredaktor. Por në kohët më të fundit, nga pena e tij janë botuar radhazi disa përmbledhje me poezi si “Kujt qajnë”, dy romane grotesko-satirik “Manekinët”, “Vezullimet e Ferrparajsës”. Në shkrime dhe intervista të tij, ai pohon se ka të përgatitura për botim disa libra të tjerë me poezi e drama.

Përmbledhje më e re me poezi, titullohet me një metaforë të gjetur dhe domethënëse: “Në meshën e ullinjve”. Dihet se në besimin e krishterë, mesha është shërbesa themelore e kishës, ku evokohet në mënyrë ceremoniale sakrifica e Birit të Perëndisë. Që poeti ynë i parë, Pjetër Bogdani, këtu e katër shekuj më parë, do ta skaliste aq mjeshtërisht me metaforë antologjike këtë sakrificë biblike: “*Nji bir të vetemë, qi Ama pat për mall.../Se Dvekuni ja kthej.../ Me Diell veshun`, e mbathunë me Hanë*”.

Poeti i këtij libri të sapobotuar, arrin që ta transferojë simbolikisht këtë “meshë” me kuptimësi qartazi humaniste, në “katedralen” e heshtur e paqësore të gjelbërimit të ullinjve. Me kursorat e tyre shpaluar drejt lartësive të qiellit. Si lutje e përhirshme, fiksuar ngultazi drejt përmasash e hapësirash kozmike.

Në vend të qirinjeve, edhe në këtë “meshë” vargjesh drithëronjëse për nga emocionet që ato ngjallin, nuk mungojnë të ndizen si flakëza të vogla kujtimet e mallshme për fate njerëzish, të cilët, mbeten përherë të endur në shtigjet dhe në udhëkryqet e pafund të jetës. Kjo u sjell atyre sfida e privacione, porse në këtë shtegtim të pandalur, ata shtyhen dhe ndihen se dinë që ta kërkojnë fatin drejt realizimit të endërrës së tyre. Prandaj jo rastësisht, ndeshen në poezi stilema vargjesh të tilla si p.sh:

“Të isha gur
Do rrija në mur kështjelle
Të isha lule
Do çelja në rrugë rrufeje...”

Prania e dekorit të ullinjve, ndeshur dendur në vargjet e kësaj poezie, nuk mbetet thjesht një peizazh i ardhur prej sentimenteve të vendlindjes joniane të autorit. Përtej një shënjimi, që nuk duhet kuptuar në funksion doemos adresues, prania e ullinjve, herë e drejtpërdrejt apo herë e nënkuptuar, përcaktohet si ADN-ja e kësaj poezie. Pikërisht në shpalosjen e frymës së paqtë, që ajo e mbart si mesazhin e saj themelor dhe që synon ta përcjellë natyrshëm për te lexuesi..

Si një poezi që prirret të projektojë artistikisht vlerat esenciale të njeriut, ndërkaq, ajo nuk mbetet në caqet e ligjërimeve patetike për shpalosjen e rrugëtimeve të gjata të tij. Brenda gjuhës së poezisë, këtu transmetohen këndvështrime të mprehta konceptuale, ashtu sikundër synojnë poetët, për të qënë njëherazi “magjistarë” të thurjes

LIBRI ME POEZI “NË MESHËN E ULLINJVE” I ARBEN ILIAZIT

Nga Ymer Çiraku

së bukurive të fjalës, por edhe përçues të ideve misionare..

Heroi lirik në këtë poezi, është vizatuar në një endje të pandalur në kërkimin e një limani sublim. Që duket se ai nuk e gjen dot kurrë atë. Sado që e kërkon ngultazi, nëpër shumë përpjekje e travaje drobitëse. Dhe kjo, më shumë se trishtim e pezm, duket se i sjell atij ngazëllim dhe forcë për të mos u ndalur së kërkuari atë liman, sa real aq dhe imagjinat për të. Sa të arritshëm, aq dhe për të mos u gjetur dot kurrë. Pra, ai gjithsesi i bindet urdhërit të tij, që të mos ndalet. Ashtu siç nuk ndalen valët e detit për të gdhendur shkëmbinjtë e brigjeve, gjelbërimi vërshues i ullinjve - derdhur etshëm në rrafshina e kodra. Siç nuk ndalet kujtesa e kalvareve të njeriut, për të ndërtuar dhe dashuruar jetën. Dhe këtë shtegtim të pandalur, është gati që ta ‘paguajë’ edhe me plagët e humbjeve.

Mos më prisni në rrugët e rrahura,
ku era shfleton të shkuarën,
pa lënë asnjë shenjë
vezullimi.

Jam duke shijuar lirinë,
i llastuar nga humbjet,
që lënë plagë të freskëta
harrimi...

(“Mos më prisni”)

Në këtë poezi, është arritur që të shpaloset një botë komplekse dhe jo lineare për nga larmia e motiveve, e gjendjeve dhe e situatave të pasqyruara e të përjetuara. Kjo krijon për pasojë, një panoramë poetike mozaikale, çka i sjell librit strukturë polifonike, ku ndërthurren artistikisht regjistra të larmishëm, nga aspekti shprehës dhe stilistik.

Pikërisht në këtë konceptualitet artistik polifonik të librit, brenda sfondit të metaforës frekvente të “përjetimeve të paqta të ullinjve”, nuk mungojnë edhe momentet, që ata “ullinj të shohin endërra me aroma malli e dhimbjeje...” Këtu nuk synohet që të bëhen traktate historie, morali apo filozofije. Sepse poezia, është e vetmjaftueshme si art i fjalës. Dihet se ajo nuk mund që t`i flasë imediatisht veçse një kohe dhe një hapësire. Do të mbetej kështu mjaft i



reduktuar misioni i saj. Pra, poezia nuk mund që të murosset kurrësi brenda caqeve të atyre “kronikave ditore”. Ato do të ishin korniza tepër të ngushta për hapësirat që poezia zotëron dhe kërkon të depërtojë drejt hapësirave të pafundme dhe të gjithkohshme.

Dhe pastaj kuptohet, që në këto dimensione të epërme letrare, mund që ta gjejnë veten sigurisht edhe ato domene apo dukuri të pjesëshme, apo lokale.

Poezia e A. Iliazit, e krijuar dhe e botuar nëpër disa dekada vitesh, vështruar në arritjet e saj më të mira, tashmë është formatuar si një univers letrar me tipare origjinale, e cila ka fituar një pjekuri të sigurtë. Përgjithësisht, ajo mbetet një poezi e prirjes meditative, ku gërshetohen natyrshëm dhe larmishëm e tashmja me historinë, gëzimi me dhimbjen, e përkohshmja me të shenjtat e përjetshme... Rreth këtyre temave, rimerren një varg motivesh, të cilat, synojnë dhe ia arrijnë që të sjellin në trajtë ciklike, një peizazh poetik sa më të përplotshëm të botës së njeriut, shpesh deri në qasjet më të brendshme e delikate të shpirtit të tij.

Ujëvarat e begata stilistike, sidomos denduria e metaforave, nuk mbeten qëllim në vetvete, pra, nuk mbeten elemente të një dekorit të jashtëm neutral. Ato janë të derdhura organikisht dhe që arrijnë të projektojnë dhe të çlirojnë një energji të fortë emocionale dhe imaginative për te lexuesi. Janë të ndeshura vargje metaforash vërtet befasuese si: “Me orkidenë e mëngjesit në dorë”, “pikojnë gjelbërimet”, “yje pritjesh”, “buzë të paputhura qielli”, “në brengën time mbiu një qipariz”, “qan një zog i kaltër plot maraz... dhe yjet i ul mbi kafaz” etj. Prania e herëpashershme e një figure stilistike si oksimoroni, që përmes të cilit, luhet poetikisht me të përkundërtat, apo të largëtat në vështrimin formal, arrihet që të krijohen p.sh. tablo të tilla aq prekëse e madje tronditëse si: “Më zuri nata, mike, më zuri nata/ Edhe kur të kisha pranë, nuk të pata...” Këtu projektohet një dashuri e pamatshme dhe e pafundme për nga thellësia dhe zjarrmia e ndjenjave mes të dashuruarve.

Poezia e A. Iliazit shfaqet si një krijimtari që mbart esencialisht atmosferën e jetës së njeriut me një mori pamjesh thelbësore të saj, apo edhe disi të lehta e të parëndësishme, në vështrim të parë. Pra, është një poezi me “reliev” dhe jo e rrafshët, ku ndërthurren një larmi temash, zhanresh, formash e teknikash stilistike, të cilat, zgjojnë jo vetëm kërshtëri e befasi estetike, por që krijojnë edhe raporte aktive me lexuesin.

Kjo i ka sjellë kësaj poezie një përjetim leximi, mjaft më të zgjeruar nga aspekti hapësinor e kohor, që ajo zgjon e përcjell, përtej atij teksti real vëllimor.



Në hyrje të librit “*Paradigma e Parajsës*”, Gjekë Marinaj na lë një interpretim i cili shkon përtej një parathënie të zakonshme. Ky shënim është një rrëfim mbi dashurinë si themel i poezisë dhe i jetës. Duke e lidhur këtë vëllim me 30-vjetorin e martesës së tij me Dositën, autori na bën të kuptojmë se çdo poezi në këtë libër është e rrënjësuar në një përvojë personale, por duke e ngritur në një nivel universal, dashuria bëhet jo vetëm subjekt poetik, por edhe *paradigmë e jetës*.

Vetë titulli, “*Paradigma e Parajsës*”, mbart në vete një tension të frytshëm, një koncept gjuhësor përballë një nocioni filozofiko-teologjik. *Paradigma* është model, dhe mënyrë organizimi, kurse *Parajsa* është dritë, shpresë dhe përjetësi. Kur këto dy nocione takohen, sipas autorit, krijohet një hapësirë ku dashuria mund të shfaqet si emocion i pastër dhe si metaforë poetike. Ky bashkim i një fjale të gjuhësisë me një fjalë të liturgjisë shënon edhe rrugën e vetë librit. Kjo poezi ndërtohet si një sistem ku shpresa dhe ndjenja, mendimi dhe bukuria, marrin formë të përbashkët.

Në këtë kuptim, poeti Gjekë Marinaj vendos një rregull të qartë poetik, andaj poezia e tij nuk do të futet në “*turbullira*”, në mjegulla të pakuptueshme. Qartësia, thjeshtësia dhe transparenca janë pjesë e përgjegjësisë së tij ndaj lexuesit. Ai e sheh marrëdhënien me fjalën poetike si një përgjegjësi të njëjtë me fatin e dashurisë: *delikate, e thellë, e brishtë* dhe njëkohësisht e *fuqishme*.



Gjekë Marinaj, “*Paradigma e parajsës*”, poezi,
“*Faik Konica*”, Prishtinë 2022.

RRËFIM MBI DASHURINË SI THEMEL I POEZISË

Nga Shefqet Dibrani

Struktura e librit është një udhëtim i organizuar në pesë cikle: *Dashuria dhe fati*, *Bukuria dhe estetika*, *Ëndrra dhe ëndërrimi*, *Ndjenja dhe pëlqimi*, si dhe *Vetëdija dhe vullneti*. Secili cikël me poezi është një stacion ku dashuria merr formë dhe interpretim të ndryshëm. Nga përkushtimi bashkëshortor, tek admirimi i bukurisë, nga hapësirat e imagjinatës dhe ëndrrës, tek ndjenjat e rafinuara, nga lufta e brendshme mes vetëdijes dhe vullnetit, tek bashkjetesa e harmonizuar si virtut e si vlerë, e bëjnë poezinë e vëllimit “*Paradigma e parajsës*”, me vlerë të veçantë dhe artistike njëkohësisht. Kjo ndarje nëpër cikle i jep lexuesit mundësinë ta përjetojë motivin e dashurisë si një univers me shumë shtresa, ku secili cikël dhe secila poezi është një dritare me një dimension të ri të saj.

Në qendër të këtij universi poetik qëndron *Dusita*, bashkëshortja e poetit. Ajo nuk është thjesht adresuese e lirikës së dashurisë, por figurë që i jep kuptim dhe themel gjithë krijimtarisë. Edhe poezitë e shkruara përpara njohjes me të, thotë Gjekë Marinaj, duket sikur e kanë pasur *Dusiten* si epiqendër e pashmangshme e dashurisë. Në këtë mënyrë, dashuria personale shndërrohet në një paradigmë universale, në të cilën çdo ndjenjë e saj e përjetuar [*më parë apo më pas*] është reflektim i asaj dashurie që tashmë bëhet “*parajsë*” etike dhe poetike e vëllimit “*Paradigma e Parajsës*”.

Një nga idetë më të fuqishme që del nga ky shënim është se *dashuria dhe poezia kanë si emërues të përbashkët metaforën*. Autori e sheh veten si subjekt të një hapësire metaforike që e ka orientuar jo vetëm në art, por edhe në jetë. Kjo e bën qëndrimin e tij të veçantë, andaj për Gjekë Marinajn, të gjithë njerëzit e mirë janë poetë në mënyrën e tyre. Dallimi qëndron vetëm tek forma e shprehjes dhe tek përgjegjësia publike që ka poeti lirik.

Në fund të fundit, libri shfaqet si një proces i pandërprerë rritjeje dhe kërkimi. Autori e përshkruan dashurinë si një mal që ngjitet gjithmonë, por nuk dëshiron të arrijë majën. Sepse në momentin që do

të shihte “*anën tjetër të dashurisë*”, magjia do të humbiste. Ky imazh është një nga më të bukurit e gjithë shënimit. Dashuria nuk është një stacion përfundimtar, por një udhëtim i pafund.

“*Paradigma e Parajsës*” është, pra, një vepër që bashkon përvojën intime me reflektimin universal, një vëllim ku dashuria dhe poezia shndërrohen në dy pasqyra të njëjta. Për Gjekë Marinajn, poezia e dashurisë është mision, përgjegjësi dhe dhuratë.


Pra një përpjekje për të ndikuar



pozitivisht në jetën e njeriut dhe për ta bërë botën më të kuptueshme, më të bukur dhe më të drejtë, dhe krejt kjo mund të realizohet vetëm përmes dashurisë.

St. Gallen, 01 shtator 2025.

* Fragment nga libri në dorëshkrim “*POEZIA E GJEKË MARINAJT KUNDRUAR NGA “PARADIGMA E PARAJSËS”*”.



...Në mëngjes herët, teksa bridhja faqeve të facebook, pulita sytë dhe... Regjisori i shquar, i papërsëritshëm, Dhimitër Anagnosti, 89 vjeç, ishte shuar. Saora doja të isha pranë ikjes së tij dhe shkrova këtë status në FB. “Lamtumir ANAGNOST! Të rrallë janë njerëzit që ju flasin në mbiemër. Por ti ishte një krenari. Krenari e krijimit, e artit, e atdheut. Ti vunjotas, ti bir i Bregut, ti shqiptar i madh, ti gjenium i këtij populli, ti filozofi dhe antropologu i kinemasë. I barte të gjitha mbi shpinë për t’u dhënë dritë, mall, kujtesë, identitet. Të kam pasur përherë në respektin tim më të thellë si për prindërit e mi dhe jam aq i ngopur që shkrova me shpirt, falë mirekuptimit tënd, një libër për ty. Fluturo “Shtergu ynë i Madh”, qielli të pret në këtë ditë plot diell, se Diell për të gjithë ne ishte. Lamtumirë!”

...Kur mbarova, po shihja argjendimin e diellit derdhur mbi syprinë të detit tutje... tutje... Dielli ishte bërë “poetik”. Një “ah” mbi rrënojat e qytetit dhe kujtesën e gurit kohëve të mitit, m’u duk sikur lëshoi. As vetë s’e di pse mendova asaj grimë here për filmat e Dhimitër Anagnostit dhe për vetë Anagnostin. Mendova për lashtësinë, gurin e hirtë ngulur mbi tokën e sertë, dritën, ngjyrën, reflekset. Ishin të gjitha të filmat e tij. Vdekja e paqme e tij hyri në vetëdijen time duke u kolovitur mes poezisë, magjisë së ekranit, “përrallës nga e kaluara”, filozofisë. Brenda meje klithi ky bard i fundit i syrit: *Imazhi*. Klithi deti me një anije plagësh mbi shpinë, pyjet dhe gërçhet me një mësues që bridhte fshat më fshat si Diogjeni me një kandile drite për të mësuar shkronjat e shqipes, klithën e “gurëve të shtëpisë sime”, “malet me blerim mbuluar”, ca “lulëkuqe mbi mure” që prindin e tyre e gjetën te mësuesi dhe liria, njerëz të thjeshtë që qajnë hallet në familje te “shtëpia jonë”, malësorë të ashpër rritur nëpër skërka, ca me thika e ca me libra, Abazë e Servet, dhe mes tyre një Gjolekë që ëndërron diçka më të bukur sesa dhëntë. Të gjitha janë aty. Mes tyre, *Përsiatja* për njerëzit, jetën. Nga gjithë fjalët, më të parën, më thelbësoren, mbase kryefjalën e vlerësimit tim për artin e Anagnostit është pikërisht: **Njerëzorja**. Ose ndryshe thënë: *Njeriu dhe toka e tij. Njeriu dhe deti, Njeriu dhe liria...*

Teksa tres syrin brigjet tona të bukura të Jugut, ku edhe ai ka rrënë, degë, fis e farë, s’e kuptoj pse ndjem i “afërt” me të. Më lidh vetëm toka vallë? Bregdeti, fshatrat tona të afërta, ai nga Vunoi, unë nga Shën Vasili? Mos më lidhin traditat, zakonet, historia jonë, që ai e derdhi në shirita filmi? Apo më lidh më fort arti, imazhet, gurët e hirtë ku ka ngrirë kujtesa e kombit, pullazet e çative, drunjtë e ullirit, lulet e portokalleve, manet, vajzat “mandile hedhura mbi sy”, rrapi në qendër të fshatit? Apo edhe idetë. Qenësia. Dhe ja, këtu ia beh një tjetër “kryefjalë” e filmave të Anagnostit: **Shqiptaria**. Ajo është kudo si plazma, si fryma; e sheh, e ndjen...

Dhe teksa mendoja kësisoj, mishi i butë i jetës hapëronte tashmë shëtitores së re të qytetit tim, Sarandës; dashuritë mbinin syve të djemve e vashave të bukura, ndërsa shpirti im rënë në pezmë nga ikja e regjisorit, operatorit, skenaristit dhe shkrimtarit, fliste me “qiejt” si në një përshpirtje. Ky ishte **ATDHEU**. Atdheu im, i yti, i Anagnostit, i të gjithëve. Atdheu, që kineasti e kishte bartur si çdokush nga ne shekujve, i futur në kockë. Gjithkund ne e shohim Atdheun në filmat e Anagnostit. Si ideal, si dashuri, si flijim, si qenësi e patjetërsueshme, si dhembje. Mandilezezë mbi kobe e leshrat e zbardhura të grave tragjike të Bregut, vellobardhë mbi fytyrat ëndërrore të vashave malësore, ato të Zagorisë, vashave të luftës, vashave të qytetit...

“Nuk ka rëndësi subjekti i filmit, - më vjen zëri i Anagnostit në vesh. - Krim, ndëshkim, dashuri, urrejtje, këto janë në një film. Rëndësi ka: ku dhe kush? Je shqiptar? Si e përjeton dashurinë? Je francez apo je rus? Në forma të ndryshme, e njëjta temë, i njëjti subjekt ka veçoritë e tij, që buron nga identiteti kulturor shqiptar. Se Shqipëria nuk ka tjetër identitet kulturor dhe asaj që prodhon gjuha. ADN -ja e veçantë është te çdo identitet kulturor. Dhe ne kemi identitetin tonë kulturor me bazë gjuhën shqipe, unike, që vjen nga thellësitë. Andaj jemi të veçantë...”

Kjo është AND-ja etnike, **Identiteti**, gjuha, shpirti... - ja formula e filmave të tij. E gjitha si një ABC, që të jepte veçse krenari. Shihni një grimë herë “Përrallë nga e kaluara”. Një histori mirëfilli shqiptare. Regjisori dhe skenaristi e merr shtysën nga Çajupi, por tjetër gjë krijon; jo thjesht zakonet poshtëruar të martesave qysh në djep, por gruan që kërkon lumturinë e saj, lufton

In Memoriam

Teksa mendoj për Anagnostin

Nga Josif Papagjoni




për të, madje vë në lojë vjehrrën dhe vjehrrin e saj. “Malet me blerim mbuluar”, pos sakrificës dhe rrugëtimit të një partizaneje të plagosur drejt jetës, ka një dasmë aty, ka zakone e doke, ka dhe një përplasje njëherazi sociale politike sad he familjare e mes brezave, mendësive. Shihni “Gjoleka, djali i Abazit”. Ai realitet i ashpër, ajo antropologji kulturore, zakonore ngujuar në male, dashuritë e ndaluara dhe rreziku i një thike, rritja dhe formimi i fëmijës midis jetës së vrazhdë të çobanit, ndëshkimit, dhunës dhe ëndrrës, mësimit, kulturimit. Më në fund një shpresë për përparim, qytetërim. Ndofta ky *Identitet Shqiptar* ishte porta prej nga hyjnë e dalin edhe përjetimet e mia si kritik. Por jo vetëm të mijat. Janë portat e një “alkime” që ti veçse e ndjen në rrjedhën e gjakut, por nuk e shpjegon dot. Sepse Anagnosti nuk është artisti që t’i jep të gatshme idetë. Ai është një Mag që di të luaj me thellësitë e shpirtit të njeriut.

...Unë kam shkruar një monografi për Anagnostin. Një libër është një “shpirt i djegur”, një pergamenë, dhe mua më duhej të bëhesha një skrib në qelën time. Por imazhi i filmave të tij nuk ishte thjesht një pergamenë, nuk kishte “aromën” e pluhurit të bibliotekës. Jo aq me fjalën sesa me imazhet e këtij artisti duhet komunikuar. Ndofta është pikërisht fuqia hipnotike e imazhit që na josh aq shumë në filmat e tij. “Unë kam folur me filmat e mi”, më pat thënë kur i kërkoja të rrëmonim ca skutave të laboratorit të tij, zjarrmisë krijuese. “Filmi është imazh, kujtesë në lëvizje, - më shpjegonte një ditë teksa kuvendonim për specifikën e filmit si art. - Ja... Dhe nxori nga xhepi një stilolaps. - E kam këtë këtu, tani e lëviza këtu. Është i njëjti dhe “ndryshe”, sepse ka ndryshuar raporti me gjërat e tjera. Simboli i shkrimit, i dijes, por edhe diçka tjetër. Duhet ta kapësh funksionin, ndryshimin, lëvizjen. Po s’e kape, iku, u zhduk. Fiuuuu... Nuk është shkronjë që mbetet në letër imazhi. Ai vjen dhe ikën. Prandaj ka shumë spontanitet. Duhet të jesh i gatshëm ta kapësh pikërisht kur ai lind. Imazhet kanë kujtesë të “shkurtër”. Kur i fikson në film, kujtesa e tyre nuk shuhet, mbetet. Nëse shkronja, fjala radhitet mbi fushën e bardhë

të letrës, qëndron aty, krijon kujtesë, dhe s’ka hapësirë e as kohë të drejtpërdrejtë fizike, përkundrazi imazhi ka, imazhi është si era, vjen dhe ikën në çast, nuk përsëritet. Imazhi është “shkronjë” në lëvizje. Dalloje! Gjeje! Në ekranin e bardhë imazhi fiksohet, ka edhe kohë edhe hapësirë, ka energji, ka dinamikë, ka domethënie, ka kujtesë. Është shpirt në lëvizje...”

Kishte të drejtë. Syri ynë është i mbytur me imazhe. Truri, edhe ai, prodhon dhe pleks pafundësisht imazhe të përthyerë e të përfytyruara. Nuk e rrok kollaj atë transhendencë që veçse fshehtësitë e mendjes inventive si ajo e Anagnostit e krijon. Një shikues i thjeshtë nuk e dekripton kollaj atë mistikë poetike që lidhet pikërisht me artin e tij, me “qiellnajën” emocionale, memoriale të tij, me çastin (eskatalogjik) kur subjekti bëhet shpirt. Kur e vogla, e kufizuara, e atyqjendura shkon tek e paana, e pamata, e kudogjendura, bëhet e madhërishtme. Ja, pra, dhe një tjetër veti e ngulur thellë në kinemanë që Anagnosti bëri: **Universalja...** Arti në vetëdijen e tij estetike ishte një paralëndë zanafillore, ishte si *brahma* ku qenia njerëzore ngjizej. “Shqipëria nuk është gjë tjetër veçse kulturë, - më rierdhi sërish zëri i tij në vesh. - Përveç gjuhës dhe kulturës, çfarë ke ti, forcë ushtarake? Kjo natyrë, ky peizazh fantastik me male, liqene, me lumenj, me det, me njerëz, me gjuhën shqipe origjinale dhe të veçantë, kjo është pasuria tënde...”

Në filmat e Dhimitër Anagnostit spektatori dallon dy elemente bulbore: *Madhëshinë* dhe *Njerëzoren*. Këto mbështeten mbi dy tema madhore: *Atdheu* dhe *Shqiptaria* (mëvetësia identitare). Këto, edhe në qoftë se nuk duken a nuk i sheh, janë brenda tyre, drithërojnë aty. Ëndrra është i treti element i kudogjendur. Jo ëndërimi si situatë psikofiziologjike, por ëndrra për diç të bukur, për një tjetër realitet, më të mirë, ndoshta të pamundur në dukje, por frymëzues, për të cilën ia vlen të vetëfljohesh. Ëndrra për të munguarën. Ëndrra për të penguarën. Ëndrra si vizion. Për ëndërrën vdes dhe një mësues udhëve të fshatrave të thellë të Malësisë, Dritan Shkaba quhej, në filmin “Komisari i dritës”. Mjafton kjo



ëndërr që ta bëjë filmin të shikueshëm, duke ia hequr zgjyrrën ideologjike që koha pat lënë.

Jeta e njeriut është një cikël i pareshtur i rrokullimës së historisë. Nuk e di pse këtë “ëndërr” a “ëndërrim”, që filmat e tij na japin gjithkund, dua ta lidh me paanësinë dhe të madhërishtmen; pastaj ta pleks me vetë njeriun në mikro dhe makro kozmosin e tij, te kasollja me kashtë e një mësuesi a te një kabinet luks i një gjenerali, madje-madje të shkoj edhe përtej kufirit të dheut tonë, Shqipërisë e shqiptarëve, dhe ta bëj pjesë të cikleve të mëdha të ekzistencës humane, të vetë lëvizjes së shpirtit. A e kanë filmat e Anagnostit “Botën e Madhe”? Padyshim që e kanë. Por sa kjo “botë” është aty, brenda tij? Deri ku shkon? Deri sa hapet? Them se “Bota e madhe” dhe “Bota e vogël” rrinë te filmat e tij si një pleksje kahesh, si një ndërthurje, si një vajtje-ardhje shpirttrash. Janë simbiozë. Një dikotomi. “Po bota çdo thonë”, e nguc Marigoja Vangjelin te “Përrallë nga e kaluara”, teksa të dy, kinse, do t’i japin fund jetës me helmim, sepse kanë bërë turpe të padëgjua, kanë rënë në shtrat nuse e vjerr. Por kjo është bota brenda një fshati. “Gurët e shtëpisë sime” sjellin përplasjen e dy botëve të huaja, shqiptarët dhe italianët. Te “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” botët janë dy shtete, dy ushtri, dy qëndrime (humane dhe antihumane) ndaj luftës. Kur njeriu pikturohet bukur, ai e tejkalon cakun, hapësirën, vetë kohën. Sepse njeriu si qenie, ku më shumë a ku më pak, aty apo këtu, dje apo sot, ka një fill përshkonjës që sikur e lidh, njëjtë me atë vetëtimën që flakërin mes reve të ngarkuara me “elektricitet”.

Personazhet e Anagnostit janë shpirta të hapur, shpirta kozmikë, shpirta që rrugëtojnë historisë dhe hapësirës humane. Ëndrra është përtej një dite, përtej një jetë-vdekjeje, përtej një shekulli, epoke. Prandaj dhe arti i tij i tejkalon kohët, hapësirat. Ai i ka dhënë lavdi fuqisë krijuese të shqiptarëve. Vangjelët, Tanat, Marigotë, Sulot, Jaçet, kujdestarët surratpatate, Abazët, Gjolekët, Servetët, Gjino, Dritanët, Kabot janë jo vetëm të djeshmit, as vetëm të sotmit, por edhe të nesërmit ndër ne shqiptarët. A nuk janë ata si pilarët ngulur thellë vetëdijes etnike dhe që mbajnë përsipër parthenonin e shpirtit tonë?!

Ja, thërmokla të këtij shpirti nga “shpirti i botës” (*anima mundi*) kanë sjellë edhe filmat e Anagnostit. Dhe ëndrra e njeriut për t’i ikur të keqes dhe për t’iu bashkuar të mirës, na shfaqet aty, në mes të mesit. Ajo merr formë, kthehet në një pikëllim që s’të lë rehat, që të grish, që të çpon. Unë e kam ndjerë këtë në filmat e Anagnostit.

Subjektet nuk janë grimime të jetës, por vijnë nga vetë jeta, bëhen jetë, bartin art, ide, të menduar figurativ, përshfaqen si një vesk që nënkupton të dobishmen, të ardhmen e personazheve, humanen dhe të bukurën. Janë premisa për shpërfaqjen e njeriut të mirë, njeriut të lidhur me tokën, atdheun, fshatin, shtëpinë; një kryq mundimi e shpëtimi. Dhe subjektet shkojnë përtej një fati, plekset me fatin e kombit, sepse gjithkush në filmat e Anagnostit ka një histori më vete, të veçantë, të papërsëritshme, heroike a poetike; histori të një jete njeriu sa dhe histori të një populli. Këto shkrihen më tej te “rruga e artit” për të fituar vezullimin estetik. Arti e bën “ëndërrën” të rrokshme, të shkrirë tek ndjeshmëritë dhe mendimet e heronjve të tij të thjeshtë, ndërsa fatin e tyre ai e rrëfente në mënyrë të tillë që të ngulitet në kokë për fuqinë e shprehjes filmike, sa dhe për besueshmërinë, sintezën, vërtetësinë. E pra në këto tri udhë, Dhimitër Anagnosti ka ditur të lundrojë. Ai ka qenë nga “rremtarët” më të mirë të ekranit shqiptar, për mua më i miri.

Anagnosti ka qenë i vështirë. Nuk ka dashur të intervistohet, t’u japë gjuhë të panjohurave të artit të tij. Duket sikur ai ia pat lënë në dorë vetëgjykimin e filmave dhe ideve të tij estetike “pritësit” të nesërm, perceptimeve të tij, shijes së kohës, duke mbetur deri në fund një sqimëtar. Ndoshta është pikërisht ashtu siç e thotë Kadare për procesin krijues të shkrimtarit te libri “Ftesë në studio”, që zana ia mori gojën me qëllim që ajo thellësi e ajo fshehtësi ku ngjizet krijimi të mbetet e pabëzajtë. Ndofta, as Anagnosti vetë nuk e ka ditur hollë-hollë se si i kanë lindur e janë shuar imazhet, atë e dinte veçse instinkti i tij krijues, alkimia e procesit, konturet e spërnditura sa dhe të mugëta të ëndrrës. Vetëdija krijuese e artistit është një palimpsest. Dhe “palimpsestet” e artit dhe vetëdijes krijuese të Anagnostit mund t’i zbulojë vetëm koha. “Pergamenat” e tij janë aty, në ekran, në 15 filmat artistikë dhe 10 filmat dokumentarë duke i blatur artit dhe kinemasë shqiptare në përgjithësi një gjuhë të bukur, një “scripta manent” të shkruar mbi ekran...

A jini ju “gjo” me Anagnostin?

Nga Ylli Pango

...Gjyshja ime nga mamaja ishte Anagnost...dhe kjo nuk do të paraqiste as ndonjë interes për ndokënd... e aq më pak ndonjë meritë për mua.

E madje s'do ngjallte as edhe ndonjë kuriozitet të vogël, të mos qe mbiemri i një njeriu si Dhimitër Anagnosti.

Po edhe unë po e përmend thjesht se ish ky mbiemër që më dha një mundësi për të njohur nga afër Dhimitër Anagnostin, Taqon, ndër më të mirët e kinematografisë shqiptare, për mua më të mirin...

Dhe për të shkruar për ca detaje të vogla të jetës së tij, nga ato të voglat, por që ato e dallojnë të madhin...

...se me thënë të drejtën të ishte të flisja për kushurirllëkun, ende nuk e di tamam tamam, se deri në çfarë shkalle jam i afërt me Dhimitër Anagnostin...

...në karriket e qeverisë Meksi 1992-1994, më ka rastisur të ulesha disa herë pranë tij kur mungonte ministri përkatës i Arsimit. Anagnosti, ndryshe Taqua, ishte ministër kulture e unë isha zv.ministër arsimi.

...ai më afroi i pari si më i madh që ishte...”pa hajde ulu këtu pak...”më tha...” se duhet ta dish besoj se jemi...a biem dhe “gjo” bashkë. Gjyshen tënde Lilon, Lilo Kiçen a ndryshe Anagnosti, ne e kemi kushërirë.(kjo “gjo” në dialekt Vunoi, që dmth “gjë”, donte të thoshte që ishim diçka...si punë farefisi...)

...Të njëjtën fjalë, “gjo”, tha atëhere edhe për Edi Ramën, kur aso kohe sulmonte në gazetë qeverinë e diku pat thënë diçka edhe për Taqon...”po unë e kam mbajtur në gjunjë kur ish i vogël...edepsëzi...biem edhe “gjo” bashkë...pa le...”

...kam pasur gjithnjë idenë, dhe jo vetëm unë, që në atë fshat, në Vuno, ku lindi Taqua dhe mëma ime e ca të tjerë, të gjithë janë në një farë shkalle “gjo” me njeri tjetrin...

(nuk di të kenë mbajtur inat Taqua me Ramën më vonë... kanë qenë kohra shumë të largëta ato të Ramës së vogël në prehër...se ndryshe nuk do ja shkruante aq bukur nekrologjinë e vet Rama, Anagnostit...

...e quajti dhe “barba”, kështu u thonë andej nga bregu “xha”-ve, gjyshave, burrave të moshuar me një barrë mend...e disi të afërt)...

...Po të isha me Taqon nuk do ndiqja më dot se ç’thuhej në mbledhje qeverie se do e pyesja vazhdimisht e do doja të dija. Se unë isha thjesht nip Vunoi, nga mamaja, gjysëm-gjak bregu... kurse ai puro vunjotës...temperament, e nevrík-artist si ai... (mirë u tha: “diktator i së bukurës...vërtet e donte të përsosur, të vërtetë, bukurinë në art...)

...më tregoj një herë, një tjetër histori me këtë fjalën “gjo”...

“...më merr në telefon një herë ambasadori jonë në Argentinë e Uruguai, Piro...(edhe ky vunjotës) e më thotë:” Taqo kam gjetur një kushëririn tënd këtu në Uruguai, pronar hotelesh turistike në Puerta y Sol...ka mbiemrin tënd Anagnosti...do të rinjitet me fisin e harruar e të ftojë këtu në Uruguai njerëz të fisit të tij nga Shqipëria...”

“Dëgjo këtu” i them(tregon Taqua), “ unë Anagnost jam vërtet, po mua nuk më bie edhe aq “gjo”, ...tamam “gjo” e ka Lilua, Lilo Anagnostja, Kiçja nga burri, ajo e ka pasur vëlla... babanë e këtij që kërkon...e ai e di që ka emigruar në Amerikë Latine që në kohën e Zogut...”

...e kishte fjalën për gjyshen time e vëllanë e saj mërguar herët në shekull të 20...

Njoftoi pastaj Taqua njerezit e gjyshes time, ne, e u rilidhen njerëzit nga të dy kontinentet...(të kish qenë dikush tjetër...në fund të fundit edhe Taqua...si Anagnost, «gjo» i kishte...)

...”do më gjesh një drejtor të mirë për kulturën” më thotë



një ditë...

Dhe unë i çova Korab Hoxhën. Poet, përkthyes e mbi të gjitha njeri modest e i rrallë për nga pastërtia e shpirtit....

...I pëlqeu që në fillim Taqos.

“Epo” mendova “të dy artistë...nuk ka si bëhet “krushqi” zyrtare më e mirë...

Pata gabuar çuditërisht...

...pak muaj më vonë më thotë Anagnosti i madh: “...dëgjo këtu...nuk bëhet djalë më i mirë se ai shoku yt. Edhe krijues me vlera...I kam lexuar perkthime kollosësh nga rusishtja Brodskin, Nabokovin...i kam lexuar edhe disa poezi ...i ka shumë të mira...” pastaj me një kthesë të beftë nga ato të Taqos “...po më duket se nuk e do atë punë..në ministri...ndofta se është tamam i artit...si edhe unë ...kupton ti...”

...Disa ditë më parë Korabi vetë më pat thënë se nuk i shkonte ajo punë...(“ndonje problem me Taqon” e pyeta...”Absolutisht jo...i shkelqyer...)

...dha dorëheqjen pas pak ditësh. Pa ja kërkuar Taqua. Nuk qe heqje nga puna. As dorëheqje e ashpër zyrtari. Qe një largim i butë e nje pranim i butë nga eprori. ...i rrallë ndër viset tona...

...Jo shumë kohë më vonë dha dorëheqjen nga posti ministror edhe vetë Anagnosti, Taqua...

...u tha per shkak te deshtimit te referendumit dhe mosnjohjes se kesaj si deshtim...edhe kjo...po unë them se i pat ardhur edhe atij në majë të hundës si Korabit ajo punë...

...ja kështu artistët...ata të vërtetët...

...po kur uleshim flisnim për filmin, Vunoin, Jalin....Aty shtëpitë e vockla buzë detit, ngritur nga gjyshërit tanë që patën rrahur kurbetin ajo e Anagnostit e ajo e familjes së gjyshes time, ishin pranë e pranë.

“Hajde” më tha një herë, “por po erdhe me mua ka kërkesa... duhet të vish i pajisur...”

...Kur shkonte atje merrte lloj lloj anti-helmesh kundër gjarpërit, vegla gjuetie, peshkimi, veshje speciale...E dëgjoja kur më tregonte aventurat verore në bregdet dhe duke ditur për atë filmin “Njeriu kurrë nuk vdes”, punim diplome, sipas tregimit të Ernest Heminguejt, që mori dhe çmim ndërkombëtar ...e kuptoja se e donte Heminguein e madje nganjëherë me ato antihelmet, pushkën e gjuetisë e grepat... më dukej edhe si ai...

...nuk fola për filmat...filmat shihen, nuk tregohen... gjithsesi ata janë parë e riparë aq shumë ...për ta është folur e shkruar aq mirë...për “Lulëkuqet...” që e rishkroi vetë e i dha jetë pasi lexoi “Bonjaket”, për “ 14 vjeç dhëndërr” ku më ringjalli Zagorinë e babait e për “Gurët e shtëpisë time” ku më shpuri në Vunoin e nënës time etj etj...

...po ishin dhe të përsosur në çdo detaj filmat e Taqos...e aq té gjetur, në karakteret e aktorët që zgjidhte, në skenat e dialogjet aq shqiptare sa vetëm duke i kujtuar të gjitha këto mund ta kuptosh se përse e shkruajti Mevlani atë “diktator i së bukurës”. Po unë nuk harroj se arsye për këtë cilësim, ka qenë dhe ndjesia e reagimi i tij natyral alergjik, karshi ndonjë filmi a veprë arti reklamuar më kot e pa vlera:”...po ç’janë ato metafora lakuriqe...ai banalitet...kupton ti...”

...zaten me këtë përsosmëri në këta filma, Taqua u bë ky që është...I ngriti monumente karakterit shqiptar, historisë, ...vendlindjeve tona...brenda këtij vendi...vendlindjeve të të gjithë neve...e me këto i ngriti monument vetes si artist...e prandaj po na dhemb kaq shumë që po na ikën...

...tani edhe mund ti përgjigjem asaj pyetjes që ngrita në krye, a jeni a s’jeni edhe ju “Gjo” me Anagnostin...

...me ata filma e ato karaktere gjithë-shqiptarësh, që i ka qëndisur a skalitur edhe si shkrimtar, edhe si skenarist, edhe si operator e si regjisor, në libra e në skenare, ekran e në mendjet tona...me Anagnostin i bie të jeni edhe ju, të jemi të gjithë ne “Gjo”...

Dy poezi nga Kiki Dhimula

Marrë nga Libri “U zhvendosëm brinjazi”
Përktheu nga origjinali: Armela Hysi

Epitaf

“Çdo puthje që jepet, ama çdonjëra pa përjashtim një për qind përbëhet nga përjetësia dhe e tëra pjesa tjetër prej rrezikut të jetë e fundit.”

Por dhe e fundit veçse cila vallë në fakt nga puthje do t’quhet

për sa kohë të paktën atypari pas vetes së tyre e tërheqin kujtesa nga njëra anë harresa nga tjetra secila si pronësi të vetën duke e pretenduar

der’sa Solomoni i Drejtë që të dalë në shesh kujt i takon vërtetë mes-përmes do të kërcënojë ta ndajë gjysmën të marrë njëra e gjysmën tjetra dhe cila prej të dyjave në çdo radhë – asnjëherë e njëjta s’është – të ulërijë mos.

Çdo puthje përbëhet tërësisht nga rreziku të jetë e fundit.

Në vazhdim të përherëshme është vetëm ajo puthje që kurrë nuk është dhënë. Të urta, paqësisht e ndajnë pritja dhe heqja dorë lule që përballin njëra-tjetrën ato të dyja në vazo të përbashkët kompromisi kenotaf stolisin.

Zhvendosja

Siç u thepis përsëri aty vazhdon të jetë. Vëllim balte gurësh pluhur aty i përplasa në mes të korridorit të ngushtë nga ku detyrimisht kaloj jashtë në kam për të dalë a të shtyhem më brenda. Një mal i tërë gërmadhat.

Pyes veten kaq e madhe të qe kjo histori?

Krejt e kundërta E stërpakëza e një historie është ç’ shemb përtokë tërë këtë përmasë pikëllimi.

Ja për hir të kësaj zhdrejtësie analogjike ruhet prestigji i së pakuptueshmes.



Le ta theksojmë që në fillim: autori i Romanit për fëmijë “Lejleku”, Gani Bytyçi, është ndër të rrallët që e trajton tematikën e luftës. Dhe arrin të na japë një roman të realizuar artistikisht. Letërsia për fëmijë ka një rol të veçantë në formimin e botëkuptimit dhe vlerave të fëmijëve dhe rinisë, për t’iu dhuruar atyre mesazhe që i udhëzojnë t’i kuptojnë jetën, shoqërinë dhe historinë. Kaq shumë përjetime dhe ende shumë shkrimtarë hezitojnë ta trajtojnë këtë periudhë më të re historie?!

Një nga temat më të diskutueshme dhe më të thella në këtë zhanër letërsie, është tematika e luftës. Në letërsinë për fëmijë kjo tematikë trajtohet përmes përmasës edukative dhe morale, ku qëllim kryesor është që t’u jepet fëmijëve një shtjellim më i thjeshtë, por i thellë, i ngjarjeve historike dhe pasojave të luftës. Me këtë rast, le t’i kujtojmë veprat në prozë të Rifat Kukajt, si ajo e tregimeve për fëmijë “Kush ma vodhi dorën” apo romani për fëmijë “Një verë pa bukureza”, ku lufta është një akt çlirimi dhe heroizmi dhe ku heronjtë dhe protagonistët janë vetë fëmijët që bashkëpunojnë me të rriturit. Mirëpo, lufta përfshin edhe pasojat emocionale dhe psikologjike që lë tek njerëzit, sidomos të fëmijët, të cilët humbën prindërit, shokët ose shohin pamje të trishtueshme të dhunës dhe shkatërrimit...

1. Perspektivat rrëfyese të romanit: lufta dhe mërgimi

Lufta dhe mërgimi. Me këto pasoja merret edhe romani i Gani Bytyçit, ku lufta dhe mërgimi trajtohen të këndvështruara nga disa perspektiva kohore: nga kujtesa e autorit, si rrëfyes në pjesët e para të veprës; nga këndvështrimi i të sotmes dhe vetë ngjarjeve të luftës, i personazhit kryesor, Lules. Një nga perspektivat më të zakonshme për luftën është ajo që përqendrohet në ngjarjet historike dhe dëshmitë që janë lënë nga ata që e kanë përjetuar atë. Ky trajtim kohor është veçanërisht i rëndësishëm për përshkrimin e periudhave të pasluftës, me mërgimin, ku shkrimtarët kërkojnë t’i rikthejnë në kujtesë dhimbjen, humbjet dhe heroizmin që e shoqëruan atë kohë përjetimesh të rënda. Në këtë kuadër, letërsia përpigjet ta paraqesë perspektivën e atyre që kanë vuajtur, duke krijuar një lidhje të fortë midis të kaluarës dhe të tashmes. Kësisoj, në shtresat narrative të veprës ndërldhen breza të ndryshëm: i brezit të autorit që i ka përjetuar në mënyrën e vet ato ngjarje, si dhe i brezit të Lules fëmijë, që i shkruan letra Lejleku në vendlindje, pasi ajo është detyruar të largohet dhunshëm me familjen e saj, në mërgim, pa e kuptuar përse ka ndodhur ky largim. Në fakt, autori as që dëshiron ta lëndojë botën e vogëlushes, as ta përmendë fjalën luftë. Ai përdor një qasje më delikate dhe më tërheqëse për t’ua shpjeguar fëmijëve pasojat e saj. Romani arrin të na japë përvojat dhe botën emocionale të fëmijëve, me gjithë pasigurinë, frikën, humbjen, por edhe me shpresën dhe dashurinë për shtëpinë e për vendlindjen, pa përdorur fjalën e ashpër “luftë”. Madje, për t’ia dhënë kësaj vepre karakterin universal, autori e afishon që në fillim në referencën përkushtimore: “Të gjithë fëmijëve të botës që janë viktime të konflikteve, të dhunës e të luftërave”. Kjo do të thotë se vepra merr karakter të përgjithshëm. Edhe te teksti hyrës jepet, në formë të sintetizuar, lënda romanore:

“Një vajzë e vogël nga një fshat i Kosovës, si çdo vit tjetër, po priste me padurim që pranvera t’i sillte lejlekun e saj. Pas një pritjeje të gjatë, torturuese e të mërztishme, një ditë, krejt papritur, ajo bashkë me familjen, detyrohen që ta braktisin shtëpinë dhe fshatin, akoma pa arritur lejleku. E mërztitur, e pikëlluar dhe pa e kuptuar se çfarë po ndodhte me ta, ajo nisi t’i shkruante letra lejleku.”

Lulja është një karakter që reflekton durimin dhe dashurinë e pafundme për natyrën dhe për lidhjen e saj me të. Ajo e shikon lejlekun si mik të dashur dhe fakti

Gani Bytyçi: “Lejleku”, roman për fëmijë e të rinj,
Faik Konica, Prishtinë 2024

Fryma e letërshkrimit për lejlekun, simbol i lidhjes së mërgimtarëve me atdheun

Nga Prend Buzhala

që ajo fillon të shkruajë letra për të, është një formë për t’i shprehur dhe komunikuar mendimet dhe shqetësimet që ka.

2. Alegoria e dashurisë dhe shpresës: Lulja dhe personazhi figurativ i lejleku

Në këtë roman, letërshkrimi i vajzës për lejlekun e saj, si dhe pasqyra e këtij akti në mendimet e shkrimtarit, e thellon këtë procedim, shpalos ndikimin emocional dhe simbolik të mërgimit, humbjes dhe kërkimit të identitetit.


Një nga motivet më të rëndësishme që shfaqet në letërsinë për fëmijë, kur flitet për shpezët dhe zogjtë, është liria. Shpendët trajtohen si simbole të lirisë, pasi mund të fluturojnë lart dhe larg, duke iu dhënë mundësi fëmijëve të imagjinojnë një botë ku ata mund të jenë të lirë, pa kufizime. Në shumë vepra letrare zogitë paraqiten si udhëtarë të pafund, të cilët shpalosin ide të largësive dhe mundësive që janë jashtë mundësive të zakonshme të jetës së përditshme. Një shembull i tillë shihet te karakteret e zogjve në përralla dhe tregime, ku ata janë të lidhur me ide të lirisë dhe pavarësisë. Kësisoj, edhe figura e personazhi i Lejleku te ky roman, merr një vend të veçantë. Ky shpend simbolikisht përcjell mesazhe të rëndësishme mbi vendlindjen, natyrën, traditat dhe vlerat e jetës, duke krijuar një lidhje të fortë midis fëmijëve dhe mjedisit që i rrethon.

Në këtë vepër lejleku shfaqet, pra, edhe si simbol që shqipton lidhjen e pandashme me shtëpinë dhe rrënjët, simbol i kthimit aty, i atyre të rinjve që kanë migruar në botën e jashtme. Vajza e vogël, përmes shkrimit vetjak, shpreh dashuri të pafundme për mikun e saj dhe shpresën që ata do të jenë përsëri së bashku... Teksti lexohet si alegori e dashurisë dhe shpresës. Te

Letra e parë *Largimi nga fshati), kemi një ndërthurje mes natyrës së vendlindjes dhe tragjedisë njerëzore, që kap disa nivele të tekstit. Emigrimi është shkatërrim i jetës së dikurshme. Mbase, ky edhe ka qenë qëllimi kryesor i autorit, që ta evidencojë këtë plagë në të gjitha përmasat e veta. Lulja është e shqetësuar dhe e tronditur, ka humbur shtëpinë e saj dhe mjedisin e njohur. Ajo nuk e kupton plotësisht se çka është lufta, por i tregon mikut të saj (lejleku) se njerëzit me “uniforma të zeza” vrasin dhe shkaktojnë dhimbje, që lënë gjurmë në jetën e pafajshme të fëmijëve dhe kafshëve. Megjithatë, përmendëm Rifat Kukajn në fillim, le të theksojmë se ai ka një vepër poetike me titullin “Lejlekët në luhaja» (»Flaka e vëllazërimit«, Shkup 1971). Dëshëm të theksojmë se në letërsinë për fëmijë janë të njohura paraqitja e trajtimi i botës së kafshëve dhe shpezëve, të cilat e nxisin imagjinatën dhe kureshtjen e fëmijëve. Reminishencat romanore për lejlekun na vijnë që nga vargjet e njohura të Mjedës: «O lejlek, o shpend udhtar, . Qi prej s largut je tui mbërri”...(poema “I tretuni”), ku figura e lejleku merr një rëndësi të theksuar si simbol i dashurisë për atdheun, nderin dhe besnikërinë, ndërsa përmes imazheve poetike Mjeda krijon atmosferë të thellë lirike dhe emocionale. Edhe te ky roman lejleku, si shpend migrues, bëhet një metaforë për përjetimet e humbjes dhe të rikthimit, përmes të cilit autori përçon mesazhe të mëdha mbi lidhjen e njeriut me atdheun dhe natyrën.


3. Fryma e letërshkrimit

Kësisoj, te Letra e dytë edhe titulli është kuptimplotë: “Takimi me lejlekë të tjerë”. Kjo letër shpalos përshkrimin e përjetimit të mallit dhe vuajtjes, ndërkohë që Lulja, personazhi kryesor, tregon për jetën e saj të re pas largimit nga fshati. Në fillim të



letrës, Lulja përshkruan një moment të bukur pranveror ku, gjatë shëtitjes së saj me nënën, sheh një grup lejlekësh. I ngjashëm është edhe largimi nga fshati. Lulja e ndjen se diçka e thellë po ndryshon brenda saj dhe brenda familjes.

Ky ndryshim është ballafaqim me të panjohurën dhe me atë që është lënë pas. Vijnë me radhë letrat tjera, deri te e nëntëmbëdhjeta. Letra e tretë (*Atje po digjej gjithçka*), paraqet një periudhë pasigurie dhe shqetësimi, duke shprehur frikën dhe pasigurinë e personazhit kryesor, Lules, për fatin e lejleku të saj dhe për pasojat që ka sjellë zjarri që ka shpërthyer në fshatin e tyre. Te Letra e katërt (*Takimi me shopen*), përshkruhet, tashmë nga një perspektivë tjetër narrative, largimi për shkak të dhunës dhe frikës që shkaktohen nga situata e luftës dhe zjarreve. Ky është një moment i thellë trishtimi, që shënon një humbje të madhe dhe një ndarje të dhimbshme nga e kaluara. Shkolla e tyre, e Lules dhe e Sarandës, në fshat është djegur, një tjetër humbje e madhe që ka prekur të gjithë fshatin dhe veçanërisht fëmijët. Megjithatë, në mes të gjithë dhimbjes dhe trishtimit, Lulja ruan një shpresë të fortë dhe besimin që dashuria dhe gëzimi do të shërojnë gjithçka. Përjetimet e humbjes, kërkimit dhe shpresës, paraqiten edhe nëpër letrat tjera. Lejleku që kërkon njerëzit e tij është simbol i vazhdueshmë i kërkimit të diçkaje që është zhdukur, i një lidhjeje që nuk mund të realizohet plotësisht. Letërshkruesja Lulja, është personazh tejet empatik dhe e ndjeshme ndaj ndjenjave të të tjerëve, siç e tregon ndjenja e saj e thellë për lejlekun dhe kërkimin e tij. Bie fjala, te



Letra e gjashtë (*Kënga për lirinë*). Lulja shfaq jo vetëm mrekullinë e mësimi dhe rëndësinë e dijes për fëmijët, por gjithashtu lidhjen e thellë që ajo ka me atdheun dhe me lirinë. Në Letrën e tetë (*Pikëllimi i Dorinës për gjyshen*) ka një moment emocional dhe prekës, ku Dorina, një vajzë e re, e përjeton dhimbjen e humbjes së gjyshes së saj, e cila ka ndodhur pas një periudhe të vështirë emigrimi.

4. Perspektiva narrative e Lules si rrëfyese

Letra është një urë komunikimi që lidh shpirtin e dy qenieve, duke kaluar përmes distancave, kohës dhe rrethanave të ndryshme. Te Letra e dhjetë veçohet historia e një fëmije që nuk mund t'ia dërgojë letrën e tij diellit. Kjo është një figurë poetike që simbolizon pafajësinë dhe humbjen. Pavarësisht dhimbjes që kalon, Lulja shpreson të flasë për gjëra të bukura kur të jetë me mikun e saj sërish. Kjo dëshirë për biseda të bukura dhe të ngrohta paraqet një nevojë të thellë për shpëtim dhe shpresë në një kohë të errët dhe të pasigurt. Te Letra që flet për Bardhin dhe ëndrrën për babën, ka një rrëfim të brendshëm dhe intim të vuajtjeve dhe ankthit të një të riu që ka kaluar një përvojë të dhimbshme dhe ka pasur ndikim të madh nga ajo që ka përjetuar në ëndërr.

Në ëndërr, ai ka parë një skenë ku babai i tij është marrë dhe ai dëshiron ta ketë atë sërish me vete, duke shprehur dëshirën për të mos e humbur kurrë. Ëndrra që përjeton Bardhi është metaforë për pasigurinë dhe frikën nga humbja... Te letra *“Ndarja me mësuesen Verë”* nxënësjë ballafaqohet me një ndarje të dhimbshme nga mësuesja dhe nga shokët e klasës, për shkak të një udhëtimi që do të çonte në një shkollë tjetër.

Te Letra 14, nënat, si simbol i dashurisë dhe kujdesit, janë të mbërthyer nga dhimbja dhe përpjekjet për të lidhur komunikim me ata që kanë humbur. Prekës është përshkrimi i gruas që humbi të bijtë.

Letra tjetër, e shkruar shumë vite më vonë, paraqet ndryshimet që kanë ndodhur në jetën e Lules që nga koha kur ajo dhe familja e saj u detyruan të largoheshin nga atdheu për shkak të luftës. Ajo flet për jetën e saj në Fribourg, për karrierën dhe familjen e saj. Lulja e ndjen thellë humbjen e të dashurve dhe jetën që la pas, por gjithashtu gjen ngushëllim në natyrë, sidomos te zogjtë që jetojnë në paqe dhe harmoni, duke kontrastuar këtë me luftën dhe ndarjet që ka përjetuar njeriu...

Në fund, në tekstin e titulluar “Para kthimit”, ndryshon perspektiva e rrëfimit. Një pjesë e thellë e këtij teksti, është zhgënjimi që Lulja ndjen kur nuk gjen asgjë që lidhet me të shkuarën e saj, si fotografitë e familjes së saj dhe të dashurve të saj të zhdukur.

5. Emrat si gurë të kujtimit

Një tregim i bukur dhe prekës (*“Gurët që janë emra”*) shpalos shumë dimensionë të ndjeshmërisë, lidhjes familjare dhe rëndësisë së kujtimit të të kaluarës. Të gjitha ngjarjet që ndodhin, ndonëse të thjeshta në dukje, janë të ngarkuara nga ana emocionale dhe tërheqje simbolike. Pasi takon xha Zenelin dhe viziton varrezat, Lulja reflekton mbi të kaluarën dhe lidhjen që ka me të vdekurit, duke kuptuar më shumë rreth rëndësisë së kujtimit dhe ruajtjes së traditave... Lulja, pas një momenti të thellë reflektimi, përjeton një gjendje që është midis realitetit dhe ëndrrës. Ky është një përshkrim poetik që tregon pasigurinë e saj në lidhje me realitetin dhe mendimin e saj për atdheun. Atdheu është i pranishëm si një ëndërr që kurrë nuk ndahet, dhe Lulja është gjithmonë e lidhur me të, pavarësisht se ku ndodhet. Shkrimi i fundit, ku thuhet *“Atdheu është si ëndrra. Sa mendon se të ka lëshuar ai kthehet e të zë përsëri. Ai nuk ndahet asnjëherë”*, përmbyll romanin me një mendim të thellë dhe të fuqishëm.

Mars 2025

Emocionet e një fotografi

Sprovë nga Qerim Vrioni

Si në çdo veprimtari krijuese në fushë të Sarteve, edhe në krijimin e fotografisë, emocionet janë element nxitëse, që e shtynë autorin për ngjizjen e saj. Këtu fjala rreh për fotografët të cilët mëtojnë të krijojnë foto arti. Atyre, aparati iu është shtuar si një gjymtyrë dhe fotografimi si shqisë me të cilën janë përherë në “gjueti” a “peshkim” të pamjeve që do të përngrijnë (fiksojnë) në pelikolën e filmit e më pas në letrën fotografike. Veçantia, po të shprehemi në mënyrë figurative, qëndron në pozitjen gjithë ditës me varkën e tyre, aparatin, në detin e fotografisë. Prej çastit kur imazhi godet syrin dhe mendjen e fotografit deri sa fotoja bëhet gati për të “parakaluar” në ekspozitë ose të paraqitet në album, kryhen disa procese krijuese mendore e teknike. Pa dyshim, çdo kohëndarje e këtyre proceseve shoqërohet me emocione vetjake të ndryshme.

Para se të shkrepet aparati, ajo që ndodhet përballë fotografit, nëpërmjet syrit, “përtpet” nga vetëdija dhe ndërdija e njeriut. Kur këto të dyja, barabar ose njera më shumë se tjetra bien në një “mendje” se tanimë gjithçka është në rregull, menjëherë ato i u hapin “shtegun” përrudhjeve të mëtejshme. Aparati shtrëngohet pas fytyrës, frymëmarja mbahet, trupi ngrin, e nga sistemi qendror nervor urdhërohet ajo lëvizja klasike e gishtit tregues mbi butonin e shkrepjes. Ndërkaq, shembëllimi në të dhjetat e sekondës, ose edhe shumë më pak, kalon (si në vrimë të gjilpërës) nëpër objektiv dhe ndehet përgjithmonë mbi film. Nga ky nëpërkallim atij i humbet një përmasë (thellësia) dhe shndërohet kështu në një figurë të rafshët, pra dypërmasore.

Shtypja e mollëzës së gishtit tregues mbi butonin e shkrepjes i jep fund trysnisë ndjesore të krijuar nga imazhi mbi fotografinë, e në atë lëvizje mekanike (mish-metal) kalon si “shkrepje rrufeje” një rrymë e lartë emocionale, a ndoshta nje tension i ndjeshëm bioelektrik. Vet fjala “shkrep” (aparatin), që simbolizon fotografimin, në gjuhën shqipe përdoret edhe për rrufenë, si dhe për daljen e shkëndijave kur përplasen dy sende. Kjo fjalë ka një tingëllimë shumë të afërt me zhurmërinë e obturatorit gjatë fotografimit (shkrap) dhe sipas fjalorit të termave letrare, përbën një onomatope të pastër. Pra, një proces teknik, bazë për një

krijim artistik, emërtohet në shqip me një figurë letrare. Ndoshta kjo përbën një “epërsi” të gjuhës tonë ndaj të tjerave në lëm të fotografisë Këtu, merita i përket atij fotografi shqiptar me shpirt poeti, deri tani i panjohur, aty nga fillimi i shekullit XX, i cili e shqiptoi për herë të parë. Më pas me këmbëngulje ai e përdori në vijimësi në vend të ndonjë fjale të huaj, siç ndodhte e ndodh rëndom. Në rastin e fotografimit, dy subjektet janë: Njeriu dhe mjeti (fotografi dhe aparati) dhe xixat ose shkëndijat janë fotografitë, fryt i mendimit dhe i veprimit të të dyve. Shkrepja shoqërohet nga zhurma (e ëmbël për fotografën) e hapje-mbylljes së obturatorit që tejçon nga veshi në tru kumtin se shembëllesa “u prangos”. Pra, edhe nje shqisë më tepër, ajo e dëgjimit, merr pjesë në procesin e fotografimit, çka natyrshëm shton emocionet.

Pas këtij çasti, të rrahurat e zemrës së fotografit ulen disa, por pa u normalizuar, sepse nuk është përpunuar fotoja në laborator, dhe ai nuk e ka prekur krijimin e tij, fotografinë, madje as me shikim. Ndonëse përbën një proces teknik, ai është shumë i rëndësishëm. Stampimi në laborator, ku fotografia përfundohet (teknikisht) gjithashtu ka emocionet e tij. Letra e ndjeshme, e bardhë në dukje, pasi ka kaluar nga zmadhuesi është “mbarsur” me shembëllimin. Në vaskën e zhvilluesit, ajo dalngadalë e pjesë-pjesë, ngjyroset nën veprimin e reaguesve kimike. Kështu nis “mpiksja” e fotografisë. Fotografi, tanimë i bërë vetëm sy, vëren si formohen, të themi flokët, vetullat, sytë e pjesë të tjera të një portreti, e kur mbaron ravijëzimi, ai heton se sa ia ka arritur qëllimit me këtë foto. Kjo kohështrirje ndjesiplotë ha disa minuta të “mëdha” e duhet prituri të formëzohen edhe fotot e tjera që të dalë në përfundime për punën fillimisht teknike.

Për natyrën e mënjëanshme të artit fotografik, puna nuk mbaron me stampimin në letër të imazhit. Kjo sepse, në ndryshim nga piktori, i cili pasi e mbaron veprën, vendos datën dhe emrin dhe le mënjanë penelin, fotografi duhet të bëjë zgjedhjen e më të mirës ndër disa që ka përpara. Me këtë kuptojmë përcaktimin e fotografisë përfaqësuese, ngaqë për veçoritë e këtij arti, rregullisht për çdo pamje aparati nuk shkrepet vetëm një herë (përjashtohen

rastet kur imazhi që po fotoqrafohet është në çastet e konsumimit të tij përfundimtar). Duke pasur në duar shumë foto për të njëjtën pamje a subjekt (me ndryshime të parametrave teknikë, si këndmarrja, shkallët e diafragmës, fokusimit dhe kohës, por që ndryshojnë vlerën e fotos), fotografi duhet të përveçojë atë më të bukurën, më të goditurën, gjithmonë sipas tij. E këtu nuk ka matematikë, sepse vepron më shumë ndërdija dhe ai e ka të vështirë të lërë mënjanë disa foto e të mbajë vetëm një, mbasi të gjithë gishtat e dorës dhembnin njësoj. Pas disa mëdyshjesh ai duhet të vendosi, e tani rahatet e zemrës përsëri shpeshohen. Kjo përzgjedhje kërkon shije të hollë artistike dhe shpërfaq kësajsoj nivelin estetik të fotografit. Si të thuash, është një proces teorik ku ndërthuren në përpjestime të papërcaktuara estetika dhe psikologjia e fotografit. Atij tanimë, i duhet “të hedhë dorën e të zgjedhi mollën”, e kjo të jetë e tillë që të nesërmen të mos “e hedhë dorën” sërish. Këtu një peshë të madhe ka edhe gjendja shpirtërore e atij që zgjedh. Fotografia, duke bërë një krahasim figurativ, themi se është rezultante e dy vektorëve, dritës dhe kohës, ose dhe më ndryshe, ajo është si një bimë të cilën e mbjell e para, por e korr e dyta. E para, e domosdoshme për t’u ngjizur fotografia, por e pamjaftueshme për të “qëndruar më këmbë” pa mbështetjen e kohës që është shumë e pamëshirshme dhe e paanshme në përcaktimin e vlerave artistike, çka shfaqet në përballjet me publikun. Koha përbën kushtin që fotografia e mbjell nga drita të “vegjetojë” gjatë, e me këtë nënkuptojmë bashkëjetesën me shikuesin, numërimin e kohës drejt pafundësisë.

Le të kthehemi tek përcaktimi përfundimtar i fotos më të mirë. Kujtojmë se fotografi i madh Gjon Mili, për të arritur te fotografia “ikonë”, “Pikaso duke vizatuar me dritë”, ka qëndruar pranë piktorit të madh me ditë të tëra dhe e ka shkrepur aparatin qindra herë. Me këto fotografi, Mili ka botuar edhe nje album-monografi “Dimensioni i tretë i Pikasos” ku përfshihet pjesa më e madhe e fotove të piktorit, i cili paraqitet duke vizatuar me dritë. Në zgjedhjen e fotos së sipërpërmendur të Milit ka ndikuar veçanërisht intuita e tij artistike dhe mendimi i përgjithshëm ka “nënshkruar” se ai ka goditur në shenjë.

Ndoshta mendohet se me përzgjedhjen e fotos më të mirë shqetësimet e fotografit kanë mbaruar, emocionet janë mpakur e janë normalizuar dhe rahatet e zemrës. Fotoja kërkon emër, dhe këtë e kërkon nga “babai” i saj. Ai duhet ta vrasë përsëri mendjen, t’i rritet adrenalina e të përveshi rishtas mëngët. Këtu përjashtohen rastet kur titullin e ka pasur në dorë para fotografimit dhe pikërisht ai titull e ka nxitur ta bëjë atë foto. Fotografi përpilon një listë titujsh që shkurtohet duke e studiuar deri sa mbetet vetëm ai që autori e vendos ndënjë foto. Kujtojmë fotografinë e njohur të Gegë Marubit me katër shkrimtarët. Në atë kohë fotografi e titulloi thjeshtë, por me shumë kuptim “Dy breza letrarësh”. Ka edhe raste kur fotos i ndryshohet emri nga analizat që i bëhen, si p.sh., fotoja “Kapiteni Mark Raka dhe bajraktari i Shalës” e Kel Marubit, sot në shtyp botohet e emërtuar “Dorëzimi i armëve”. Ndonjëherë fotografët i bien shkurt, sidomos kur kanë mëdyshje dhe ngurime dhe i quajnë fare thatë fotot e tyre “Pa titull”, e kështu edhe me pak “dredhi”, i detyrojnë shikuesit të ngulen e të përsiatin gjatë para tyre.

Tani fotografia është gati dhe autori e vendos para publikut në ekspozitë, në album, në shtypin e shkruar në median elektronike, në rastet më fatlume në muze (“mejdane” e fotografisë) dhe pret gjykimin e shikuesve. Kjo drejtëz kohore është pafundësisht e gjatë dhe përcjell tek autori përshtypjet e shikuesve të cilat lindin ose rilindin emocione të dikurshme, por edhe të paprovuara. Përmendim se edhe sot vlerësohen me nota të ndryshme, gjithmonë “kaluese”, fotografi që janë realizuar dhjetra vjet më parë.

Këto na bëjnë të mendojmë se emocionet e fotografit janë të shumta, të mënjanshme dhe të vazhdueshme ashtu sic ndodh natyrshëm me artistin në procesin e krijimit të veprave artistike. Por a nuk ja vlen që të jetohe me emocione të tilla ?!

Tirane, 2005



Libri “Ad infinitum” (Sprova dhe studime) i studiuesit dhe poetit Sadik Bejko, përbën një objekt të rëndësishëm studimi dhe leximi për shumë arsye, pasi libri vjen në duart e lexuesit në një moment kur metodat e studimeve dhe interpretimi i teksteve të krijimit letrar dhe gjurmimet mbi krijimtarinë popullore kanë pengesat e koncepteve në terma dhe një lloj shkërbimi të dijeve nga fusha të ndryshme.

Dr. Sadik Bejko nga niveli shkencor i dijes filologjike është lektor i Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Histori-Filologjisë për shumë kohë, çfarë tregon, se çështjet që libri “**Ad infinitum**” trajton, qofshin si sprova, qofshin si studime, por edhe si synose për trajtime dhe më të gjerësishme të llojeve, përbëjnë një punë analitike të nivelit universitar-estetik, është poet me një zë dhe profil të veçantë, por edhe një kulturolog i rëndësishëm i kulturës kombëtare dhe të huaj, ku spikat një absorbim i veçantë dhe interpretim jashtë klisheve.

Libri në fjalë ka një përzgjedhje të qëlluar dhe emblematike prurjesh të profileve dhe çështjes së studimit apo hulumtimit, që letërsia artistike apo poezia popullore i afron një mendjeje hulumtuese, që të baresë dhe të gjejë vend për perceptimet simboliko-psikoanalitike, idetë, opinionin dhe mënyrën e leximit të tij mbi fundamente të rëndësishme të kulturave dhe veprave të shkruara herët dhe me një diversitet leximi nëpër kohë. Madje, çështjet e diversitetit të leximeve në letërsi, duket se përbëjnë dhe një nga profilet më të kërkuara në ese- në mbi estetikën dhe ontologjinë e leximit në dijet bashkëkohore estetike-filologjike.

Parë në aspektin vertikal, një “evidencë” e rëndësishme përmes të cilës autori kërkon t’i zbulojë zgjatimet e kohërave të errëta, siç është etnopsikologjia e popullit shqiptar, por edhe horizontet (dritën që ato mëtojnë në gjendjet vektoriale) drejt të cilëve janë orientuar udhëtimet e mjaft profileve poetike dhe fushave të tjera të lëvrimit të dijes dhe artit të krijimit, libri i dr. Bejkos ngërthen një total-kohë letrare, e cila lidhet me agnostikën e njohjes, por edhe pranisë së artit, kryesisht në realitetin letrar shqiptar.

Përmes një gjendjeje sizmologjike përjetimi shpirtëror prej poeti, por edhe ndjesie të thellë ontologjike, një shqisë e zgjuar në të gjithë refleksionet e librit “**Ad infinitum**” (- deri në pafundësi), e thënë ndryshe, studiuesi Sadik Bejko “prish” kufijtë e “arsyes”, së komunikimit normal, shprish gardhet dhe kërkon të receptojë kumtin, pasi kumti është i aftë ta kapërcejë historiken, zërin, të kufijshmen, atë që shihet, normalen, sepse në të shumtën e herës ai vjen përmes një gjendjeje psikoanalitike (psikoanaliza), një lloj leximi i integruar që herët në letërsi. Kjo mënyrë leximi krijon dritare të vogla nëpër kohë dhe tekste që janë “rrumbullakosur” për arsye të ndryshme në lexim, interpretim dhe refleksione idesh, konceptesh dhe “relacionesh” të tjera që arrin të krijojë një tekst.

Libri “*Ad infinitum*”, i “sigluar” si një gjendje e brendshme dhe meditimi e autorit është një udhëtim me hapa të ngadaltë nëpër bujtinat dhe kullat e afërta dhe të largëta të kulturës popullore shqiptare, pasi studiuesit i pëlqen të qëndrojnë gjatë si bujtës, të grindet me gurët e kangjellat e frëngjive, që i duken të vogla për të parë përtej kohës reale, të hakërrehet mbi “hieroglifet” që krijohen nga vizatimet e kumteve për vajet e gazet, për vdekjen e kreshnikëve, ai do të flasë të meditojë, të shohë nën diell e hënë, nën tokë e mbi tokë plagë, gjëma, teshtima e kollë të thata nëpër kohë, pse shpirti krijues lë shenjat e veta nëpër kohë, shenja që s’i zhduk apo rropos dot qoftë dhe apokalipsi.

I ndarë në pesë pjesë, që për nga fillim-rugëtimi i studiuesit, vjen nga “përtej”- koha reale apo nga zonat e errësirës të nën-kohës, për të ardhur deri në ditët tona, një udhëtim që ka zonën e vet të paprekshme, siç janë ca gjëra të paprekshme në mbijetesën e ekzistencës e çfarëdollojshme qoftë ajo. Libri “*Ad infinitum*” është po ashtu një udhëtim somnambul për të ardhur dalëngadalë dhe autori të ikë prej mjegullave dhe tistit të moteve në Lugjet e Verdha e në 24 prerje profilesh autorësh, epokash, krijimesh popullore, kohët dhe sinkretizmi, mitizmi dhe paganizmi rrinë mjaft mirë në eshtra dhe skelete historike, për të ndaluar tek autori Bashkim Shehu, një autor i cili tërheq në metaforën e krijimit herë një “portë kështjelle” e herë hedh një guralec në një masë të rrafshët liqenore, që sajton rrathë mbi sipërfaqe, siç sajohen mjegullat nëpër epokat dhe rrëfimet e lashta, të cilët dalin nga këto mjegulla të plagosur dhe me shumë pjesë të tyre të rroposura nën kohë dhe ndryshk.

Nga Homeri, baladat, “Vaji i Ajkunës”, zgjatimet homeriko-biblike që takonin në motet tona Lefter Çipën e Bregut, Gilgameshin mes Perëndisë e tokës; pastaj në epokën e shkrimit dhe krijimit shqip të shekujve më vonë

Sadik Bejko në shtegtimin letrar “Ad Infinitum”

Prof. dr. Bardhosh Gaçe

deri në dritën e shekullit të kaluar nga Budi, De Rada, Shiroka emblematic, epi Naim Frashëri, Mjeda i trazimeve të thella në detin që dukej i qetë në sipërfaqe, Milosao mes qiellit e tokës, ku Perëndia përpigjet të gjejë shëmbëllimin e vet në tokë, Noli që përpigjet të sjellë me një barrë të rëndë shpirtit dhe supeve Shekspirin-total, njeriu poet si Fishta, që u përpoq të krijojë atdheun në sinorët e tij të lashtë; kohën me njerëzit, ku u duk dhe shfaq shprishja e “gardhit të artë” të perëndive, prej njeriut, që duket se e “lexuan” dhe ia ndjenë konvulsionet të parët poetët, si: Poradeci, Kuteli, Migjeni, Spasse.

Koha e shfaqit fytyrën e vet në letërsinë e kohës; me krijimin e një atdheu të çuditshëm, i cili nuk vdes kurrë, si një tokë ku mbillen lisa e qiparis epokë pas epoke, përmes prekjës së dhimbjes së moçme si në balada të Dushko Vetmos, Llluka Perronen, e një dore të artë që qep plagët e thella si Camaj, i cili kudo iku e mbajti atdheun mbi shpinë. Koha e pestë e librit “*Ad infinitum*”, ku poezia dhe arti diktoi një plagë tragjike, ndoshta nga tragjikët e mëdhenj me atë mbijetesën e metaforës së moskuptimit, si dramë e tragjedi të Laokoontit në qëmtime të imta ekzistenciale të autorit nga Dhori Qiriaz, Ismail Kadare, Vath Koreshi, Frederik Reshpja, Ali Podrimja e deri te Bashkim Shehu.

Ky është relievi dhe mozaiku ekzistencial, ku natyrisht kohët mund të maten me orën e Mujit e Halilit, ndërsa në pikturën e tij ka një surealizëm të moçëm, ndoshta kur piktura nuk kishte lindur ende, veçse bridhte para syve të njeriut pagan pa një konvencion të qëndrueshëm. Autori një eksplorues dhe meditues i pa-nxituar, herë asket e herë demiurg, na ka njoftuar që në krye të herës se si e ka raportin me krijimin, qoftë atë popullor a qoftë atë të kultivuar, kur shkruan: “*Nga ana ime, para tekstit përkulem, para baladave prej vetiu dua të jem fëmijëror. Në këtë pikë jam pak reaksionar, jam mitik dhe fanatik, jo çmitizues. Jam mjegullor, jo racional. Nuk jam mosbesues buzëhollë ndaj tekstit të baladave. Nuk e dua racionalitetin në një tekst dehës, në një melodi që rreh të të shkundë emocionalisht me një mesazh gati të një tmerri kozmik, me gjëmën e një morti të pashpjeguar, gjëmë e cila nuk mban ndonjë ngjyrim social a shkas tokësor. Gjëmë si gjurmët me shkrepimë e dritë të një meteori verbues që bie nga lart. Dhe të djeg, të përvëlön.*”, për ta rithënë dhe në një formë më ekselente, gati prej krijuesi:

“*Besoq që një stih, një gjarpër, helmoi djemtë*

e shtëpisë së Dhoqinës... Pra, e lexoj baladën (si fëmijë) që të mrekullohem, jo të mendohem. Në përrallë thuhet: Ec e ec kaptuar shtatë male... dhe e gjetën të Bukurën e Dheut...” Pra, në një tekst të ngjeshur komunikues dhe si një metaforë që ndihmon në leximin dhe raportin që studiuesi dhe “lexuesi” ekselent i shpirtit gëlues të njërit nga popujt më të vjetër të Ballkanit, dhe pse me shumë golle të errëta, ka me këtë pasuri, duke na njoftuar se ka pasur vërtetë Muj e Halil, Ajkunë dhe Omer, Dhoqinë dhe Konstandin, dhe kjo gjendje e çuditshme e justifikon asketizmin dhe një dozë të dukshme demiurgiteti, që e përshkon këtë raport të tij jo vetëm në baladë, një krijim popullor që për shumë syresh afron mjaft me artin e kultivuar, për detajet, estetizimin dhe raportin me personazhet, por edhe si ai i përulet dhe mbetet brenda këtyre gjendjeve.

Raportet dhe komunikimet estetike veçmas, bashkojnë dhe ndajnë gjendje, koncepte dhe komunikime, për shkakun se letërsia (libri në fjalë është një raport konvencional me letërsinë në gjithë qasjet që pleksin një metaforë të çuditshme “deri” në pafundësi,... d.m.th. të një lirie të pakufi, e rrezikuar gjithmonë për të ikur nga orbita, pse për të prekur kufirin ekstrem të artë) është e ndërtuar mbi gjendje të çuditshme meteorike, dhe pse “*Ad infinitum*” është përtej letërsisë, duke qenë se në të gjithë refleksionet e tij lëviz një formë ontologjike, një udhëtim i ndërtuar dhe “kushtëzuar” nga gjendja. E shfaqur më së miri me petka murgu, që ia lejojnë të hyjë në portat e Parajsës, por edhe Purgatorit, 24 profilet anonime-autoriale propozojnë një lexim përmes qenies, procedimi më intim që njeriu mund të krijojë me gjërat dhe abstragimet mbi atë që s’e prek dot.

Nuk mund të mungonte themeli, etnologjia hyjnore-sinkretike e ekzistencës, që më mirë se “Vaji i Ajkunës” nuk mund ta bëjë asgjë tjetër, kohë kur raportet matriarkat-patriarkat janë “hëpërhë”, një manual gjithë ngjyrësh, gjithë-kohësh, ku raporti njerëzor me vdekjen, Perëndinë, të përjetshmen, me të përkohshmen, të njeriut me super-njeriun, të përkohshmen me të përjetshmen, ku dhimbja sfidon qielloren, mbi toka i çon kumte nën tokës, ndërsa kjo e fundit nuk i kthen sinjale, përmes vajit epik-legjendar të Ajkunës për Omerin e vvarë, me armikun dhe varrosur në Lugjet e Verdha pa e parë sytë e nënës, sipas kumtit që përcjell legjenda, do t’i hiqte madhësinë vdekjes së tij.

Përzjerja hyjnore me atë afër njerëzore,



siç shkruan dr. Sadik Bejko: “*Ajkuna e flakur jashtë shtëpie prej Mujit që në klithmat e para të vajtimit, nisat e vetme natën (qyqe vetëm) dhe mbërrin te varri i djalit në Lugjet e Verdha*” nën një dekor madhështor, ku “... *pamja është e përmasave planetare: njeriu, nëna në dhembjen për fëmijën e humbur, në njërën anë dhe hëna, yjet, lugjet, pyjet, ahët, orët dhe zanat në krah të saj, në anën tjetër.*”, janë një fuqi e krijuar brenda qenies, për ta besuar fuqinë që krijojnë dhimbja për t’i bindur hënën dhe yjet të dialogojnë apo t’i “lëshojnë” rrugën Ajkunës. Në thelb, ky është një lexim ekselent, i kësaj marrëdhënieje nënë e bir, që udhëton me këtë fuqi nga kohët e mugëta. Dr. Bejko në pjesën më të madhe i ikën tekstit të epikës legjendare, për të përcjellë një extra, gjendje, për ta bërë të prekshme vdekjen pikërisht përmes legjendës së saj.


Sa shekuj mban brenda vetes Polifonia e Bregut, nga zëri i parë: “... *që është Deti, dallga, është ai burri që tregon, që rrëfen me një energji gjerësisht të thellë, sepse ka çfarë të thotë...*”, te zëri i dytë: “... *është zëri që mbështet të parin. Zëri që pohon, por edhe që mediton. Janë hijet e ajrit që bien me jehonë në logorinë e honeve të grykave të Akroerauneve...*” pastaj zëri i tretë: “... *ky është zjarri. Një zë jashtë njerëzor. Dhe fytyra e atij që e shpreh, e shpërthe, bëhet i tillë. Mpihet si çeliku në zjarr.*”, për të ardhur apo mbërritur tek isoja: “... *zëri i katërt është. Toka, është dheu që bie si guna mbi supet e shekujve, bie si gruaja mbi trupin e mërdhirë të atij që dallgët e hedhin pa frymë në breg...*”, duke parashtruar një sy-hedhje nëpër shekuj (sa kohë e ngjarje, njerëz e dhimbje ka nga njëri zë te tjetri?!), për të ardhur te bardët e kësaj perle të përjetshme të Bregut të Labërisë Neço Muka e Lefter Çipa, që gjallojnë si fuqi dhe ekzistencë brenda shpirtit të autorit.

Në fakt, pavarësisht çdo lloj leximi që mund t’i bësh librit me sprova dhe studime “*Ad infinitum*” të dr. Sadik Bejkos, hulumtimet, zbulimet, koherencat, shtegtimet disa llojesh të autorit, në gjithë rastet duke iu shmangur klisheve të mëparshme, lidhen me qenien dhe dëshminë, një lloj identifikimi. Në këto lloj studimesh apo tendencash për të depërtuar thellë fundamenteve të kulturës së një populli, qoftë duke medituar, madje dhe përmes një gjendje somnambul, lidhet me identifikimin. Balada e njohur shqiptare “Konstandini dhe Dhoqina”, në fund të fundit përmes një udhëtimi somnambulik kërkon të krijojë referimin e një identifikimi, që lidhet me një tipar identiteti, ndërsa, mënyra si e shpërfaq balada këtë është unike, ku nuk mungojnë as fryma qiellore, as ajo tokësore-historike, as irealiteti dhe asnjë praktikë që ngërthen hipoteza të ndryshme.

Budi, njëri nga katër “B”-të e viteve 1600, me të drejtë konsiderohet si poeti i parë në poezinë shqipe, që në kontekstin e raporteve që kultura kombëtare shqiptare vendos me kulturat e tjera, ka një racionalitet të çuditshëm përmes një shqyrtese fundamentale, temën e vdekjes. Raporti i njerëzve dhe shoqërive me vdekjen, në historinë e qytetërimeve është ndër më të rëndësishmit, në fund të fundit është një qëndrim me shumë të dhëna fundamentale mbi besimin, kanonet, gjuhën, shpjegimin e saj.

Poezia “**Mortja**” e Budit është një visar për të kuptuar dhembjen, për të cilën dr. Bejko shkruan: “*Vjersha përcjell me dhembje të thellë fatalitetin e vdekjes, karshi madhësisë (së rreme) njerëzore nën këtë diell. Poeti i drejtohet përvojës sonë të drejtpërdrejtë, por edhe asaj historike. Lënda dhe fryma e poezisë buron nga të dyja Dhjatat...*”, për të arritur te mesazhi, që të kujton porosinë e profetit Jeremia, i cili këshillon, se njeriu nuk duhet të lëvdohet nga pasuria a pushteti, por me mirësinë, ushtrimin e drejtësisë etj., duke i dhënë asaj një aktualitet universal, aq më tepër kur e vendos atë përballë poezisë së Vilonit, në vitet 1400, të titulluar “*Dhjata e madhe*”, ku ajo që bën përshtypje përkundër shtrimit të çështjes nga ajo personale tek e përgjithshme, Budi reflekton idenë e mëshirës hyjnore, duke e bërë poezinë “*Mortja*” një hymn ku shkëndijonte dhe gjuha shqipe.

Për shumë arsye, në udhëtimin ontologjik të autorit në arealin më emblematic të raporteve të krijesis me qenien, Fishta është i pashmangshëm, ai lidhet me kombin (qenësinë më sublime të identitetit me fije të shumta, që nga ata më baziket etnologjinë e tij të lashtë deri te besimi).



Dr. Bejko e ka zbuluar Fishtën përmes një metafore emblematike, ekzistenciale, e cila syresh konvergon shkëlqyer krijimtarinë artistike të tij, veçmas “Lahutën...”, në të cilën ka vend për mitet, historinë, luftërat, besimin, njerëzit, lashtësinë, mbijetesën, racën dhe genin, konceptin fondamental të territorit, për të vdekurit dhe të gjallët. Kështu për klerikun dhe njeriun e iluminuar në dije e kulturë, politikan dhe orator, debatues dhe zë prej qytetari, ai shkruan: *“Me këto cilësi, ai (Fishta) e kishte vizatuar veten si një karakter i madh, një karakter referencial. Etnosi, kredibiliteti, karakteri në këto raste, si pasuri e një personi, i kalojnë një kohë, një komuniteti, një etnie apo fytyrës në formim të një shteti të ri.”*, ku spikat dukshëm malësori i vizatuar prej tij si një pasuri kombëtare. At Fishta kishte bërë detyrën e shenjtë për gjuhën, ndërsa në marrëdhënie dhe vëmendje me klerikët e tjerë kishin mbledhur Eposin e Kreshnikëve, ashtu siç kishte përndritur në gjithë të vërtetën e tyre luftëtarë të kohës.

Sipëran, elegant, brenda dhe jashtë kohës (një kohëprerje e çuditshme, madje misterioze) në *“Ad infinitum”* në këtë lloj pafundësie, për natyrën dhe metaforën që zakonisht Sadik Bejko ndërton në komunikimet eistike nuk mungon Poradeci. Në fakt Poradeci nuk i ka munguar asnjëherë frymës ekzistenciale të artit apo poezisë, pavarësisht shfaqjes së tij, duke qenë një ikanak i çuditshëm dhe i pranishëm me mosqenien e tij. Rrallë poetë pleksën raporte të tilla ku ekstremet “puthen”.

Shqyrtesa *“Shënime për artin e Poradecit”*, ndër nyjëtimet për të do të veçonim: *“Poet me frymëzim sipëran, i cili lëndën që prek e kthen në material fisnik, në bukuri të shkallës më të lartë”*, duke qenë larg politikës dhe që përmes raporteve të dukshme në poezi, si: *“Dashuria dhe vasha”, “Gjuha dhe detaji”, “Ngjyra”, “Poezia gjendje”* dhe *“E bukura- tragjika”*, ai krijoi shëmbëllimin e tij që nuk e kishte askush, për të cilin Bejko shkruan: *“Mund të thuhet se, sipas tij (Lasgushit, shënimi im B.G.), detyra e artistit ishte të punojë për luksin, për të tepërtën, për të bukurën, për të mosekzistuarën, “për të moskuvenduarën”, që buron nga një instikt i lashtë për të krijuar një realitet tjetër që vetëm arti mund ta bëjë.*

Ndoshta Migjeni nuk do të ishte ai që u bë nëse jeta nuk do të silllej e vrazhdë, e pabesë, e pamëshirshme dhe refuzuese ndaj tij: familja e varfër deri në ekstrem, e ardhur në Shkodër, pesë vjeçar i vdes e ëma, tetëmbëdhjetë vjeç i vdes i ati, pas babait, një vit më vonë i vdes i vëllai, pjesa tjetër e familjes e shpërndarë (ai nën kujdesin e dajave), në një qytet si Shkodra, ai refuzon të bëhet klerik, ndërsa ëndërron të shkollohet për letërsi në Itali, kurse kulturën qytetare e kishte marrë në Shkodër, si element dhe i identitetit të tij qytetar.

Dr. Bejko përveç atë që Migjeni është në profilin e tij prej poeti dhe prozatori, të cilin e krijoi duke ecur me vdekjen për dore, për shkakun e agravuar të turbekulozit, arrin të sjellë një kontrast të thellë, madje atë ndjenjën zotëruese të tij në personalitet, pasi Migjeni nxënës shkollë *“... ishte tenori i parë në korin e kishës,... për vite me radhë liturgjinë në kishën ortodokse, një liturgji tri-katër orë të gjatë, me melodi bizantine të afta që të modelojnë muzikalisht edhe prozën e ungjijve, dhe psalmet biblike...”* nuk mjaftuan për ta larguar nga realiteti, ku krijoi raportin fondamental me ekzistencën, pasi *“... si shkrimtar ai është tërësisht shqiptar dhe ndër më të mirët autorë të gjuhës shqipe”*, një letërsie realiste kritike dhe pse i ushqyer me teologji.

Të gjithë atë që pa e përjetoi lidhej me thellësinë teologjike, por duke qenë një shkrimtar qyteti, në të shfaqet ajo “thatësira biblike”, duke i dhënë asaj një theks social, me të cilin krijoi universin migjenian. Ndoshta raporti që ka krijuar studiuesi, duke zbuluar Migjenin është edhe udhëtimi më ekzistencial në libër, për shkakun e asaj që të afron Migjeni, arti i tij, tragjika dhe dhimbja në jetë dhe art, revolta dhe pranimi i fatalitetit etj. Studiuesi në formulimin e “yllit dhe dritës” me të cilin shkëlqen Migjeni shkruan: *“...filozofikisht Migjeni është një njeri në kapërcyell. Ai u nda racionalisht nga kisha si institucion, që me misterin dhe traditën e ritit pranonte prapësitë e kësaj bote, madje me tërheqjen e saj në mister e në rit, jo drejtpërdrejt, u ndihmonte atyre.”*

Dushko Vetmon dhe Martin Camajn i bën bashkë mungesa e atdheut, i pari prej disa shekujsh një mungesë e shtresuar ndër breza, ndërsa i dyti nga mesi i shekullit të XX. Arbëreshët arritën dhe gjetën mjete dhe forma të ndryshme për ta krijuar atdheun, ku natyrisht një rol të rëndësishëm luajti arti, ndërsa Camaj i vetëm, në miqësinë e të tjerëve, që dhe atyre u mungonte atdheu, e krijoi vetëm me art, me poezi dhe ndonjë lloj tjetër të krijimtarisë atdheun.

Arbëreshët, pjesa më e madhe e shkrimtarëve dhe poetëve shërbyen priftërinj,

misionarë, të cilët e kishin trashëguar ndër shekuj, njëri prej të cilëve Frangjik Solano (alias Dushko Vetmo) gati të gjithë krijimtarinë e tij e lidhi me një lloj ekzistence të brendshme që e lidhte me atdheun, përmes një forme ekzistenciale. *“Burbuqe t’egra”* është njëri prej librave të tij, sublim që lidhet me këtë lloj ekzistence, për të cilin dr. Bejko shkruan: *“Shkurrja e rrëgjuar në vite e trëndafilut arbëresh po celte burbuqe pas një dimri të gjatë heshtjeje, pas goditjes që mori kultura arbëreshe dhe të gjitha minorancat e tjera nga regjimi fashist.”*, ku Frasnitën e famshme që zë vend në pjesën më të madhe të krijimtarisë e bëri një targë që e mbante në shpinë më vete, pasi Frasnita është një vend gurë gëlqerorë, frashër, hithra, mëllaga, sfaka e barëra, ndërsa ai një Dushko i lindur në truallin kockë e gurë arbëresh, ndërsa ai Vetmo, një *“filiz i shkëmbit Vetmo, ujë në tokë të paktë, një plasë shkëmbi, në dheun e drurëve të selvisë... (Dushko Vetmo... dushk në atdheun e Selvive të Arbërisë)”*. Ndërsa Camaj i vetmuar do të udhëtonte nëpër honet perëndimore me poezinë *“Dritë malësore”* një monument tragjik, siç shkruan Bejko, ku fjalët dhe imazhet ngjeshen fort në thellësinë e saj, për të zënë sa më pak vend, si një torbë udhëtimi, ku i duhet t’i fusë të gjitha rrobat dhe gjërat.

Ndoshta libri *“Gediche”* është libri më tipik i tij që mbart trishtimin e një të mërguari pa kthim në atdheun e tij, një trishtim që jeton brenda tij, si një shërbesë dhimbjeje për ata që nuk i sheh, në të cilin lëvrijnë fjalët *“vetmi”* dhe *“vdekje”*, ndërsa pjesën tjetër të kontaktit me atdheun Camaj e bëri në mënyrën më ekselente, më bukur të mundshme përmes librave të shkruar. Temali i tij u kthye në një total-letërsi, total-ekzistencë në artin e Camajit, përmes të cilëve ai e deshi atdheun, pa u marrë me gjëra të tjera, të cilat i konsideronte kotësira, atdheu duhet në këtë mënyrë, mësonte Camaj.

Studiuesit Sadik Bejko, i ka shërbyer si një parabolë, dhe një arsye e mjaftueshme për të gërmuar në estetikën e thellë të Kadaresë refleksioni i gjerësishtëm dhe i imët që ka bërë më herët se në këtë libër për poezinë e Ismail Kadaresë, e shkruar që në vitin 1957, poezia me titull *“Vjeshhtë tiranase”*, ku vargu *“Pa formë është qielli si tru idioti...”*, që ngjan me një fill të hollë, shumë të hollë, që s’u këput kurrë, për të cilën një nga kritikët e kohës David Samojllloi do të shkruante në parathënien e vëllimit “Lirika”, se Kadare një çunak i imët dhe i ri fare *“... ka ndikime nga modernizmi perëndimor.”* Disa nga poezitë e tij do të ishin bërthamat e veprave të ardhshme, si “Rrugët e Moskës” për romanin “Muzgu i perëndive të stepës”, “Piramida e Keopsit” për romanin “Piramida”, poezia “Kali i Trojës” për romanin “Përbindëshi” etj.

Duke qenë ndoshta shkrimtari dhe poeti i vetëm i viteve ’60, qytetar, Kadareja arriti të “krijojë” pak liri në kushtet e censurës, për të cilën autori mendon se poeti ka përdorur mjeshtërisht paradigmat simbolike dhe sinektodike të *“kohëve për kohën”* apo të *“atyre për këtë”*, që ishin të vështira për ta vrarë kalorësin e thirrur në gosti, siç shtjellon paradigma e novelës “Kalorësi me skifter”, i cili arriti ta kalojë me shumë finesë festën e vdekjes.

Ali Podrimja e bëri dhimbjen për djalin që s’arriti të jetojë dhe përtej dhimbjes dhe dëshpërimit epik të poetit, një dhimbje sipërore, një vajtim i gjatë, që nuk do të shuhet kurrë sa të jetë në këtë jetë libri *“Lum Lumi”*. Një simbolikë që del nga një shpirt poeti, por në rrethana me një përkatësi shoqërore kombëtare ballkanike, prej të cilës libri merr nivele të ndryshme leximi, si: *“Refuzimi i vdekjes”, “Vizioni biblik”, “Bota shqiptare”* në të dhe *“Mjeshtëria e lartë”* e komunikimit dhe sendërtimit të dhimbjes si ekzistencë. Për ta kuptuar përmasën e dhimbjes së këtij njeriu të vrullshëm, zë-lartë Bejko shkruan, se: *“Aliu ishte shpirti rilindës ardhur në ditët tona, si një maratonmak do të rendte te Guri i Artë i Prevezës, te vajtojcat e Rekës, te kalaja e Ulqinit, te “Mbreti im i vdekur Dioklecian”, do t’u thërriste arbëreshëve: “A ju dëgjon harrimi?”, do të ngjitej në malin e Tomorit e në malin e kishës së Laçit... do të rendte edhe drejt Evropës, ku më së fundi e ndali vrapin, drejt diellit që lind andej nga perëndon”*. Ndërsa vargjet poetike si *“fener i hedhur në një det./ rrugën ta shkruam me kufoma deri në zemra./ të kam pas thanë një ditë: ngado të nisem do të vij te ti...”*, përmbyllin vargun madhështor *“... miq, Kosova/ është gjaku im që nuk falet.”*, që ngjan se i përgjigjet të gjitha dhimbjeve që poeti ndau në poezinë e tij.

Mendoj se libri *“Ad infinitum”* është i rrallë, një libër i gjerësishtëm dhe me një liri të çuditshme që arrin ta kontrollojë vetëm një mendje dhe profil me kulturë të lartë komunikimi i rrafsheve estetike, kulturore, psikologjike dhe ontologjike, siç është poeti dhe esteti Sadik Bejko.

Tiranë-Vlorë, gusht 2025.



Akuarel

Nga Istref Haxhillari

Klientët e përhershëm të barit me emrin e çuditshëm “Lantenso”, sodisnin me nge rrëshqitjen e kohës. Në atë vakt qarkullimi mpakej, ditës i merreshin këmbët, qyteti kridhej në heshtje. Qetësinë e prishte zhurma gërvishtëse e karriqeve me këmbët të shtrembëruara dhe shpinoret të grisura. Ndonëse i freskët e i bollshëm, nuk mbahej pastër, frekuentohej nga njerëz dosido, kryesisht xhepzabazur.

Lalo Koçiu bojalli me shprehje të vazhdueshme habie në fytyrën e ndryshkur nga vitet dhe pija ulej afër dritares ta shihte gruaaja kur kalonte rrugës përbri. Dy gota përballë njëra-tjetrës jepnin përshtypjen se priste dikë që nuk vinte kurrë.

Në tavolinën ngjitur një burrë rreth të gjashtëdhjetave dhe miku i tij porositen pulën e pjekur, ndarë në dy gjysma, kanën me verë të kuqe, shishen e ujit pa gaz. Më i riu, kuqalash dhe energjik me flokë të rralluar, nxitoi nga dyqanet në anën tjetër të rrugës, bleu limona dhe mollë. Tjetri nuk pinte alkool, punë presioni gjaku a diçka e tillë. Pati botuar një roman dhe dy vëllime me proza të shkurtra, po klientët e kafenesë nuk e vrisnin mendjen për kësi punësh. Thjesht e dinin se bënte libra, qe shkrimtar.

-Pa lëng, - u ankua teksa rrekej ta shtrydhte limonin në gotën mbushur përgjysmë me ujë. Qëlloi i fortë, i fishkur.

-Limonët e vjetër janë pa lëng, - i tha, - të rinjtë duan kohë të piqen.

Ky qe poet, thurte vargje moderne, që pëlqeheshin nga lexuesit e rrallë. Pati fituar dy çmime në një revistë të përjavshme të Tiranës, po këtë e dinin vetëm ata të dy. E dinte dhe Lalo Koçiu, që lexonte rregullisht gazetatat. Në të vërtetë vetëm sa u hidhte një sy titujve te libraria e Dritës, përballë Pallatit të Kulturës.

Pronari-kamerier solli porosinë me pamje prej muratori kur mban tulla. Nga veshja e zhubrosura, këpucët, lëvizjet e ngathëta nuk dukej i atij zanati. Buzëqeshja e ngrirë në skajet e buzëve i ngjante një cohe zbërdhulur nga koha.

Ndonëse porositnin të njëjtën meny, gjithnjë harronte diçka.

- S’ka djathë ? - shpotiti shkrimtari.

- Ta marrë dreqi! - u kthye solli pjatën e vogël me djathë të prerë në feta të holla.

Në cep të rrugës u duk gruaaja e Lalo Koçiut. Si padashur hodhi sytë, pa të shoqin, i erdhi zemra në vend. Ai ngriti kokën, i bëri shenjë të ikte.

Pastaj i ra tavolinës me pëllëmbë.

- Dy të tjera, - thirri.

- U bënë shumë, ja gruaaja të kërkoi, - i tha pronari.

- Ajo ka punën e saj, unë timen, ti tënden.

Vuri njërën gotë para, tjetrën në qoshen e përballtë.

- Tani, - tha shkrimtari.

- Jo, shpejt, - kundërshtoi tjetri.

Lalo Koçiu vështroi gotën përkarshi, mermëriti diçka, priti.

Gota s’donte t’ia dinte.

- E fundit po të them, - ngriti zërin, - kurrë

s’më bërë qejfin!

Ajo nuk jepej.

- Më beso, nuk të gënjej më.

- Do t’i lutet edhe dy herë, - shpresoi poeti.

- E fundit, - i tha Lalo Koçiu gotës, - nuk të flas më.

U mendua pak, ngriti të tijën, çukiti gotën e pabindur, piu çerekun. Pa nga rruga, ku u duk si gjithnjë në atë orë, Mane budallai. I gjatë, i dobët, i palarë, rripin e pantallonave shtrënguar deri në fund, sikur donte të vetë mbytej. Shpërfilli Lalo Koçium, i erdhi rrotull tavolinës së shkrimtarëve.

- Ej, shok! - iu drejtua shkrimtarit.

Turbull e dinte, binin kushërinj.

Sapo i vunë në duar pjatën me pjesët e mbetura të pulës, bukën e panisur, gotën me verë, i përlau shpejt e shpejt në këmbë, piu verën, filloi sërish ritin e ecejakeve. Lalo Koçi u rrotullonte kokën sipas trajektores së tij.

U lodh, hodhi sytë nga rruga.

Një vajzë e shëndoshë, gjysmë zbuluar tërhoqi vëmendjen e klientëve. Poeti i ra me bërryl mikut të tij.

- Ç’ ka, - i tha ai me sytë mbi femrën dërdënge.

- U plake!

- Jo aq sa pandeh.

Vajza ndjeu vështimet, drejtoi trupin, eci serbes, pa kthyer kokën. Vithet e kërcyera lëkundeshin nën ritmin e hapit, rripi i kanotierës lidhur për mesi i përkëdhelte të ndenjurat.

- Jo keq, - mermëriti shkrimtari.

- Të pasmet i ke dobësi, - i tha poeti, - punë moshe!

- E vërtetë, pa këtë të fundit.

Mosha ishte pika e tij e dobët.

Stivat e pllakave majolike të Uruç Asamenit mbi trotuar pengonin lëvizjen e njerëzve, kalimtarët detyroheshin të ecnin në radhë njëri pas tjetrit.

- Bashkia nuk punon mirë, - u tha Lalo Koçi u fqinjëve, - trotualet janë mjedise publike.

- Uruç Asameni di ta vërtitë, - tha shkrimtari.

- Paganu nën dorë, - shtoi poeti.

Medituan një copë herë rreth korrupsionit që gërryente themelet e shtetit, pastaj Lalo Koçi u iu kthye gotës.

- Përse mendohesh? Nuk e shikon se u vonova? E pe gruan?

Në anën tjetër të tavolinës heshtje.

- Me fund, - ngriti zërin.

Piu të tijën, u ngrit zbrazti tjetrën më një të kthyer, e la në vendin e mëparshëm, fshiu tërë lezet buzët, thirri kamerierin.

- Edhe nga një, - porositi, - asaj mbushja me majë, ka bërë hile sot.

Kamerieri qeshi nën buzë, ia mbushi siç porositi. Vodka u derdh, skicoi një si hartë të lagësht mbi mbulesë.

- U deh, - tha shkrimtari.

- Përditë njëlloj, si nuk u lodh.

- Ndoshta kujton brengat e vjetra.

- Punon?

- S’më duket të punojë gjëkund.

- Nga i gjen paratë?

- Ka dy djem jashtë.

- Meze nuk merr kurrë.

- Pi me lezet, nuk bën sherr, paganu.

- Do ta ketë një hall, - pranoi poeti.

- Gruan e dëgjon, - tha shkrimtari.

Lalo Koçi u grindej me gotën e pabindur, i binte tavolinës. Ajo lëkundej pak. Pas porosisë së pestë nisi t’i hante geramat, lëvizjet u plogështuan.

Gota lëkundej më pak.

- Po më dëgjoje këtë radhë e mbylлим, - i tha.

Heshtje.

- Fol, vetëm me shenja mezi të kuptoj.

...

Dialogu hyri në fazën finale. Mezi i nxirrte fjalët, rrokëzonte.

Gota karshi nuk lëvizte vendit.

Shkrimtari iu qas në tavolinës së tij.

- Më pëlqen, - tha.

Zakonisht i pashoqërueshëm, vëzhgues i vëmendshëm e i largët, kërshtëria nuk e la.

- Çfarë të pëlqen?

- Si e pi vodkën.

- Mua s’më pëlqen fare.

- Ç’ thua? Pse?

- Përherë humbas, fiton ajo.

- Gota?

- Jo, mendja. Kam qejf të më lërë këtu, të ikë, po nuk e bën asnjëherë.

U ngrit. Te dera e priste gruaaja e merakosur.

Gusht 2025

Kantiku i Parë - Beteja

Humbe në një tërthore terri.
Një arenë e fshehur nga sytë e botës,
vetëm muret e natës dhe të makthit e
nijnin.
Dhe aty, me hap tronditës,
u shfaq demi i padukshëm:
me gjoks prej tymi,
me brirë prej kamash dhimbjeje,
dhe sy që pikonin vdekje.
Ndërsa ti u kape nga brirët e tij si toreador.

Dy vjet të mundonte,
të godiste në brinjë,
të rrëmbente frymën.
E ti, tre e katër herë në muaj,
merrje rrugën për Janinë,
si karvanarët e hershëm
një udhë që mbante erë jod dhe shi
dhe një burbuqe shprese
si bajme në shkurt tej dritares së spitalit.
Analiza, kimioterapi,
rrezatime të digjinin deri në palcë;
e megjithatë qëndroje në këmbë,
duke mbajtur shpirtin me dashuri.

Nuk bërtite.
Nxirje vetëm fjalë të ëmbla,
sikur të flisje ende me nxënësit e tu
në orë letërsie:
përralla, rrëfime,
përkëdhelje fjalësh të harlisura,
ndërsa dhimbja të shqyente kraharorin.

Dhe kur u përkule,
nuk ndjeheshe i mundur.
Ende njomzak si Herkuli mitik
ishe ndeshur me gjarprinjtë e flakes.
kishe kapur fatin prej fyti.

Kantiku i Dytë — Durimi

Si lis në shpatet e Nemërçkës
që e rrëmben nga supet era, gati ta shqyejë
ndërsa ai shtrin rrënjët më thellë,
ashtu qëndroje.

Ditët shkonin ngadalë,
numëroje pikat e serumit,
hije nga sytë e mjekëve,
dhe korridore të bardha
që kundërmonin erë klor dhe vetmi.

Por ti nuk u theve.
Uleshe në karrigen e pritjes
sikur të ishte bankë shkollore;
nxirrje nga xhepi lapsin,
dhe shkruaje në skajet e mendimit
fjalë që u jepnin forcë të tjerëve rreth teje.

Në netët e spitaleve,
ishe një far prej gjaku e dashurie.
Kushdo që të shikonte,
merrte guxim,
siç merr detari
nga ylli që e udhëheq,
siç ndeshej Odiseu me Poseidonin
zemërak.

Kantiku i Tretë — Heshtja

Fjala jote kishte rrënjë dielli.
E dije kur duhej të flisje
dhe kur të heshtje.
Heshtja jote s'ishte bosh;
ishte det i thellë,
ku dallgëzonin brenda tij
gjithë dhimbjet e botës.

Netëve, kur shuheshin dritat,
nuk kërkoje ngushëllim;
vetëm shikoje murin
sikur pas tij të shihje
shtegun që hapej
nga toka drejt qiellit.

Heshtja jote na mësoi



se betejat e mëdha
nuk fitohen me britma,
por me shtrëngimin e qetë të zemrës,
me një frymëmarrje që duron
ndërsa gjithçka rreth saj shembet.

Vetëm mbajte shikimin të pastër,
që ta kujtojmë ne
si pasqyrë shprese
kur të vijë edhe ora jonë.

Në heshtjen tënde ecte Zoti;
dhe ne ulëm kokën,
jo nga trishtimi,
por nga madhështia.

Kantiku i Katërt — Jetë e vrulltë

Ai lëmsh i zi ishte agresiv
si bombë që shpërndan cifla dhe vret
por nuk shqiptove kurrë fjalë të hidhura.

Endeshe në arenën e errët.
Ai buall i tmerrshëm të godiste pa
mëshirë,
nga goja i shpërthenin flakë
dhe shkëndija nga brirët
ishin flakë nga ai pishtar i mallkuar
që dikur të kishte djegur fytyrën
dhe tani po të digjte shpirtin.

Luftove, nuk e provokove me beze të kuqe
i hodhe petale lulesh
si ato në fletoret shkollore,
në poezi dhe në sytë e studentëve.
Petale të shpirtit tënd të trazuar.

Gjithë jetën tënde ecje për të falur zë drite
që zëri i njeriut të fitonte forcë.
Mësues i ri atëhere nga Lambova e Kryqit
mirrje shtigjet në fundjavë
për të arritur në Poliçan.

Pastaj bëre ato kërcime fantastike
nga Nemerçka arrite në Orosh
në malet e Mirditës
dhe uleshe këmbëkryq në kullat prej guri
ku ndershmëria rrinte krah për krah me
hakmarrjen
dhe gjaku kërkonte gjak
me jetën që dridhej
në dhëmbët bishërorë të një kodi vdekatar.

Gjatë ditëve të tua në spital,
largoje dhimbjet duke sjellë ndërmend të
gjitha këto
fytyra dhe histori të thërrisnin “Na ke
premtuar, mos harro!”
Nuk ishe nga ata që harrojnë
dhe kur armiku i padukshëm të mori

dorën e djathtë,
“Kam dorë tjetër”, the,
dhe vazhdove të punosh me të majtën
për të përfunduar ato histori njerëzore
që ujitën rrënjët e shpresës me gjak.

Kantiku i Pestë — Varroste një copë diell

Kur erdhi ora, s’u dëgjua vaj.
Vetëm një hapje e lehtë
si rrahje krahësh të një harabeli
që gjen udhën drejt qiellit.

Fytyra jote u qetësua,
një frymë që u shua butë,
dhe me të u ndez drita e përjetësisë.

Qyteti u drodh, jo nga tërmeti,
por nga turma që erdhi të të përcjellë.
Nëpër sokakët e Gjirokastrës
jehonte emri yt:
mësues, krijues,
bashkëpunëtor, mik,
Odise i mirësisë.

Nxënës me sy të përlotur,
kolegë me fytyra të ngrysura,
shkrimtarë që njihnin kontributin tënd të
heshtur.
I gjithë qyteti u bë përkujtim.

Arkivoli yt zbriste ngadalë,
dhe dheu i Gjirokastrës
u hap si buzë që puthin.
Kurorat u bënë rrethe zjarri,
dhe heshtja pikonte mbi gurët
si temjan.

Atë ditë,
qyteti nuk përcillte vetëm një njeri.
Varroste një copë nga dielli i vet
dhe mbante ngrohtësinë e tij përjetë.

Kantiku i Gjashtë — Të shtruan udhë drite

Në botën tjetër të dashurit të prisnin.
Babai Akile me shikimim kaltërim deti,
nëna Evelina me buzëqeshje-fanar,
mjeku Anesti me sytë si vesë agu,
dajko Nashua me buzën prej shakaje dhe
kënge,
vogëlushja Evelina me duar si lule.

Të shtruan udhë drite.
Dhe ti, u afrove me hap të qetë,
siç shkoje në shkollën e “Kryqit të shënjtë”
dhe u shtrive në përqaftimin e tyre
pa nxjerrë ankesë.

Kantiku i Shtatë — Nderim

Dhe atëherë u hapën qiejt.
«Më mbani të ngrihem, vëllezër»
jehonte midis yjeve.
«Dalianon» e kapën engjëjt,
dhe «Djemtë e Samarinës»
u bënë vallëzim i përjetshëm.

Poliçani ngriti supet nga krenaria.
Gjirokastra dëgjoi gjithashtu,
dhe shtëpitë e vjetra prej guri
u pajtuan me ritmin.

Nuk kishte më kufi
midis të gjallëve dhe të vdekurve.
Vetëm një zë,
vetëm një flakë,
vetëm kujtimi që s’do të shuhet.

Vëllai im, gjaku im,
Mësues, brumë i tokës Polçanjote,
pusho tani në paqe!

Kantiku i Tetë — Ja vlen të luftosh

Nuk e di nëse do ndërgjegjësohem
ndonjëherë me ikjen tënde.
Çdo mëngjes që lind dielli,
do na përshëndesë buzëqeshja jote.
Çdo natë që Morfeu trazon ëndrrat e
botës,
do na mbështjellë heshtja jote,
si mantel yjesh.

Kujtimi yt nuk është hije;
është rrënjë që na mban drejt,
është lum që ujit thatësirën e zemrave
dhe tokën e shpirtrave.

Kur ecim rrugëve të Gjirokastrës dhe
Janinës,
diku do ndeshim vështtrimin tënd
dhe hapin tend duke shkelur mbi
kalldrëme dhimbjesh;

Dhe ne,
çdo herë që do kujtojmë betejën tënde,
në atë arenë mistike toreadorësh të zinj
do ndjejmë se bota ngrihet brenda nesh,
më e fortë, më njerëzore, më e vërtetë
dhe ja vlen të luftosh për bukurinë e saj.

Kantiku i Nëntë — Lamtumirë

Gruaja jote qëndroi si gur,
por prishi zemrën kur ike:
“Mbahu të rrojmë dhe disa vjet bashkë!”
Fëmijët e tu mbajtën sytë të thatë,
por zemra e tyre u bë det.

Vëllai im, gjaku im,
emri yt nuk do të shuhet.
Në shpirtin tonë është gdhendur,
me dritë ylli që rrëzëllon magjishëm.

Vëllezër dhe të afërm presin kokulur:
– Kthehu pak, të shohim si u shtatua lisi i
dashurisë;
– Hapi sytë, të na thuash amanetin e
fundit;
– Kthehu pak, të na thuash sa të thella i
kanë rrënjët
durimi dhe mirësia ku ti u mbajte.

Por ti kalon pragun,
dhe vetëm hija jote zmadhohet
çuditërisht.

Kantiku i Dhjetë — Rrugë jetime

Poliçani vari degët e pishave dhe rrepet,
Gjirokastra tkuri gurët e kalldremeve,
Janina ngre dallgët e liqenit si shami
lamtumire.
Kudo që shkove, mësues,
le dritë pas teje —
në klasë, në fshat, në mal, në sallat e

promovimeve,
në zemrat e nxënësve që kishin etje për
fjalën e vërtetë.

- Hej, ku është Odisea?
- Në bankën e dijes, aty qëndron ende.
- Ku është mirësia e tij?
- Tek nxënësit që ushqueu me mençuri e buzëqeshje.

Dhe lumi kalon i turbullt,
Urat tranden,
kambanat heshtin,
dhe rrugët mbeten jetimë nga hapi i tij.

Kantiku i Njëmbëdhjetë
— Na e helmojnë jetën

Mbeten jetimë rrugët e botës, vëlla
Se na e helmojnë jetën përditë,
me korona vdekatare e vaksina,
thua se jeta është bar i keq
dhe duhet ta bombardojmë
me hebricide, me atome, bomba e raketa.
Na e helmojnë jetën,
na rrëmbejnë oksigjenin
dhe njeriun e çlërësojnë tmerrësisht, vëlla
na helmojmë atmosferën
na helmojnë çdo qelizë
na vrasin për fitime,
na vrasin me gënjeshtra,
na vrasin me mikrobe
dhe na servirin në tavolinë
nikoqiren e kobzezë vdekjen.

Ata ta injektuan atë lemsh të zi në mushkri
ata injektojnë mikrobe në mushkritë e
botës
që të na paësojnë Oksigjenin.
Po njeriu, ku është njeriu që reziston,
që ngre grushtin!
Toka njohu peshën e fjalës tënde,
të nderoi dhe të pranoi në gji
si farë që nuk kalbet,
por jep fryt të përjetshëm.

Dhe zemrat thërresin kur do vijë
Drejtësia?
Shpirti yt ende digjet,
jo nga dhimbja, por nga drita.
Dhe zemrat tona shtërngohen grusht.

Kantiku i Dymbëdhjetë
— Sa herë të humbasim

Vëllai im, gjaku im,
flakë Pogonite,
mbajte kryqin e rëndë të tokës
dhe tani ecën nëpër yllësi.

Tani fjalët na u bënë të rënda si kolona
tempulli,
të ndezim flakë në erë.
Do na mungosh — si heshtje që djeg.

Do t'i bie numrin tënd në telefon,
si të thërrisja mbrëmjeve të bisedojmë për
letërsinë;
kur ti, me siguri do të jesh duke kuvenduar
me të mëdhenjtë
në verandën hënore të qiellit:
me Ricosin dhe Kadarenë,
me Migjenin dhe Elitin,
dhe gota jote do të ngrihet,
duke u ofruar raki ballë kazani
dhe vilë rrushi nga pjergullat e oborrit
tonë,
që përkujdeseshe për to si të ishin foshnja,
dhe do trokasësh gotat me urim
mençurak.

Dhe ne,
sa herë do ndiejmë se humbasim,
do të kujtojmë ty
dhe do gjejmë sërish orientimin.
Sepse përjetësia nuk është vend;
është tempulli i shpresës
që ngre shtylla mermeri përjetësisht
brenda nesh.



XHEVAIR LLESHI

Shkallët e ëndrrës

tregim

Kishim rënë në gjumë të thellë. Unë dhe im
atë ndjeheshim krejt të mpirë: na dukej
se po bënim një shekull pa vënë gjumë në sy.
Po këto shkallë kush na i bëri dhuratë? Nuk
dimë, bab’. Eh? Si qenka e mundur? Jemi nëpër
mjegull bab’, prandaj... Mjegull? Ç’thua! S’shoh
fare mjegull!

Ky dialog i vjetër më kujtohet dhe unë
s’di ç’bëj. Një çast me pak dritë, si një rreze e
hollë, më solli para syve, fqinjin tim, një njeri
që e quante veten intelektual. Psenë përse e
thërrisnin kështu e mora vesh nga ato shkallë
ëndrrë, që i pashë në gjumin e parë. Ah, të
ngjiteshe nëpër ato shkallë! Them nganjëherë
sesi e kam humbur këtë shans të madh në jetë.
Sigurisht ato ishin shkallë ëndrrë. Isha unë dhe
im atë. Të dy nëpër mjegull. Endeshim dhe nuk
e gjenim dot rrugën. Mos janë gjë të parajsës?
Jooo. Parajsa nuk lëshon shkallë. Ajo të merr
në krahë. Shkallët janë veç për t’u ngjitur. Po
s’di sesi, të holla fort po më dukeshin. Mund të
këputeshin, do të rrëzoheshim e do të thyenim
qafën!...

Duke parë shkallët që rrinin pezull para
syve tanë, foli im atë. E pse të ka mbetur
mendja tek fqinji yt, Zeka? Pse? Po se me të
e shkullon një shishe, pa shih (!) dhe duke
ndenjur te shkallët e shtëpisë. Dhe e di ku është
e keqja bab’? Se kur flet me Zekën ke afër detin
me dallgë, furtunën, pyllin në vjeshtë, çfarëdo
të jetë fjala. E? Vërtet? Paska qenë burrë i
mençur Zeka! Vetëm kur pi e ka këtë. Ai pi
sapo kthehet nga protesta në shtëpi. Që ditën
e parë të pensionit ai ka dalë në shesh, ka varur
një pankartë dhe aty shkruhet: «Bashkoku me
mua! Do të protestojmë kundër qeverisë!»
Zeka kishte qenë profesor universiteti. Pa
titull. I qenë lutur dhe nuk e pat pranuar! E lanë
pastaj në udhën e tij. Dhe Zeka protestonte
edhe në universitet, pa pankartë. Për gjithçka.
Rrinte vetëm mbi shesh. Dhe mendonte. Po
ç’mendonte? Ja, në një nga mbrëmjet tona më
tha se atë ditë kishte protestuar për dashurinë!
E? Qenke kundër dashurisë? Jo, bre! Po sepse
duhej të mendoja sfida që s’i kisha prekur
kurrë. S’po gjeja elementin e bukur. Asaj dite
kishte parë sytë e mëdhenj të një studenteje
që të këpusnin shpirtin dhe rrëzonin kokrra të
mëdha lotësh. Zot, s’kam parë lot ashtu! Dukej
që i buronin nga zemra! Pse ajo po gjente më të
vështirën rrugë? Se dashuria ecën drejt, kokën
lart, të sheh dhe ti i depërton në sy, se...

Po të nesërmen? Për plehrat që
lëshonin rrugës miqtë e mi, aty pranë meje.
Shkarravinat e tyre! Më mbaj mendjen, Zot!
Doja t’i jepja kuptim çdo gjëje që bënim. Po
pastaj? Eh, ka plot leshko që harxhojnë qimet
e kokës për të vajtur te kundërshtimi dhe nuk
ia mbërrijnë kurrë. Një përgjigje e zvarritur
gjatë seminarit apo provimit, more edhe
për hiçmosgjë. Se atë e kemi hak dhe do ta
marrim me vete: asgjënë! Ja, le të marrim ty?,
më pyeste. S’pate asnjë problem? Kisha, sa unë
e di! Dhe nuk e ngrite zërin? Jo. As mendove?
Po pse të mendohesha? Që të kundërshtosh

edhe me mend, për të mos ndodhur prapë
nesër, për të gjetur një rrugë të re! Flasim për
një kohë tjetër, kur edhe mendimet i kishe të
ndaluara! Sot? Eh, ku ka si sot! As vetë nuk e
di se çdo të bëja po të qe edhe *atëherë* kjo e
tanishmja! Mua në protestë më ke, mor bir!
Aty! Përditë. Thonë se kam lajthitur? Ndoshta
edhe ka ndodhur, po megjithatë unë nuk e
kuptoj ende. Po? Sigurisht, edhe për biletat
e urbanit, edhe për çmimet e letrës, edhe për
qeskat plastike! G j i t h ç k a ! Merr vesh, edhe
për pikën e helmit në zarf, edhe për atë!

Pse s’thua, po Zeka paska qenë fenomen!
Dëgjoja se ka qenë burrë i ditur, po me ç’po
më thua, i tillë paska qenë. Një ditë, bab’
kam qeshur me lot. Erdhi në shtëpi, se e kam
fqinj, hoqi nga qafa pankartën «Jam kundër
protestave politike!» Sytë atë çast i ndizeshin
fort. Duket se po digjeshin krejt. Njeri i
mrekullueshëm, bab’! S’kam parë tjetër si ai!
Po pse nuk i donte protestat politike? Po ja, të
ishte kundër tyre, sipas profesor Zekës, do të
thoshte se ato forcojnë dhe mbajnë në këmbë
kundërshtarin, i hollojnë mendjen dhe je ti
që e pëson pastaj. Apo jo? Vetëm revolucionin
të fshin nga faqja e dheut dhe pas tij vjen
përsëri politika, urtë e butë, e buzëqeshur, e
ndotur, e mjerë për të ardhur keq, por tinës,
fshehtas, e merr veten në dorë: rrit taksat - me
të qeshur, me të ngjeshur - shkel ligjet me të
dyja këmbët, nuk paguan gjë prej gjëje, s’e fut
dorën në xhep, të rrjep të gjallë gjithnjë ashtu
pa u ndjerë... E pse ta dua politikën? Edhe e
djeshmja si e sotmja... Një surrat kanë...

Bab’, e pyeta një ditë: Pse nuk ta dhanë
titullin, profesor? Titullin? Ç’thua! Ku ta fut?
Titull pa gjë në dorë? Ç’domethënë?... Dhe
ndizej. Bota, thoshte është një copë filmi me të
këputura! Sa të tilla ke brenda një dite? Shumë!
Pa hesap. Çdo çast! Ti e ngjit, filmi këputet.
Dhe ti mbetesh duke u marrë me ngjitje-
këputjet, të bëhet mendja ujem! Ç’domethënë
ujem, profesor? Hm. Ujemi... Në mulli, djalosh,
lënë hakën e bluarjes, ata që bluajnë (Ç’them!
Çdo gjë bluhet!). Gjithçka në një vend. Dhe ti
do të hash bukë ujemi! Do hash zorrët e tua,
hakën tënde! Dhe të përzihet!... E ç’bëra unë
për të qenë *profesor*? Të gënjeja mendjen me
fjalët? Nuk e bëra dot. Kurse të sotmit, bir,
paguajnë, ç’të të them sa, dhe u vjen diploma
e bukur enkas për ta! Çë? Doktoraturë? Ç’thua,
mo, të plastë e mendjes! Gënjeshtra me brirë!

Ashtu mbeti. Kritik për çdo gjë. I zgjuar?
Të përgjigjej për çdo gjë. Dëshira e tij ishte
që t’i thoshte gjërat në sy! NË SY!
Jo me letra. Kurrë! Me emër e pa emër. Ia thua kujtdo,
edhe kreut politik, edhe doktorit të shkencave,
edhe profesorit, me shprehje dhe me qëndrim.
Prerë. Ai, vajti para Kryeministritë, para
bulevardit të madh dhe pankarta shkruante:
«Kryeministër! Paguaj energjinë elektrike
për zyrat e kryeministritë!» Kaq, as foli, as
bërtiti. Njerëzit kalonin, lexonin pankartën
të hardallosur dhe nxitonin sikur do t’i zinte
flama. Po më e bukura është se sekretari i

përgjithshëm i kryeministritë mbajti këmbët
para tij dhe shpërtheu në ngërdheshje, por që
pak më vonë i ra parainfarkt...

Thashë një ditë, që t’i shkruaja presidentit
që t’i jepte një dekoratë. Dhe ai, menjëherë,
si të ndodhte çudia: hiqe, largoje atë që po
bluan në mendje! As mos të... shkojë... Ta
lexova mendimin. E kapa. Mos mendo kurrë
të mirën për një gjë se, me siguri del keq! Litar
rëre... Kupton? Bëhet dot litar rëre?... Edhe ti
bab’, ma ke zënë ngoje këtë punën e litarit të
rërës. Kudo të jem më del para syve Zeka. Edhe
në ëndërr. Mbase do ta shikoja kur të nxirrte
një curril uji nga goja, sikur të dilte nga deti,
pishina, liqeni... Kudo. Edhe në një vend të
shkretë! I shkretë edhe kur është deng me
njerëz! *Më mirë shiko një ëndërr; pa i mbyllur
sytë. Prit të bien shkallët!* Mos, këto shkallë?...
Ëndrra ka për të qenë skëterrë. Sidomos kur
janë ëndrra dashurie. Ëndrra të pamundura!
Në ëndrra nuk është vend për të ndenjur. Por...
ëndrrat e kanë një të mirë: ta zbardhin faqen,
sidomos kur e ke të nxirë!

Ah, sa mirë do bënim, të merrnim një sy
gjumë! Po në ëndërr, do protestonim? Jo, s’ka
protesta në ëndërr. Rrallë qëllon të shohin
dy vetë të njëjtën ëndërr. Protestat bëhen në
shesh. Vetëm në shesh. Dhe që ta kuptojnë
njerëzit, var një pankartë të shkruar. Për
shembull një ditë gjeta në facebook thënien
e një klouni, gaztori komik, të nderuar me
çmimin Nobel, që thoshte e «Intelektualët
s’kanë dinjitet, ndaj nuk indinjohen!» E
shkrova, e vara kartonin dhe dola në sheshin
«Skënderbej». Kalonin, mbanin këmbët,
lexonin, qeshnin hidhët. Atë ditë kanë
kaluar njëqindëzyzetënëntë mijë e dyqind e
tridhjetenëntë vetë. Më Kupton?... Më e keqja
është se ata, të diturit e kohës sonë, janë të
tredhur, s’u del as pika e zërit nga goja, sesi
dridhen kur janë para politikës. Zot na ruaj.
Mungesa e revoltës, or bir është e tmerrshme!
Dhe këta të tredhur të thonë si pa të keq: po
sikur të kem nevojë nesër nga ata?... Pa merak,
aty ke për të vdekur, te këmbët e tyre dhe *ata*
as me sy s’do të shohin! Derdimen! Mbeturinë!
Unë, or mik, protestoj, nuk shantazhoj njeri!
S’e ha atë koqe ulliri unë! Përndryshe as hija
jote nuk mbetet në lojë. Atë ditë erdhi pranë
meje një grua, m’u qas dhe më puthi. Po, po, në
buzë! «Ti qenke burrë!» më tha. «Mbaje mend
këtë ditë...» Dhe ashtu ndodhi, e mbajta mend,
derisa një ditë e pashë, si rastësisht në sheshin
Skënderbej duke protestuar. Kishte shkruar:
Para jush gjithnjë ka mbeturina! Kujdes! Iu
afrova dhe e putha. Bukur. U bënë dy shokë të
një ideali. Pastaj, u bëmë tre, katër, tridhjetë...
Dhe bëmë Shoqatën e protestuesve. Mos
ardhtë dita që ajo, shoqata, të hiqet branë dhe
të jetë veshur me rrecka!

Nëpër ëndërr e pashë duke protestuar. Ajo
ishte ëndërr e papërsëritshme. Ishte dimër
dhe binte shi si pika kristali që të shponin. Dy
policë bashkiakë të instruktuar mos më keq
dhe si me duart e bythës, i bërtitën ta hiqte
pankartën, ndryshe do ta pësonte! Ai nuk
i dëgjoi. Kishte shkruar: «Kundër politikës
si prostitutë, por jo kundër prostitutave!»
Buzëqeshte. Një çast e fshiui buzëqeshjen. Polici
më i ri ulëriu, kurse profesori qeshte lehtë, si
fllad. Atëherë polici e goditi me grusht. Atij i
doli gjak, ra dhe pastaj ashtu siç ishte u ngrit.
I erdhi shumë keq që nuk e gjeti pankartën e
shkruar. Ngadalë-ngadalë, pothuajse zvarrë, u
kthye në shtëpi, u la, u pastrua, u vesh ndryshe
dhe u ul të shkruante fjalët e asaj që i morën
policët. E kështu me radhë, ditë për ditë.
Kush nuk futet në rresht, dëbohet. Dëbohet
nga gjithçka. Dikush i tha se janë bërë listat e
atyre që sillen keq. Dëmtohet shoqëria. Turp.
Ç’turp, mo? Sahanlëpirës. Ja, ç’shoqëri jemi!
Na mbushët mendjen që paskeni familje. Po
ne të tjerët ç’kemi? Më thuaj, de, ç’kemi? O
perëndi, ç’po ndodh? Edhe të shohim ëndrra
na ndalohet!...

Po me shkallët si? Cilat shkallë kërkon,
mo, gjytyrym! Ec përpara! Ëndrrat e tua!
Sikur s’e njohim ne, surratin tënd! Përpara!
Në komisariat! Delenxhi! Protestues i qenit!
Do ta shohim!

Po pse? Si pse, a i pe në ëndërr shkallët? Po.
Po, por mos harro. Kush i ka vënë ato shkallë?
Si, kush? Nuk e paske lexuar? Ato janë shkallët
e kryetarit, derdimen! Kryengritës. Ke tentuar
të na vrasësh kryetarin, ose të arratisesh në
parajsë! E kush të lë?...

Tiranë, më 22.01.22

Në botën e të vdekurve unë arrita me dy plumba në trup, pasi isha nisur të kaloja këmbë kufirin e Shqipërisë, aty ku katundet tona ndahen krejt befás: në një anë Skjeja me pyll shkoze e frashër të butë, kurse në anën tjetër Zogajt me kaçuba lajthish e mrinash, që iu vjen një duhmë si në derë të purgatorit. Në atë kufi kishte kohë që nuk ishte vlarë njeri, meqë në Shqipëri kishte rënë komunizmi dhe shteti nuk kishte forcë as për të hangër mutin e vet. Kështu thuhej. Mua, ndërkohë, një plumb më kishte marrë në tëmth, kurse tjetri ma kishte shpuar dërrasën e krahavorit. Vdekja kishte qenë e menjëhershme dhe kalimi në botën e territ i kishte ngjarë një ecjeje nëpër tëh vetëtime. Më pas ndodhi shpërbërja e kujtesës dhe humbja e disa ekuilibrave të tjerë, ndërsa rindërtimi i ngjarjes, e cila më kishte privuar nga jeta, ishte shumë i ngatërruar: unë kisha mbetur i shtrirë në barkën e vogël gati për një ditë të tërë dhe me sytë hapur shikoja lëvizjen e reve nëpër qiell. Në të vërtetë, siç mund të merret me mend, qielli, retë dhe era ishin përfshirë nga një boshllëk, të cilit nuk mund t'i gjendet një shpjegim i thjeshtë, me konceptet e zakonshme për botën reale.

Tani unë nuk mund të them me aq qartësi sa kohë qëndrova i shtrirë në atë sul, sepse ekziston një dallim shumë i madh ndërmjet mënyrës si matet koha në botën e të gjallëve, nga mënyra si perceptohet ajo në botën e të vdekurve. Ndërkohë, një peshkatar, i parruar dhe me një kasketë të vjetër në kokë, një përfaqësues tipik i gjeneratës së fundit të kooperativistëve të Shqipërisë, si e pa se isha i vdekur, e la sulin e vet në cektinë dhe ngarendi deri në mes të fshatit, aty ku ende mund të shiheshin rrënojat e një pularie dhe muret e rrafshuara të kazermës së vjetër. Së fundi aty ishte hapur një klub, teksa atë ditë dy policë pinin raki nga një faqore gjysmëlitrëshe. Pas gjysmë ore policët u shfaqën në breg të liqenit, njëri zbrazti fshikëzën e urinës pranë një kaçube, ndërsa tjetri m'i futi duart nëpër xhepa, duke m'i marrë të gjitha paratë që kisha me vete. Kjo situatë nuk shkaktoi tek unë ndonjë ndjenjë pakënaqësie, sepse e dija se në botën e të vdekurve, ku tashmë kisha arritur prej disa orësh, paratë nuk do të më hynin në punë për asgjë.

Por asnjëra nga këto rrethana nuk shpjegonin gjë, si ndodhi që unë u gjenda i vdekur në atë barkë, pikërisht në ditën e njëqindvjetorit të pavarësisë së Shqipërisë dhe pikërisht në kufirin që ishte vënë pranë katundeve tona, këtu e njëqind vjet të shkuara. Duke qenë se në botën e amshimit nuk ka paravendosje apo prapavendosje të ngjarjeve, sepse të gjitha ngjarjet duken sikur ndodhin në të njëjtën kohë, në një rrethanë të tillë, pra, sapo më shpallën të vlarë në kufi, pasi u mora me të gjithë shkaktarët e kësaj situatë paradoksale, erdha në përfundim se vrasjen e kishte bërë Kiçoja, i vetmi tokë që sillej ende në këto anë. Kiçoja kishte qenë partizan, pastaj ishte bërë ushtarak dhe, si veteran që ishte, uniformën nuk e kishte hequr kurrë nga trupi, ndërsa në kasketën e madhe që i zbriste deri te veshët, Kiçoja kishte qepur një yll të kuq pesëcepësh. Në një kohë më të hershme, Kiçoja kishte qenë i martuar me një kooperativiste dhe njerëzit pandehnin se kishte luajtur nga mendja, kur kishte parë të hiqej busti i shokut Enver nga oborri i shkollës në Zogaj. Tani Kiçoja mbante krahaqafë një automatik të vjetër, flinte në një garazh, mësonte përmendësh citate nga veprat e shokut Enver dhe çdo



MEHMET KRAJA

Boshti sillet rreth tokës

tregim

ditë i bënte një inspektim të kujdesshëm kufirit, që nga liqeni e deri lart pjerrinave të Taraboshit. Ndonjëherë shihej ulur mbi një mur betoni te vau i katundit, gjuante zaje në ujë dhe pyeste veten përse bota kishte ca ligjësi që nuk kuptoheshin. Shoku Enver kishte vdekur, ndërsa thuhej se toka sillej e patrazuar rreth boshtit të vet. Ncuk! Boshti sillej rreth tokës. Kiçoja i buzëqeshi vetes. Pikërisht kjo ishte! Një çarje e çmendur në mes të logjikës së gjërave!

Duke qenë se të vdekurit i dinë të gjitha gjërat, më duhet të them këtu, jo pa keqardhje, se Kiçoja nuk arriti të fshihte nga unë atë që kishte në mendje, në çastin kur m'i dha plumbat në kokë dhe në trup. Ta qi pithkën e nënës, gegë i mutit, mu aty do ta bëj gropën! Kiçoja, më pastaj, u kthye me vrik dhe mori rruginën që çonte nëpër shkurnajë, u fut në pyllin e shkozave dhe që andej u ngjit në karakollin e vjetër, u fsheh atje dhe nuk u duk më. Ndërkohë, dy policët u kthyen edhe një herë në klubin e fshatit, pinë edhe nga një dopio dhe biseduan për gjëra që nuk kishin ndonjë lidhje me vrasjen time. Gjysmë ore më vonë, njëri nga policët nxori telefonin celular nga xhepi i brendshëm i uniformës dhe thirri dikë nga eprorët e tij. Pas pak ata u ngritën me përtesë dhe shkuan te zallina afër vaut, kontrolluan edhe një herë nëse kufoma ime ishte ende në sul, pastaj u ulën mbi guriçkat e bardha të zallinës dhe pinë duhan në heshtje. Tymi i duhanit u përzie me vetminë e vaut të braktisur dhe i dha liqenit një çehre mërzie. Një çast më vonë, nëpër sytë e mi të vdekur fluturuan ca pulëbardha të hutuara. Në përgjithësi, nga ai çast vdekja ime nuk m'u duk e mërzitshme.

Dy orë më vonë kufoma ime ishte shtrirë në vigun e një autoambulance me drita të kuqe dhe me drita të kaltra, e cila e bënte me ngut rrugën që çonte për në Shkodër. Në ulëset e para të makinës rrinte një mjek i ri me syza të bardha, një infermiere truphollë dhe shoferi babaxhan dhe i heshtur. Mjeku i ri më bëri një kontroll rutinë dhe konstatoi vdekjen

time të pakthyeshme, teksa infermierja truphollë nuk doli nga autoambulanca dhe u shikua dy herë në një pasqyrë të vogël që nxori nga çanta. Mjeku i ri u ul pranë infermieres dhe në çdo luhajtje të makinës fërkohej i tëri pas trupit të saj. As infermierja nuk e fshehu se ndihej e eksituar. Vetëm shoferi babaxhan atë mbrëmje kishte një nostalgji për diçka të largët dhe të panjohur. Ai fishkëllente me cepin e buzës refrenin e një kënge të vjetër dhe dukej sikur me autoambulancën e tij ngarendte për të kërkuar një prehje që nuk do ta gjente askund.

Autoambulanca me batërdinë e dritave kaloi Shirokën, shpejtoi nëpër urën e re dhe nga ana e Nënkalasë mori kthesën të hynte në Shkodër, në njërën nga ato kthesa trupi im u lëkund mbi vig dhe mbulesa shkau anash, tani koka më mbet e zbuluar dhe unë, edhe një herë, arrita të shihja botën nga perspektiva e një të vdekuri, pash brendinë e autoambulancës dhe ato gjëra të pakta që mbrëmja e vjeshtës i ravijëzonte në xhamin e turbullt, sipër Kalasë ndizeshin fishekzjarrë verdh, kuq dhe përsëri verdh, Bunës nën urë i vinte erë kalbëzim dhe peshk i ndenjur, dritat e makinave përshkoheshin nëpër mugëtirën e ënjtur të mbrëmjes, në një kryqëzim rrugësh në xhamin e autoambulancës u shfaq një godinë banimi me shumë dritare, në një dritare në katin e poshtëm kishte zënë vend një grua e vetmuar, dritarja tjetër pranë saj ishte pa drita dhe ngjante me një varr të zbrazët. Mjeku i ri iu fërkua pas trupit infermieres dhe i pëshpëriti diçka rrëzë veshit. A do ta bëjmë sonte pas darkës, kam çelësin e një dhome të zbrazët në repartin e onkologjisë. Infermierja qeshi me zë, hodhi kofshën mbi kofshë dhe ndjeu tangat e holla që iu futën në mishin e butë midis këmbëve. Jo, tha ajo, në atë repart nuk më pëlqen, e kam bërë një herë në një dhomë të errët, ku ishin hedhur dy burra të vdekur një mbi një. Kur u ndez drita, pata ndjesinë se e kisha bërë me një të vdekur. Pranë autoambulancës, nëpër trotuar kaluan

një grup të rinjsh që qeshnin me zë të lartë. Shoferi e ndali autoambulancën në cep të trotuarit, e fiku makinën dhe zbriti nxitimthi nga dera anësore. Dilni, tha ai me gjallëri, sikur t'i kishte rënë ndër mend diçka krejt papandehur. Sonte kam një dëshirë të tmerrshme që të bëhem tapë! Dritat e rrugës ishin të verdha, trotuari ishte i verdhë, xhamat e kafenesë matanë rrugës shikonin kalimtarët me një apati gjithashtu të verdhë. Sillet boshti rreth tokës! Zot, fjalët kishin humbur drejtpeshimin!

Ndonjë orë më vonë, sipas perceptimit të kohës në botën e të gjallëve, unë qëndroja i shtrirë në morgun e spitalit. Terri aty vinte i ndragur dhe të ngjitej pas lëkurës si qerojsë. Nga autoambulanca më hoqën dy burra të bëshëm, njëri me mantel të bardhë dhe pa flokë, tjetri me mantel të bardhë dhe i parruar. Më shumë se kaq nuk qesh i interesuar të shihja. Bota kishte marrë detyrën e rëndë, që të formohej nga kaosi dhe njerëzit të mos ishin të lumtur. Korridori i morgut të spitalit ishte i ngushtë dhe i errët, shkallët ishin të ngushta dhe të errëta. Njëri nga burrat ndezi një dritë të mekur, e cila nuk ndriçonte gjë, përveç se prodhonte hije. Ata më hoqën nga vigu dhe më çuan në një vend që nuk mund të them se çfarë ishte tamam, një si prag betoni, i përbërë nga errësira dhe përfytyrimet. Dy burrat u larguan shpejt, njëri fiku dritën, tjetri mbylli derën. Hapat e tyre nuk u dëgjuan më. M'u hodh të bërtisja, mos më lini këtu, por shpejt hoqa dorë, sepse nuk kisha një argument të qartë përse duhej ta bëja këtë, përse nuk u dashka të rrija në një morg të errët dhe të qelbur, përdërisa isha i vdekur. Drita dhe errësira në botën e të vdekurve nuk kishin asnjë kuptim, këtë e zbulova së fundi, as vetmia, as pozita shoqërore, as patriotizmi. Mua më kishin vlarë në kufi të Shqipërisë, në trup kisha vrimat e dy plumbave, nuk dihej se cili kishte qenë më vdekjeprurës se tjetri. Pragu i betonit, ku më kishin vendosur, vinte i lagësht dhe i ftohtë, përjashta ishte mbrëmja 28 Nëntorit dhe kremtohej njëqindvjetori i pavarësisë së Shqipërisë, aty poshtë, në bodrum, një asgjë e molisur kishte mbushur krejt hapësirën me masën e saj pa trajtë.

Ndërkohë që unë e vrisja mendjen për t'u gjetur një shpjegim kuptimeve të fshehta të botës së amshimit, ishte bërë gati ceremonia e varrimit tim, nuk e di se ku dhe nuk e di se si. Derisa të gjallët mblidhen pranë varrit dhe nëpër komemoracione, të vdekurit, në numër të paditur, mblidhen në një përmasë të hapësirës që nuk mund të përcaktohet, mbase është diçka si jonet e errëta në një dritë që shndrit verbueshëm, ose neutronet e heshtjes që futen në mes një buçime. Mund të mos jetë as kjo. Më shumë ka të ngjarë të jetë një hapësirë johapësinore në një kohë që ecë së prapthi. Pra, unë isha atje, kur ndodhi që në botën e të gjallëve u mblodhën njerëz të më jepnin lamtumirën e fundit, disa i njihja, por nga vendi ku isha, të gjithë m'u dukën kopje pandjesore të një bote që nuk kisha dijeni për të. Bota e vërtetë nuk ishte aty. Pamjet që më kalonin para sysh, nuk ishin pamje të vërteta, por zbrazësia e përmasës ku rrinin ato.

Mbaj mend se në komemoracionin tim u mbajtën fjalime dhe u tha se unë kisha vdekur për një kauzë të madhe, teksa unë e kisha përqendruar vëmendjen diku tjetër, te zhgardhnimi i mendjes dhe te ai perceptimi i çuditshëm, se toka nuk sillej rreth boshtit, por boshti sillej rreth tokës, rreth tokës...

Sally Rooney: Do të doja ta nisja duke ju urrear, Annie, për çmimin Nobel. Është një arsye për të festuar – por e marr me mend se niveli i vëmendjes është shpërqendruar.

Annie Ernaux: Do të tregohem brutale dhe do ta them: Fitova një çmim që nuk e desha kurrë. Ra në jetën time pak a shumë si një bombë. Qëkur e kam fituar, nuk mund të shkruaj dhe, pas 40 vjetësh si shkrimtare, të mos kesh më dëshirën të shkruash është pothuajse e dhimbshme. Ajo që më preku më shumë ishte kur lexuesit, pasi kishin njohur diçka nga vetja në shkrimet e mia, më thanë: “Jemi ne ata që e kemi fituar çmimin Nobel”.

SR: Në fjalimin tuaj të pranimit të Nobelit, ju folët për dëshirën tuaj për të nxjerrë në dritë të pathënshmen. Ju keni shkruar gjerësisht për prejardhjen tuaj socio-ekonomike dhe atë të prindërve tuaj. A e konsideroni klasën shoqërore si një nga këto gjëra të pathënshme në letërsinë europiane?

AE: Për një kohë të gjatë, klasa nuk ka qenë një temë e madhe. Kjo po ndryshon – në letërsinë franceze, është diçka për të cilën po flasim shumë më tepër. Deri në shekullin e 20-të, shkrimtarët vinin nga borgjezia. Ajo që nevojitej ishte që individët të ndryshonin klasën e tyre përmes arsimimit, dhe pastaj të kërkonin të drejtën për të shkruar për këto përvoja që nuk ishin diskutuar hapur.

SR: Stili juaj i prozës është i famshëm për thjeshtësinë e tij. Ju e keni bërë të qartë se ky refuzim i qëllimshëm i një stili më lirik lidhet gjithashtu me shqetësimet për identitetin klasor.

AE: Librat me të cilët nisa karrierën time ishin shkruar në një stil plot zemërim. Por ishte gjithashtu një stil i ndritshëm, i gjallë, dhe ishte në vetën e parë: unë shkruaja për veten, edhe pse paraqitej si roman. Kur shkrova *Vendi* në 1983, ndryshova qasje. Ishte një hap i madh për mua të shkruaja jo për veten, por për babanë tim. Dhe atëherë e kuptova se stili i zemëruar vjen nga një pozicion dominimi. Shkruan në atë mënyrë sepse ndien se klasat sunduese po të shtypin. Nuk doja ta bëja këtë – doja të shkruaja për kulturën e babait tim sikur të ishte normale, të përshkruaja se si jetonte ai. Dhe kështu arrita te ky stil, i cili besoj se ka të bëjë me rimarrjen e një ndjenje drejtësie. Por librat e mi kanë evoluuar vazhdimisht përgjatë 40 vjetëve... asnjë libër nuk i ngjan tjetrit.

SR: Shumë nga librat tuaj përballen me dhimbjen dhe dhunën e të jetuarit si grua në një kulturë që ka qas shumë urrejtje për gratë. Por në librat tuaj, gjinia mund të jetë një burim kënaqësie, po aq sa edhe dhimbjeje. A është e rëndësishme për ju t'i përfshini si dhimbjen, ashtu edhe gëzimin e të qenit grua në një kulturë patriarkale?

AE: Kur nis një libër të ri, nuk mendoj në terma gëzimi apo dhimbjeje. Më shumë më shtyn një ndjesi se diçka ka mbetur e pathënë dhe se unë duhet ta them, ta shkruaj. Për shembull, në librin tim të vitit 1981, *Gruaja e ngrirë*, unë eksploroja se si në kalimin nga fëmijëria në jetën bashkëshortore, pabarazia gjinore papritur u bë shumë konkrete për mua. Pastaj më vonë, te *Pasion i thjeshtë* [1991], ajo që doja të përshkruaja ishte përvoja e të qenit tërësisht e zhytur nga një pasion. *Kujtime vajze* [2016] ishte eksplorimi i përvojës sime të parë seksuale katastrofike. E pyesja veten: Si pranova unë për këtë? Si i lashë këto gjëra të ndodhnin? Por kjo nuk do të thotë se e shoh veprën time si të motivuar ideologjikisht... nuk synon të jetë feministe. Unë thjesht po përipiem të reflektoj mbi përvojat e mia si grua.



“Fitova një çmim që nuk e desha kurrë”: Laureatja e çmimit Nobel, Annie Ernaux, i hap zemrën Sally Rooney-t

Në një bisedë me romancierën e *Njerëz normalë*, fituesja e nderit më të madh në botën e librave shpjegon pse nuk ndihet më në gjendje të shkruajë.

SR: Si e nisni një libër të ri?

AE: Unë gjithmonë punoj me disa dorëshkrime në të njëjtën kohë. Dhe pastaj njëri prej tyre merr epërsi. Nuk mund ta shpjegoj dot pse apo si. Në vitin 1999, kisha tre libra të mundshëm që i kisha nisur. Njëri ishte *Vitet* [2008]. Tjetri ishte *Kujtime vajze*. I treti ishte *Ngjarja*, për përvojën time në 1964 me një abort ilegal. Një ditë po dëgjoja radio dhe nisi Rekuemi i Duruflé-së, të cilin e adhuroj. Ajo muzikë gjithmonë më sillte ndër mend abortin tim. Dëgjimi i saj më bëri të mendoj: ky është dorëshkrimi që duhet të mbaroj. Dhe e bëra. E shkrova *Ngjarja* brenda gjashtë deri në tetë muaj. Nuk mund të bëja asgjë tjetër.

SR: Në *Kujtime vajze*, ju shkruani për ankthin se nëse përvoja të caktuara në jetën tuaj nuk shkruhen, ato “do të mbeten të pashpjegueshme, do të jenë jetuar pa asnjë arsye”. Shkrimi juaj duket si një përpjekje për të ndërhyrë në kalimin e kohës, për të ndërprerë rrjedhën e saj dhe për të refuzuar ta lësh të shkruarën të ikë.

AE: Sally, mendoj se sapa përmblodhët karakterin thelbësor të veprës sime! Isha 32 vjeç kur u botua libri im i parë, në të cilin po përipiqesha të përpunoja të gjithë të shkruarën time, fëmijërinë time, dhe pastaj fillimin e viteve të mia si e rritur. Më motivonte një dëshirë për t'i dhënë një kuptim të ri së shkruarës sime. Pastaj më vonë në shkrimet e mia, u bëra gjithnjë e më e shqetësuar për t'i dhënë një ekzistencë

tjetër gjithçkaje që ka ndodhur, jo vetëm mua, por të gjithë neve kolektivisht. Se si ne, së bashku, e kemi përjetuar kalimin e kohës, i cili ka sjellë kaq shumë ndryshime në gjithçka, në institucionet tona dhe madje edhe në fjalët që përdorim.

SR: Disa nga librat tuaj më të njohur kanë të bëjnë me jetën e njerëzve që keni dashur. Te *Një grua* [1987], ka një pasazh prekës ku ju shkruani: “Besoj se po shkruaj për nënën time sepse është radha ime ta sjell atë në jetë”. A e shihni shkrimin tuaj si një akt dashurie për të tjerët?

AE: Mendoj se akti i të shkruarit është në thelb dykuptimësh. Nëse merr librin që shkrova për nënën time, ka shumë dashuri aty. Por unë gjithashtu u përballa dhe i rezistova me dhunë nënës sime gjatë jetës së saj. Dhe kështu ai libër ishte një mundësi për mua për t'u penduar për atë histori mes nesh. Por të shkruarit mund të jetë edhe krejt e kundërta. Kur shkruan për një person, mund ta përdorësh aktin e të shkruarit për t'i treguar ata, për t'i vrarë.

SR: Ju keni thënë se dëshira juaj për të shkruar lindi nga dëshira për t'u hakmarrë për njerëzit tuaj – klasën punëtore dhe gratë. Më duhet ta pranoj se kur e lexova për herë të parë, u habita. Për mua, nuk duket se ka asgjë hakmarrëse në shkrimet tuaja.

AE: Unë në të vërtetë po flas për t'u hakmarrë për klasën dhe gjininë time duke

zbuluar padrejtësitë e së shkruarës. Dhe nuk po e bëj këtë për të dhënë gjykime – mendoj se të shkruarit mund të jetë një akt riparimi. Tingëllon pak si tepër katolike të thuash, “Unë shkruaj nga dashuria për njerëzimin.” Por sigurisht që shkruaj për të bërë diçka për të tjerët. Jo për të fuqishmit – ata nuk kanë nevojë. Por unë shkruaj për ata që kanë nevojë.

SR: Ju keni qenë një shkrimtare e njohur dhe një intelektuale publike për disa dekada. Te *Ditar i Jashtëm* [1993], ka një pasazh që trajton një bisedë televizive midis Marguerite Duras dhe Jean-Luc Godard: “Ajo që ata thonë në të vërtetë nuk ka asnjë rëndësi; ajo që ka rëndësi është se një bisedë midis artistëve apo intelektualëve vihet në dispozicion të pjesës tjetër të shoqërisë. Një model i përsosur bisedë”.

AE: I qëndroj asaj që kam shkruar. Ajo që po thoshin ishte e parëndësishme. Nuk kishte thellësi, as rëndësi politike. Ata thjesht ishin ftuar sepse ishin dy figura madhështore të kulturës franceze. Dhe kështu ky ishte një spektakël, një bisedë e inskenuar. Në televizion dhe në radio, gjithçka është formuluar në një mënyrë të caktuar. Kështu që duhet të gjeshtë mënyra për t'u shprehur pavarësisht kësaj. Por mbetet e mundur të kesh biseda të vërteta për shoqërinë, për letërsinë. Shpresoj se kjo do të ndodhë më shumë. Gjithçka varet se kë fton për të folur – dhe pse.

Waterboarding, i thashë nënës. Është kur dikush të vendos një cohë sipër fytyrës, mandej derdh ujë përmbi të. Duket sikur mbytesh. *Në fakt*, mbytesh.

Dhe ti do ta bësh, tha ajo.

Po.

Nëna psherëtiu. Kjo duhet të jetë një prej ideve të tët' vëllai.

Sapo kishim parë një film rreth Gjirit të Guantamos, thashë. Pas tij, më pyeti nëse mund t'ia bëja waterbording-un, dëshiron ta dijë si duket, dhe unë i thashë se po, vetëm nëse do të ma bënte edhe ai mua. Kështu, ja pra si mbërritëm këtu.

Dhe si ishte? pyeti nëna.

S'e kemi bërë akoma!

Teksa nëna plakej, aftësitë e saj për të dëgjuar përkeqësoheshin edhe më.

Oh, po, tha. Po shihja dje diçka në televizor dhe një prej personazheve që kisha më përzemër u hodh në erë, prandaj fjeta aq keq.

Mendua se duhet ta kishim mundësinë të shtriheshim në një pozicion mjaft të rehatshëm, prandaj vendosëm ta bënim në divan. Im vëlla i pari. U shtri në shpinë me një mësallë të kuqe hapur mbi fytyrë. Unë i qëndrova pranë me një kanë me ujë.

Epo fillojmë, i thashë, duke i derdhur ujë mbi mësallë. Pas pak sekondash, im vëlla largoi cohën nga fytyra dhe u ngrit.

Mbase duhet të të kishim lidhur, i them.

Me një prej çorapeve të mia, i lidha kyçet njëri me tjetrin dhe ia fillova prapë. Ramë dakord ta largoja cohën pas tridhjetë sekondash dhe vendosa kronometrin në telefon. Im vëlla gulçoi dhe u përpoq të lëvizte krahët. Po mbytet, mendova. U desh goxha kohë për tridhjetë sekondat që të kalonin dhe me ta larguar cohën, kur ai përfundoi së kollituri, tha: Mjafton me kaq.

Unë nuk i doja kyçet të lidhura, doja të mund ta hiqja cohën nga fytyra kurdo të më përshtatej.

Kështu nuk bën, tha im vëlla. Ma lidhi çorapen rreth kyçeve dhe ma vendosi cohën mbi fytyrë. Uji më hyri në hundë dhe s'merrja dot frymë. U përpoqa të ngrihesha dhe gjuajta diçka me këmbë. Kur më në fund isha drejtuar, e shkunda cohën nga fytyra dhe përdrodha duart deri sa u liruam.

Im vëlla më zgjati një facoletë për të fshirë fytyrën, por unë tunda kokën, duke marrë dhe nxjerrë frymë, sërish e sërish. Kambanat e kishës ranë, alarmi në telefon u fik.

Pse nuk më ndihmove?

Më fal, tha ai.

M'u duk se do të villja. E vara kokën mbi tualet dhe prita që të dilte diçka, por asgjë nuk doli dhe mendova për atëherë kur kisha ftuar një djalë në shtëpi dhe për mënyrën se si ai ma shtynte kokën. M'i kishte mbuluar veshët me duar dhe vazhdonte të ma shtynte kokën edhe më poshtë, mbase mendonte se po më eksitonte pasi kur bëra pas, i ushtrova presion mbi gjunjë dhe u përpoqa të shpëputem, ai më mbërtheu edhe më fort dhe gjithë çfarë mundja të dëgjoja ishte veçse rrahja e zemrës. Dhe atëherë mendova për herën e parë kur kisha dëgjuar dikë të thoshte se po i dilte zemra vendit. Imë ëmë e kishte thënë. I tregoi dikujt se sa herë mendonte rreth së ardhmes të së bijës, e mbërthente ankthi pasi ajo s'kishte ndonjë bukuri kushedi se çfarë. Nuk shqetësohej për tim vëlla dhe se si ai ia shkulte përherë flokët vetes ose për tullën që i kishte shkaktuar shkulla. Nuk e mbaj dot mend kur ndaloi së shkuluri, por nuk i zgjati shumë dhe flokët iu rritën prapë.

Im bir është i zoti në gjithçka, thoshte shpesh ime ëmë. Një ditë, ai do të bëjë diçka të jashtëzakonshme.

JENTE POSTHUMA

Çfarë do të doja të mos e mendoja

Fragment nga romani | Përktheu Andreas Dushi

Pse duhej botuar në ky libër në gjuhën shqipe?

“Çfarë do të doja të mos e mendoja” është një libër i trishtë, thellësisht madje. Por ndryshe nga e zakonshmja, trishtimi nuk është një synim, por një mjet, i bashkuar me shumë mjete të tjera, për intensifikimin gjuhësor të disa kujtimeve që notojnë krejt natyrshëm mes fictionit e së vërtetës, kjo e fundit përherë letrare, duke krijuar ashtu një histori të letrarizuar të situatave që shpeshherë, krejt pa dëshirën e njeriut, atij i kthehen në atë gjënë që konvencionalisht kemi vendosur ta quajmë destinë. Libri çmonton hap pas hapi, pa asnjë rend kronologjik, besimin te ekzistenca e diçkaje të tillë dhe na lë të besojmë se si rastësia, në fakt, nuk është mbreti i botës, në konceptin klasik që “bota” përmban, por pasqyra ku ne vështrojmë paaftësinë tonë për të pasur çfarëdolloj roli në përmirësimin e jetës së atyre më pranë nesh. Kjo na ofron një tekst të qashtë, pa asnjë shtresë epizmi e pa asnjë shtresë lirizmi, me domethënie të zbërthyer në secilën frazë të hedhur, sikurse mund të duket, pa pasur një qëllim paraparak, çka është krejt e gabuar mbasi, “Çfarë do të doja të mos e mendoja” në fakt, pot'i mungonte qoftë edhe vetëm një mikrokapitull, do të çalonte. Ftesa për ta lexuar këtë libër është ftesë për të njohur një tjetër botë të dhimbjes, atë të njeriut që e fajëson veten, pa ia dalë ta zbulojë asnjëherë nëse ka vërtet faj apo jo. Herë faji e herë pafajësia janë prehja aq shumë e dëshiruar, por po ashtu, në mos akoma më shumë, e shmangur, pasi ajo shoqërohet me frikën e asaj çfarë e pason. Nëse njeriu bën paqe me humbjen, po pastaj çfarë e pret? Kjo pyetje mbetet pa përgjigje, duke shpalosur kështu tendosjen më domethënëse, më komplekse të qenies njerëzore, atë mes kureshtjes dhe frikës.

JENTE POSTHUMA

Libër finalist i Booker Prize International 2024



Onufri

Pasi im vëlla rilindi gjatë një seminari, tha: Jeta nuk është një linjë e drejtë. Është si një cikël. Mund të vdesësh dhe t'ia fillosh prapë nga e para.

Seminari ishte organizuar nga ndjekësit e Osho-s të cilët, njëzet vjet pas vdekjes së tij, e shihnin akoma si një mjeshtër shpirtëror, çka ishte po ashtu domethënia e emrit të tij.

Osho, tha im vëlla. E njeh kush është, apo jo? Burri që e thërriste veten Bhagvan që do të thotë Zot.

Sigurisht që e dija me përpikmëri për kë e kishte fjalën. Po fliste për burrin e lindur Chandra Mohan, emër shumë i zakonshëm në Indi, por që kur ishte fëmijë, gjyshërit e thërrisnin Rajneesh që do të thotë Mbret i Natës. Rajneesh-i shkonte shpesh te lumi pranë qytetit të tij, shtynte fëmijët e tjerë brenda në lum derisa ata desh mbyteshin dhe mandej i pyeste si ndiheshin. Sikurse Bhagvan-i thoshte shpesh: *Shpresa është një drogë. Vetëm të gatshmit për të vdekur do të njohin një jetë plot me dashuri. Kush i frikësohet vdekjes nuk do të penetrojë kurrë në misterin e dashurisë*. U tha njerëzve që erdhën në Ashram-in e tij në Poona se duhet të dorëzojnë veten. *Po u larguat tani, tha, mund t'i jepni fund jetës*. Sipas tij, nevoja për të vrarë veten ishte shenjë e inteligjencës së vërtetë dhe e ndjeshmërisë, një dëshirë për t'i shpëtuar asfiksionit të egos. Për ata që e njohin pakuptimshmërinë e gjithçkash, vetëvrasja – ose dorëzimi tërësor – ishte e vetmja mundësi. Kjo ishte pak a shumë ajo çka je postuar në një ndërfaqet e parapëlqyera të internetit të tim vëllai, shkurt, fjali të copëtua në mënyrë të çuditshme, të gjitha të renditura si një poezi e keqe.

Shkaku i vdekjes së Osho-s më 1990 është i paqartë, pasi ai u dogj pak orë pasi vdiq. Mu para se të vdiste, Osho-ja pranoi se ishte helmuar teksa shërbente në një burg amerikan më 1985. Ka prej atyre që besojnë se ai thjesht fare, u lodh së jetuari dhe i kërkoi fizikanit të tij personal t'i jepte një injeksion vdekjeprurës.

Më vonë, im vëlla ndaloi së besuari se jeta ishte ciklike. Po fillon një mot i tmerrshëm, tha. Nga tani e tutje, veçse do të bëhet më keq.

Në studimin kombëtar të lumturisë, qyteti ynë shënoi pak mbi mesataren. Ose pak nën mesataren, nuk e kujtoj më tamam. Sidoqoftë, unë kam kujtime shumë të forta nga qyteti, por im vëlla nuk ka. Deri në çastin e fundit, bezdisje shumë po të përmendja shatërvanin në sheshin e qytetit dhe fëmijët që loznin aty, më të vegjlit zhveshur dhe më të rriturit në kostume banje, ose po të sillja në bisedë bikinin rozë me xixa që halla më solli nga New York-u.

Në 1990, viti kur im vëlla dhe unë mbushëm dhjetë vjeç dhe ishte viti i bikinit tim me xixa, kishte 2245 vrasje në New York. Dhe 596 vetëvrasje. Ishte po ashtu viti kur nja dy çuna te shatërvani e bënë zakon t'i merrnin mbathjet e notit tim vëllai, kështu ai detyrohej të ecte për në shtëpi i zhveshur.

New York-u ka ditë pa vetëvrasje. Nuk janë ditë feste, nuk është se lajmërohen më parë. 12 korrik 1993 ishte një ditë pa vetëvrasje në New York. Im vëlla dhe unë lexuam për këtë pasditen e ardhshme, te lajmet në teletekst. Sapo ishim kthyer nga parkingu pas supermarketit ku ishte një vinç i stërmadh. Mbase është diku



pesëmbëdhjetë metër i lartë, tha im vëlla. Si do të ishte po të ngjiteshim deri në majë, them unë. Deri ku do të mund të shihnim. Një motor shpejtoi me zhurmë pas meje dhe kthehem të shoh një nga punonjësit e sektorit të mishit duke u larguar me shpejtësi nga parkingu. Gjithë zhurma që motori bën, thotë im vëlla, është krejt e panevojshme, është veçse për t’u dukur. Kur u ktheva, im vëlla kishte arritur tanimë në gjysmë të vinçit. Me shpejtësi ula shikimin poshtë, duke këqyrur tufat e barit nën këmbët e mia derisa qafa filloi të më dhembte dhe im vëlla më në fund u hodh nga vinçi dhe zbriti pas meje me një zhurmë të mbytur. Mund të shohësh qytetin, tha, dhe gjithë gjarpërimet që lumi bën gjatë udhës së tij.

Ishte i bukur?
Më së shumti ishte thjesht larg.
Dhe mu para se të na zinte gjumi atë natë, tha: Sot ishte një tjetër ditë pa vetëvrasje.

Mes 2000-shit dhe 2005-ës, numri i vrasjeve në New York ra ndjeshëm, por numri i vetëvrasjeve u rrit. Mënyrat më popullore të vetëvrasjes në New York janë varja, asfiksimi ose hedhja nga një lartësi e madhe. Teksa numri i atyre që hidhen nga lartësitë po ulet, New York-u ka prapëseprapë më shumë sesa pjesa tjetër e Shteteve të Bashkuara. Tetë herë më shumë, për të qenë e saktë.

Ndoshta numrin e të hedhurve, New York-u ia ka borxh Wall Street-it ku herë pas here, në kohëra recesionesh, një menaxher i fondit të investimit do të hidhet nga dritarja. Sipas Qendrës për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, ata që punojnë në Wall Street janë dyzet përqind më të prirur për t’ia marrë jetën vetes sesa njerëzit e zakonshëm. Profesionalistët në Wall Street janë, për nga natyra, perfeksionistë konkurrues – puna që bëjnë është identiteti i tyre dhe ata vazhdimisht krahasojnë veten me kolegët.

Im vëlla, veten e quante Njësh dhe mua Dysh pasi kishte lindur dyzet e pesë minuta para meje në një ditë gushti me zagushi mbytëse. Më trajtonte si motrën e vogël, kur lindëm ishte më i gjatë dhe më i shëndoshë se unë dhe kishte zënë thujse gjithë vendin në barkun e sime mëje. Unë kisha ngecur pas tij, me këmbën e majtë të hedhur mbi shpatulla, ose të paktën, kështu na ishte fiksuar në mendje. Prandaj u desh më shumë kohë për mua që të dilja. Në fakt, data jonë për të lindur ishte pas një muaji, por im vëlla vazhdoi para dhe unë s’mund të lihesha pas.

Të mos qenurit identikë ishte një gjë që për shumë kohë e shihja si diçka që nuk shkonte, pasojë e lindjes sonë të parakohshme, edhe pasi e kuptova ndryshimin mes binjakëve identikë dhe fraternalë. Mund të ishim afruar dhe më shumë gjatë atij muaji të nëntë.

Im vëlla ishte më aktiv, fliste me zë më të lartë dhe kishte shpërthime më të mëdha zemërimi sesa unë. Hidhte gjëra, përplaste dyer dhe shqelmonte vrima në to. Pas të tilla krizash, mbyllej në dhomë dhe kur më në fund zbriste poshtë, sillej si të mos kishte ndodhur asgjë. E gjitha çfarë u duhej prindërve të mi të bënin ishte t’i hidhnin një sy dhe herë pas here, të ripararin ndonjë gjë. Ata ishin të detyruar të më kushtonin edhe mua pak vëmendje. Këmbëngulja të më pajtonin sa herë isha e shqetësuar dhe refuzoja t’i lija ta largonin vëmendjen për te gazeta apo televizori. Kjo ndodhte atëherë kur akoma i vishja ndjesitë e mia nga jashtë, si një pallto, dhe nuk e kuptoja se kjo ishte diçka që nuk supozohet ta bësh.

Kërkuese ishte fjala që ata përdornin për të më përshkruar. Tim vëlla e quanin kokëfortë. Ai i dinte përherë të gjitha gjërat më mirë se unë. Nuk mendoj ta kem dëgjuar ndonjëherë të më përgjigjej kur i tregoja diçka me *Ashtu vërtetë?*, ose *Uau, nuk e dija këtë*. Zakonisht thoshte *E di*, dhe po të ishte diçka që nuk e dinte, atëherë nuk thoshte asgjë.

Poezia fituese e Çmimit Bullgar për Poezi Ballkanike
- Vutimski Queer 2025.

ARBËR SELMANI

Fëmija im dhe i Carlos

Do ta mësonte shqipen, gjuhën frënge, italishten në disa dialekte
në fletore pune do t’ia mjeshtëronim të trija
Ndjenjë, sensazione, la sensation—
në dy anët e fletës së bardhë, të zbehtë.

Çdo verë *ai* do të notonte në Lake Como
gishtat e vegjël do t’ja puthnim bashkë
recitimin do ta mësonte si shprehje, prej meje
e Carlo do ta ndihmonte t’i trembnin bashkë pëllumbat.

Fëmijëria nuk do të kishte shumë fotografi—
se Carlo ndihet i largët nga aparati.

Nënat tona do ta donin *vajzën* e vogël
fëmion tim dhe të Carlos
gëzimin e parë që mban tri shtete mbi supe.

Do të ecte shumë pak për te çerdhja poshtë lagjes
një riskë buke do t’ja përgatisja unë, vendosur në çantën e krahut
sytë e kaltër, si të Carlos
zemrën e ndërtuar prej pasqyrash, si unë.

Do t’i shtypte duart mbi xhamat e dyqaneve—
në kërkim të një teleskopi, *të lutem – ma blej një teleskop*.

E di që *ajo* do të dashurohej në një violinë
që zemra e saj të ishte e akorduar.

Fëmija im dhe i Carlos
do të mrekullohej prej kafshëve
do të udhëtonim në Napoli
se shoqet brilante të Ferrantes na presin
do t’ja blija *atij* kukullat më fine
ajo do të shndërrohej në qindra flutura
atij do t’ia mësoja përlësinë
asaj, fuqinë tokësore të poezisë
ajo do ta pëlqente simetrinë,
si Carlo
ai do të ishte Peshore, ose Bricjap, ani pse askush
nuk beson më në yje.

Me kohën
do ta mësonte relievin e Gjenevës, akullnajat
shkencat natyrore, mrekullitë e Kutunusë
ekuacionet me dy të panjohura
si të mos provokohet zjarri ballkanik
gabimet e Bonapartës
fotosintezën, pluhurin kimik, përrallat e Andersenit
Van Gogu preu veshin
Mylène Farmer është monumentale
dashuria e dy baballarëve kumbon butë si një natë vere mbi Розова долина.



Eeldrop dhe Appleplex morën me qira dy dhoma të vogla në një pjesë me emër të keq të qytetit. Këtu ata nganjëherë vinin në mbrëmje, nganjëherë flinin e, pasi bënë një sy gjumë, ata gatuanin tërshërë dhe në mëngjes niseshin drejt adresash të panjohura për njëri-tjetrin. Ata rrallë flinin, më shpesh bisedonin apo shikonin nga dritarja.

Ata i kishin zgjedhur dhomat dhe lagjen me kujdes të madh. Ka lagje të liga me zhurmë dhe lagje të këqija me heshtje, dhe Eeldrop e Appleplex parapëlqyen këtë të fundit, si më të keqen. Kjo ishte një rrugë me hije, dritaret e saj ishin me perde të rënda; dhe mbi të varej reja e një respekti që ka diçka për të fshehur. Megjithatë ajo kishte përparësi ndaj lagjeve më harrakate rreth e rrotull, dhe Eeldrop e Appleplex vrojtonin nga dritaret hyrjen qendrore të një rajoni të policisë nga ana tjetër e rrugës. Kjo në vetvete përbënte një tundim të papërmbajtshëm në sytë e tyre. Nga koha në kohë heshtja e rrugës prishej; sa herë që një keqbërës arrestohej, një valë e zemërimi shtjellej në rrugë dhe përplasej mbi dyert e stacionit policor. Pastaj banorët e rrugës, në veshjet e tyre të shtëpisë, do të zgjatnin qafat nëpër dyer: pastaj vizitorët e huaj do të vargoheshin në rrugë, me kapele në kokë; pak më vonë qendra e mjerimit ngujohej në birucën e saj. Pastaj Eeldrop dhe Appleplex ndërpritnin bisedën e tyre dhe nxitonin për t'u bashkuar me turmën. Secili ndiqte linjën e vet të hetimit. Appleplex, i cili kishte dhuntinë e një komunikimi të jashtëzakonshëm me klasat e ulëta të të dy sekseve, hynte në biseda me kalimtarët, dhe shpesh nxirrte prej tyre histori të plota dhe kontradiktore: Eeldrop kishte një sjellje më pasive, dëgjonte bisedën e njerëzve në mes tyre, i regjistronte në mendjen e tij betimet e tyre, teprinë e tyre të fjalosjes, mënyrat e tyre të hakërrimeve, dhe klithmat e viktimës nga salla e drejtësisë brenda. Kur turma shpërndahej, Eeldrop dhe Appleplex ktheheshin në dhomat e tyre: Appleplex i shënonte rezultatet e pyetjeve të tij në blloqe të mëdhenj, të renditur në bazë të natyrës së çështjes, nga A (tradhti bashkëshortore) në Y (turpe me kafshët). Eeldrop tymoste i përhumbur. Mund të shtohet se Eeldrop ishte një skeptik, me një prirje për misticizëm dhe Appleplex një materialist me një prirje drejt skepticizmit, dhe se Eeldrop kishte studiuar teologji e Appleplex kishte studiuar shkencat fizike dhe biologjike.

Ishte një motiv i përbashkët i cili bënte që Eeldrop dhe Appleplex të qëndronin ndaras kohë pas kohe, nga terrrenet e punëve të tyre të përditshme dhe nga veprimtaritë e tyre rëndom shoqërore. Të dy përpiqeshin t'i icknin jo mjedisve të rëndomta, të respektuara apo edhe familjare, por zonave tejet të përpikta, tejet të rehatshme, tejet strehë pëllumbash, dhe, – në gjuhën e atyre të cilët ata kërkonin t'i shmangnin – ata dëshironin “të kapnin shpirtin e njeriut në individualitetin e tij konkret”.

“Pse”, tha Eeldrop, “ai spanjoll i dhjamur, i cili u ul në tryezë me ne sonte dhe dëgjoi bisedën tonë me një kureshtje rastësore, pse ishte ai vetë për një moment një objekt me interes për ne? Mbante pecetën pulitur në mjekër të tij, bënte zhurmë të pakëndshme duke ngrënë dhe duke mos ngrënë, mënyra e tij e thyerjes së bukës në mes gishtave të trashë më bëri shumë nervoz: ai kishte veshur një jelek të zbërdhulët dhe çizme të zeza me maja ngjyrë kafe. Ai ishte tejet i shëmtuar e vulgar; i përkiste një tipi që shumë lehtë mund të klasifikohet në çdo qytezë provinciale të Spanjës. Megjithatë, në do rrethana – kur ne ishim duke diskutuar martesën, dhe ai papritmas u përkul përpara dhe bërtiti: “Unë kam qenë i martuar një herë” – ne ishim në gjendje ta lironim atë nga klasifikimi i tij dhe ta konsiderojmë për një moment si një qenie unike, një shpirt, megjithatë i parëndësishëm, me një histori të vetën, një herë e përgjithnjë. Janë këto momente që ne i çmojmë dhe të cila vetë po i shpalosim. Sepse çdo e vërtetë jetësore është e pazonja t'i shkojë përshtat një rasti tjetër: thelbësorja është unike. Ndoshta kjo është arsyeja pse është kaq i lënë pas



THOMAS STEARNS ELIOT

Eeldrop dhe Appleplex

Tregim | Përktheu Skënder Buçpapaj

dore: për shkak se është i padobishëm. Çfarë kemi mësuar në lidhje me atë spanjoll është paaftësia e tij që t'i shkojë për shtat çdo spanjoll tjetër, ose madje as ta çojë në mendje. Me tatëpjetën e teologjisë ortodokse dhe të teorisë së saj të admirueshme të shpirtit, rëndësia unike e ngjarjeve është zhdukur. Një njeri është i rëndësishëm vetëm pasi ai është i klasifikuar. Prandaj nuk ka asnjë tragjedi, apo nuk ka vlerësim të tragjedisë, çka është e njëjta gjë. Ne kishim qenë duke folur për djaloshin Bistwick, i cili tre muaj më parë u martua me shërbëtoren e nënës së tij dhe tani është i vetëdijshëm për faktin. Kush e vlerëson të vërtetën e çështjes? Jo të afërmit, se ata preken vetëm nga mirëdashja, sa i përket interesave të Bistwick, dhe kryesisht nga ndjenja e tyre kolektive e turpit të familjes. Shpirtlig e njeri që nuk vret mendjen, çka merret thjesht si dëshmi për domosdoshmërinë e reformës së ligjit të divorcit. Bistwick është i klasifikuar në mesin e të martuarve të palumtur. Por se ç'ndjen Bistwick kur zgjohet në mëngjes, çka është fakti i madh e i rëndësishëm, askush nga ata që nuk janë në dijeni nuk mund ta kuptojë. Rëndësia e tmerrshme e rrënimit të një jete është anashkaluar. Burrat janë të lejuar vetëm të jenë në klasa të lumtura apo fatkeqe. Në Rrugën Gopsum një burrë vrau dashnoren e tij. Fakti i rëndësishëm është se për njeriun akti është i përgjithshëm, dhe që për pjesën e shkurtër të mbetur të jetës, ai është tashmë i vdekur. Ai është tashmë në një botë tjetër nga e jona. Ai e ka shkelur kufirin. Fakti i rëndësishëm është se u bë diçka e cila nuk mund të zhbëhet – një mundësi të cilën asnjë prej nesh nuk e kupton derisa e përballim vetë. Për fqinjët e tij fakt me rëndësi është me çfarë e vrau burri atë? Dhe saktësisht në ç'kohë? Dhe kush e gjeti trupin? Për ‘publikun e shkolluar’ rasti është vetëm dëshmi për çështjet e Dehjes ose Papunësisë, ose disa kategori të tjera gjërash për t'u reformuar. Por bota mesjetare, duke këmbëngulur në përjetësinë e dënimit, shpreh diçka më afër së vërtetës.”

“Ajo që ti thua”, u përgjigj Appleplex, “kërkon aderimin tim matur. Unë duhet të mendoj se, në rastin e spanjollit, dhe në

shumë raste të tjera interesante që kanë ardhur nën vëmendjen tonë në hyrje të stacionit policor, ajo që ne e kapim në atë momentin e vëzhgimit të pastër për të cilën krenohemi, nuk është e huaj për parimin e klasifikimit, por më e thellë. Ne mundnim, nëse na pëlqente, të bënim koment të shkëlqyer mbi natyrën e spanjollëve provincialë, ose për varfërinë e skajshme (si është quajtur mjerimi nga filantropistët), ose për shtëpitë me vajzat punëtore. Por i tillë nuk është qëllimi ynë. Ne synojmë eksperiencën në qendrat e veçanta ku është vetëm e keqja. Ne shmangim klasifikimin. Ne nuk e mohojmë atë. Por kur një njeri klasifikohet, diçka humbet. Shumica e njerëzve jetojnë me monedha letre: ata përdorin terma të cilat janë thjesht të mira për realitete të tilla, ata kurrë nuk e kuptojnë monedhën reale.”

“Unë do të shkoja edhe përtej kësaj,” tha Eeldrop. “Shumica jo vetëm që nuk kanë një gjuhë që mund të shprehë diç tjetër pos njeriut të përgjithësuar; ata, në pjesën më të madhe, janë të pavetëdijshëm për veten e tyre si asgjë tjetër pos njerëz të përgjithësuar. Ata janë para së gjithash zyrtarë të qeverisë ose shtylla të kishës, ose sindikalistë, ose poetë, ose të papunë; ky katalogim nuk është i kënaqshëm vetëm për njerëzit e tjerë, për arsye praktike: është i mjaftueshëm për veten e tyre, për jetën e tyre “të shpirtit “. Shumë prej tyre nuk janë mjaft të vërtetë në çdo moment. Kur Wolstrip u martua, jam i sigurt se tha me vete: ‘. Tashi unë jam duke konsumuar bashkimin e dy prej familjeve më të mira në Filadelfia.”

“Pyetja është”, tha Appleplex, “çfarë duhet të jetë filozofia jonë. Kjo do zgjidhur menjëherë. Zonja Howexden më rekomandon mua të lexoj Bergsonin. Ai shkruan shumë zbavitshëm për strukturën e syrit të bretkocës.”

“Aspak,” e ndërpreu mikun e tij. “Filozofia jonë është krejt e parëndësishme. Thelbësore është që filozofia jonë të mbijë nga këndvështrimi ynë dhe të mos kthehet qëllim në vetvete për të shpjeguar pikëpamjen tonë. Një filozofi për intuitën ka disi më pak të ngjarë të jetë intuitive sesa ndonjë tjetër. Ne

duhet shmangim pasjen e një platforme.”

“Por të paktën,” tha Appleplex, “ne jemi....!”

“Individualistë. Jo!! dhe as anti-intelektualistë. Edhe këto janë etiketa. ‘Individualist’ është një anëtar i një turme krejtësisht si çdo njeri tjetër: dhe turma e individualistëve është më e papëlqyeshme, sepse ajo ka pak karakter. Nietzsche ishte një njeri-turme, ashtu si Bergsoni është një intelektualist. Ne nuk mund t'i shpëtojmë etiketës, por le të jetë diçka që nuk përbën asnjë dallim, dhe nuk shkakton asnjë brerje të ndërgjegjes. Mjafton që ne të gjejmë etiketa të thjeshta, dhe të mos i shfrytëzojmë më tej ato. Unë jam, unë të rrëfej ty, në jetën private, një nëpunës-banke....”

“Dhe duhet, sipas vizionit tënd, të kesh një grua, tre fëmijë, dhe një kopsht perimesh në një periferi,” tha Appleplex.

“Ky është saktësisht rasti,” ia ktheu Eeldrop, “por unë nuk e kisha menduar të nevojshme ta përmend këtë detaj biografik. Meqë është natë e shtunë, unë do të kthehem në periferinë time. Nesrën do ta kaloj në atë kopsht....”

“Unë do t'i bëj vizitë zonjës Howexden”, murmuriti Appleplex.

II

Mbrëmja e së dielës në periferitë ishte gri dhe e verdhë; kopshtet e shtëpive të vogla në të majtë dhe në të djathtë ishin rrethuar me shermashek, me barishte dhe shkurre jargavani; gjelbërimi tropikal i Londrës së Jugut ishte i pluhurosuar lart dhe i mykur poshtë, ajri i vakët gumëzhinte plot miza. Eeldrop, në dritare, e mirëpriste erën e tymosur të jargavanit, gramafonët, korin e kishës baptiste dhe sytë e tri vajzave të vogla që luanin karta në shkallët e Stacionit Policor.

“Në një natë si kjo,” tha Eeldropi, “Unë shpesh mendoj Sheherazaden dhe pyes veten se çfarë është bërë me të.”

Appleplex u ngrit pa folur dhe u kthye te dosjet të cilat përmbanin dokumentet për “Hetimin e Shoqërisë Bashkëkohore”. Ai e hoqi fashikullin Londër nga midisi i Barcelonës dhe Bostonit ku ai kishte qenë gabimisht, dhe i shfletoi letrat rrufeshëm. “Zonja që ti përmend,” u kujtua ai më në fund, “të cilën unë e kam renditur jo tek S. por si Edith, alias Sheherazade, ka lënë vetëm pak dëshmi në zotërimin tim. Ja një llogari e vjetër lavanderie që ajo ta ka lënë ty ta paguash, një çek i tërhequr prej saj dhe i shënuar ‘R/D?’, një letër nga nëna e saj në Honolulu (në fletë me rreshta të gjerë), një poemë e shkruar në një faturë restoranti – ‘Atthisit’ – dhe një letër nga ajo për Lady Equistep, në një fletë të bukur shënimesh, që përmban disa informata të dëmshme, por të këndshme për Lady Equistep. Pastaj janë ca vërejtje të miat në dy fletë letre me format të madh.”

“Edith,” murmuriti Eeldrop, i cili nuk e kishte pasur mendjen te ky katalog, “Unë pyes veten se çfarë është bërë me të.” Nuk është kënaqësi, por plotësi e jetës... të djegësh ndonjëherë një perlë në mes të flakës së gjallë, këto ishin fjalët e saj. Çfarë kureshtjeje dhe pasioni për eksperiencën! Ndoshta ajo flakë është shuar vetvetiu tashmë.”

“Ti duhet të informohesh më mirë,” foli Appleplex rëndë, “Edith darkon ndonjëherë me zonjën Howexden, e cila më tregon mua se pasioni i saj për eksperiencën e ka çuar atë tek një pianist rus në Bayswater. Ajo gjithashtu thuhet të jetë e pranishme shpesh në Dhomat Anarkiste të Çajit, dhe zakonisht mund të gjendet në mbrëmje në Cafe de l’Orangerie.”

“E pra,” ia ktheu Eeldrop, “unë pranoj se parapëlqej të pyes veten se çfarë është bërë me të. Unë nuk doja të mendoja për të ardhmen e saj. Sheherazadja e plakur! E përfytyroj atë shumë të majmur, me gjoks të plotë, me flokë të verdhë, duke jetuar në një apartament të vogël me një shërbëtore, duke shëtitur në Park me një qen race leshtor, të lëvizë në veturë me një agjent burse. Me një uri të tërbuar për ushqime dhe pije, kur të

gjitha uritë e tjera i ka shfryrë, të gjitha uritë e tjera i ka shuar përveç urisë së pangopur në rritje të kotësisë; duke bredhur kodrinave mbi dy këmbë të hapëta, duke u lëkundur nëpër vetura, duke u lëkundur drejt një fundi diabetik në një vend të lagësht bregdetar.”

“Pikërisht tashi ti sapo e pé atë flakë të ndritshme duke u shuar,” tha Appleplex, “tashi do ta shikosh duke pikëluar, çka dëshmon se vizioni yt u bazua në imagjinatë, jo në ndjenja. Dhe pasioni për eksperiencën – ke mbetur kaq pakthyeshtëm para-rafaelit sa të besoni në të? Kush është ajo qenie reale, me një zanafillë të vërtetë të instiktit, që ka besuar ndonjëherë në pasionin për eksperiencën? Pasioni për eksperiencën është një opinion i të singertëve, një kredo vetëm e kurrkushëve. Personi i pasionuar është i pasionuar për këtë apo atë, ndoshta për gjëra më pak të rëndësishme, por jo për eksperiencën. Por Marius, des Esseintes, Edith...”

“Por ki parasysh,” tha Eldrop, i vëmendshëm vetëm për faktet e historisë së Edith dhe ndoshta duke mos vënë re vërejtjet e Appleplex, “karrierën e saj të pazakontë. E bija e një akorduesi pianoje në Honolulu, ajo siguroi një bursë në Universitetin e Kalifornisë, ku u diplomua me Nderime në Etikën Sociale. Ajo pastaj u martua me një profesionist bilardoje në San Francisko, pas një njohjeje dymbëdhjetëorëshe, jetoi me të dy ditë, u bashkua me një kor muzikor komedie dhe u divorcua në Nevada. Ajo u kthye disa vjet më vonë në Paris dhe u bë e njohur për të gjithë amerikanët dhe anglezët në Dome du Cafe si zonja Short. Ajo u rishfaq në Londër si zonja Griffiths, botoi një vëllim të vogël vargjesh, dhe u pranua në disa qarqe të njohura për ne. Dhe tani, sikurse unë ende këmbëngul, ajo është zhdukur nga shoqëria krejt.”

“Kujtimi i Sheherazades,” tha Appleplex, “është për mua si krem karameli Zog prej kumbullash të thata në një shtëpi pushimi në Bloomsbury. Nuk është synimi im për të paraqitur Edith si thjesht të pandershme. As nuk është ajo një figurë tragjike. Unë dua të di se pse ajo mungon. Unë nuk mund ta analizoj atë në ‘tërësinë e kombinimit të elementeve të njohur’, por më mungon së prekuri diçka sigurisht e papërshtatshme për analizë.

“A është Edith, pavarësisht së kaluarës së saj romantike, duke ndjekur ngultas njëfarë qëllimi të fshehur të saj? Janë migrimet dhe kërkimet e saj shenjë e ndonjë rrjedhoje të anashkaluar? Gjej te ajo një sasi vëzhgimi mendjemprehtë, një fond të shkëlqyer kritikizmi, por unë nuk mund t’i lidh ato në ndonjë vizion të veçantë. Sarkazma e saj në kurriz të miqve është e lezetshme, por unë dyshoj nëse është më shumë se një përpjekje për ta modeluar veten nga jashtë, nga shkaku i armiqësive, për të theksuar izolimin e saj. Gjithkush thotë për të, ‘Sa përkryer është ajo e padepërtueshme!’ Unë dyshoj se brenda ka vetëm konfuzionin e një papafingoje të pluhurosur.”

“Unë i shqyrtoj njerëzit,” tha Eldrop, “nga mënyra si i imagjinoj ata teksa zgjohen në mëngjes. Unë nuk nisem nga kujtesa, kur imagjinoj Edith si zgjohet në një dhomë plot me rroba, gazeta, kozmetika, letra dhe ca libra, erën e Violetës së Parmës dhe duhanit bajat. Rrezet e diellit depërtojnë përmes qepenave të thyera, dhe qepenat e thyera që e mbajnë diellin jashtë derisa Edith të mund ta detyrojë veten të jetë e pranishme ditën tjetër. Megjithatë, vizioni nuk më jep më shumë dhimbje. Unë mendoj për të si një artiste pa as forcën më të vogël artistike.”

“Temperamenti artistik-” filloi Appleplex. “Jo, jo ai,” Eldrop e zbrapsi tej këtë mundësi. “Unë dua të them se ajo që e mban në formë artistin është puna që ai bën; ndaje atë nga puna e tij dhe ai ose thërmohet ose ngurtësohet. Nuk ka asnjë interes për artistin përveç punës së tij. Dhe ka, siç e the ti, njerëz që sigurojnë material për artistin. Tashi poema e Edith ‘Atthisit’ dëshmon përtej çdo hije dyshimi se ajo nuk është një artiste. Nga ana tjetër, kam menduar shpesh për të, siç kam menduar edhe këtë mbrëmje, sa iu përket mundësie për qëllime poetike. Por njerëzit

që mund të jenë material për artin duhet të kenë në vete diçka të pavetëdijshme, diçka që ata nuk e marrin vesh ose nuk e kuptojnë plotësisht. Edith, në dritën e asaj që quhet maskë e saj e padepërtueshme, e paraqet veten shumë mirë. Unë nuk mund të përdor atë; ajo e përdor tejet plotësisht. Pjesërisht për të njëjtën arsye, unë mendoj se ajo nuk arrin të jetë një artiste. Ajo nuk jeton fare me instinkt. Artisti, në një pjesë të tij, është një kërkues, nën mëshirën e përshtypjeve, dhe një pjesë tjetër e tij lejon që kjo të ndodhë për hir të vënies në përdorim të kreaturës së palumtur. Por tek Edith ndarja është thjesht racionale, pjesa e ftohtë dhe e shkëputur e artistit, ajo në vetvete e ndarë. Materiali i saj, eksperiencia që ka, e cila tashmë është një produkt mendor i përthithur tashmë nëpërmjet arsyes. Prandaj Edith (unë vetëm në këtë moment arrij ta kuptoj) është me të vërtetë personi më i disiplinuar që ekziston, dhe më racional. Asgjë nuk ndodh kurrë tej ajo; çdo gjë që ndodh është e bërë prej asaj vetë.”

“Dhe prandaj po ashtu,” vazhdoi Appleplex, duke i kapur fjet, “Edith është më pak e shkëputura e të gjithë personave, pasi për t’u shkëputur duhet shkëputur nga vetvetja, të dalësh kundruall dhe të kritikosh me ftohtësi pasionet dhe peripecitë e vetes. Por tek Edith kritiku është duke e stërvitur luftëtarin.”

“Edith nuk është e palumtur.” “Ajo është e palumtur, ndoshta.” “Por përsëri them, ajo nuk është tragjike: ajo është tepër racionale dhe në karrierën e saj nuk ka progresion, nuk ka rënie apo degjenerim. Gjendja e saj ekziston njëherë e përgjithmonë. Dhe nuk do të ketë katastrofë....

“Por unë jam i lodhur. Unë ende pyes veten se çfarë Edith dhe zonja Howexden kanë të përbashkët. Kjo e fton konsideratën (ju nuk mund të kuptoni lidhjen) e grupeve dhe të shoqërisë, një subjekt që ne mund ta trajtojmë nesërmbrema.”

Appleplex dukej pak i sflitur. “Unë jam i zënë duke darkuar me zonjën Howexden,” tha ai. “Por do të reflektoj mbi temën para se të takohemi përsëri.”

1917

Shënim i përkthyesit: Eldrop dhe Appleplex (Ildrop dhe Apëllpleks) janë skeptikë që e kalojnë gjithë kohën duke vëzhguar njerëzit, duke krahasuar intuitën dhe filozofitë e tyre të individualizmit. Tregimi i autorit T. S. Eliot është një dialog filozofik. Kjo vepër thellohet në kompleksitetet e përvojës dhe individualitetit njerëzor, të përshtatura përmes bisedave të dy burrave, Eldrop dhe Appleplex, ndërsa ata përballen me natyrën thelbësore të ekzistencës njerëzore dhe kuptimin e jetës në një botë të mbushur me klasifikime dhe pritje shoqërore. Tregimi trajton tema të rënda të identitetit, perceptimit dhe thelbit të realitetit, duke përzier elementë si të mendimit ekzistencial ashtu edhe të kritikës sociale. Eldrop dhe Appleplex janë dy personazhe të veçantë që bëjnë një jetë të kufizuar në një pjesë të qetë dhe të pandershme të qytetit. Ata angazhohen në biseda reflektuese që analizojnë natyrën e njerëzimit dhe mënyrat se si individët shpesh reduktohen në stereotipe. Përmes diskutimeve të tyre rreth temave të ndryshme, përfshirë figurën enigmatike të Edith, ata meditojnë mbi rëndësinë e përvojave unike kundrejt klasifikimeve të përgjithësuara. Eldrop, një skeptik me njohuri teologjike, dhe Appleplex, një materialist i interesuar në analizën sociale, eksplorojnë perspektivat e tyre të kundërta mbi jetën individuale, duke zbuluar një dëshirë të thellë për të kuptuar shpirtin njerëzor në formën e tij autentike dhe jo përmes lenteve të etiketave shoqërore. Në fund të fundit, tregimi paraqet një meditim mbi kërkimin e kuptimit brenda kufizimeve të jetës moderne dhe dëshirën për marrëdhënie të vërtetë ndërnjerëzore mes kategorizimit dërrmues.



Kate Chopin Puthja

Përktheu Artemisa Kuznetsov

Jashtë kishte ende dritë të bollshme, por, pas perdeve të lëshuara dhe pranë zjarrit që po shuhej e lëshonte një shkëlqim të zbehtë, dhoma ishte përshkuar nga hije të thella. Brantaini ishte strukur në njëren prej këtyre hijeve; ajo e përfshinte krejtësisht, por kjo nuk i shkaktonte asnjë shqetësim. Errësira i jepte guxim të ngulte sytë, plot zjarr, mbi vajzën që rrinte ulur pranë oxhakut. Ajo ishte mjaft e hijshme, me një ngjyrim të pasur e të gjallë, tipik për një zeshkane plot shëndet. Qëndronte krejt e qetë, teksa përkëdhelte me përtim gëzofin prej kadifeje të maces që rrinte mbështjellë në prehërin e saj; dhe herë pas here hidhte një vështrim të ngadalshëm drejt hijes ku qëndronte shoqëruesi i saj. Ata bisedonin me zë të ulët, për gjëra të parëndësishme, që në dukje nuk kishin të bënin fare me atë që u pushtonte mendjen. Ajo e dinte se ai e donte—një djalë i singertë e paksa i rrëmbyer, pa dredhi të mjaftueshme për të fshehur ndjenjat e tij dhe pa asnjë qëllim për ta bërë këtë. Për dy javë me radhë ai kishte kërkuar me zell e këmbëngulje shoqërinë e saj. Ajo ishte e sigurt se ai do t’i shprehte haptazi ndjenjat e tij dhe kishte vendosur ta pranonte. Brantaini, megjithëse disi i parëndësishëm dhe jo shumë tërheqës, ishte tepër i pasur; dhe ajo e pëlqente dhe e dëshironte jetën që mund t’i ofronte kjo pasuri.

Gjatë një pushimi të shkurtër në bisedën e tyre, teksa po pinin çaj dhe flisnin për takimin e radhës, u hap dera dhe hyri brenda një i ri që Brantaini e njihte mirë. Vajza ktheu fytyrën drejt tij. Një hap a dy e sollën pranë saj, dhe, pa i dhënë kohë të dyshonte për qëllimin e tij—sepse ajo ende nuk e kishte kuptuar që ai nuk e kishte parë vizitorin që ndodhej aty—u përkul mbi karrigen e saj dhe e puthi me zjarr, në buzë.

Brantaini u ngrit ngadalë; vajza u ngrit menjëherë pas tij, por me nxitim, dhe i sapoardhuri qëndroi mes tyre, me një shprehje ku hutimi përpiquej të mbulonte një përzierje zbavitjeje dhe sfide.

“Mendoj,” belbëzoi Brantaini, “se kam qëndruar më gjatë seç duhej. Unë... nuk e kisha idenë... më duhet t’ju them lamtumirë.”

Ai po shtrëngonte kapelen me të dyja duart dhe, me shumë gjasë, nuk e vuri re që ajo po i zgjaste dorën; aftësia e saj për të menduar dhe vepruar shpejt nuk e kishte braktisur krejtësisht; por asaj i mungoi guximi të fliste.

“Mallkuar qofsha nëse e pashë të ulur aty, Nat! E di që ishte tmerrësisht e pakëndshme për ty. Por shpresoj që këtë herë të ma falësh—këtë gabimin tim të parë. Po çfarë ke kështu?”

“Mos më prek! Mos m’u afro!” shpërtheu ajo me zemërim. “Si guxon të hysh në shtëpi pa trokitur?”

“Hyra bashkë me vëllain tënd, ashtu si bëj shpesh,” u përgjigj ai ftohtë, duke u përpjekur të justifikohej. “Hymë nga ana tjetër. Ai u ngjit lart dhe unë hyra këtu me shpresën për të të gjetur. Shpjegimi është i thjeshtë dhe duhet të të bindë se ajo që ndodhi ishte e paevitueshme. Por, të lutem, më thuaj se më fal, Natali,” iu lut ai, duke zbutur tonin.

“Të të fal? Ti nuk e di çfarë flet. Lërmë të shkoj. Do të varet nga... diçka tjetër nëse do të të fal ndonjëherë.”

Në takimin tjetër – atë për të cilin ajo dhe Brantaini kishin folur më parë – sapo e pa të riun aty, iu afrua me një sjellje të ëmbël dhe të këndshme.

“Mund të flas me ju për disa çaste, zoti Brantain?” e pyeti ajo me një buzëqeshje të hijshme, por të trazuar. Ai dukej tepër i trishtuar; por kur ajo i kapi krahun dhe u largua me të, duke kërkuar një vend më të tërhequr, një rreze shprese u përzie me mjerimin pothuajse komik në fytyrën e tij. Ajo po shfaqej hapur dhe me sinqeritet.

“Ndoshta nuk duhej ta kisha kërkuar këtë bisedë, zoti Brantain; por... por, oh, kam qenë shumë e trazuar, pothuajse e mjerë, që nga ajo përplasje e vogël atë pasdite. Kur mendova se si mund ta kishit keqinterpretuar dhe se mund të kishit besuar gjëra”—në fytyrën e tij të rrumbullakët e të çiltër, shpresa po merrte dukshëm epërsi mbi mjerimin—“...natyrisht, e di që për ju kjo nuk do të thotë gjë, por për hir të vetes sime dua të kuptoni se zoti Harvi është një mik i vjetër dhe i ngushtë. Ne kemi qenë gjithmonë si kushërinj—madje mund të them si vëlla e motër. Ai është shoku më i ngushtë i vëllait tim dhe shpesh silltet sikur gëzon të njëjtat privilegje si pjesëtarët e familjes.

“Oh, e di që është absurde, e panevojshme dhe madje qesharake për dinjitetin tim që ta them këtë,” tha ajo, gati duke qarë, “por për mua ka shumë rëndësi çfarë mendoni ju për... për mua.” Zëri i saj ishte i ulët dhe i trazuar. Mjerimi u zhduk krejtësisht nga fytyra e Brantainit.

“Atëherë, për ju vërtet ka rëndësi çfarë mendoj unë, zonjusha Natali? A mund t’ju quaj zonjusha Natali?”

Ata hynë në një korridor të gjatë e të zymtë, me bimë të larta dhe të hijshme në të dy anët, duke ecur ngadalë drejt fundit të tij. Në kthim, fytyra e Brantainit shkëlqente, ndërsa ajo kishte një shprehje triumfuese.

Harvi ishte një nga të ftuarit në dasmë; ai iu afrua pikërisht në një nga ato çaste të rralla kur ajo ndodhej vetëm.

“Yt shoq,” i tha ai me një buzëqeshje të qetë, “më ka dërguar të të puth.”

Një skuqje e menjëhershme përshkoi fytyrën dhe qafën e saj të lëmuar e të rrumbullakët.

“Mendoj se është krejt e natyrshme që një burrë të silltet bujarisht në një rast si ky. Ai më tha se nuk dëshiron që martesë e tij të ndërpresë plotësisht atë afërsi të këndshme që ka ekzistuar midis nesh. Nuk e di çfarë i ke thënë ti,” shtoi ai me një buzëqeshje të pacipë, “por më ka dërguar këtu që të të puth.”

Ajo u ndje si një lojtar shahu që, pasi lëviz me mjeshtëri gurët, më në fund e sheh lojën të rrjedhë sipas dëshirës së tij. Sytë e saj, të butë dhe të ngrohtë prej gëzimit, shkëlqenin teksa u ngritën drejt tij; buzët i dukeshin të etura për puthjen që po prisnin.

“Por e di,” vazhdoi ai me qetësi, “këtë nuk ia thashë burrit tënd—do të tingëllonte si mosmirënjohje, por ty mund të ta them: kam hequr dorë nga puthja e grave. Është e rrezikshme.”

Epo, asaj i mbetën Brantaini dhe milionat e tij. Njeriu nuk mund t’i ketë të gjitha në këtë botë; dhe, në fund të fundit, ndoshta ishte paksa e tepruar nga ana e saj të shpresonte për më shumë.

Askush nuk lexon më. Kjo është diçka që pedagogët e letërsisë si unë e thonë gjithmonë. “Çdo brez, në një moment të caktuar, zbulon se studentët nuk lexojnë aq mirë sa do të dëshironin ata vetë, apo aq mirë sa presin profesorët”, shkroi studiuesja e fushës së leximit, Martha Maxwell, në vitin 1979. Por gjithnjë e më shumë, edukatorët po konstatojnë se vitet e fundit kanë qenë ndjeshëm të ndryshme. Studentët po vijnë madje edhe në shkollat më prestigjioze pa lexuar kurrë një roman nga fillimi në fund. Profesori i letërsisë në Universitetin e Columbia-s, Nicholas Dames, i tha Rose Horowitz-it të *The Atlantic* se studentët e tij “e kanë të vështirë t’u kushtojnë vëmendje detajeve të vogla, ndërkohë që ndjekin rrjedhën e përgjithshme të ngjarjeve”. Muajin e kaluar, teksa studentët u kthyen në shkollë, një studim i ri bëri bujë sepse zbuloi se numri i amerikanëve që lexojnë për kënaqësi ka rënë me një shifër befasuese prej 40 për qind që nga fillimi i shekullit.

Si pedagog universiteti, edhe unë e kam vënë re këtë tendencë. Studentët e mi janë tejet të zellshëm, të interesuar për botën dhe madje të gatshëm ta besojnë pa e vënë në dyshim kur u them se është e rëndësishme të bëjnë leximin e caktuar. Ata kanë dëgjuar gjatë gjithë jetës së tyre se leximi është një pjesë e rëndësishme e suksesit të tyre në të ardhmen. Por shumë prej tyre nuk kanë nxjerrë kurrë shumë kënaqësi personale prej tij ose nuk e kanë parë vetë se çfarë mund t’u japë një libër, që një artikull në Wikipedia nuk mund ta ofrojë më shpejt. Mbylljet e shkollave për shkak të Covid-it me gjasë e përshpejtuan problemin. Chatbot-ët e inteligjencës artificiale (AI) e çuan problemin në një nivel krejt tjetër duke ofruar përmbledhje (dhe ese) sipas kërkesës, të personalizuar dhe mjaftueshëm të sakta për çdo libër që mund të gresh në Google. Por gjithçka që bëri në të vërtetë ChatGPT ishte të intensifikonte nevojën tonë në rritje për të bërë pyetjen: Pse të lexojmë? Çfarë ka të veçantë akti i të ulurit me një libër në dorë, një përvojë thelbësore e jetës së qytetëruar deri shumë pak kohë më parë, që nuk mund të automatizohet apo të zëvendësohet?

E çuditshmja është se, dikur, mendimtarët shqetësoheshin se leximi do ta mpinte mendjen, ashtu siç shqetësohemi ne sot për ekranet. Në shekullin e katërt para Erës Sonë—pak pasi u bë në modë që filozofët *chic* të Athinës t’ua shisnin dhe shpërndanin kopjet e shkruara të leksioneve të tyre të rinjve ambiciozë elitarë të kohës—Platoni shkroi një dialog, *Phaedrus*, ku Sokrati ankohet se mjetet si papirusi po i bëjnë studentët dembelë. Ai flet për tekstet e shkruara sikur të ishin një lloj hard disku i jashtëm për mendjen, që ruan informacionin në mënyrë që të mos kesh nevojë ta bësh vetë. Ai madje sajoi një mit ku një nga perënditë shqetësohet se njerëzit do të mbështeten te shkrimi për të shtuar fuqinë e tyre të kujtesës, dhe se “kjo shpikje do të sjellë harresë në mendjet e atyre që mësojnë ta përdorin, sepse ata nuk do ta ushtrojnë kujtesën e tyre”.

Pothuajse mund ta përfytyrosh Bibliotekën e Aleksandrisë si versionin antik të një qendre serverësh ‘cloud’ diku afër Palo Altos, që strehonte tërësinë e dijes së regjistruar në mënyrë që njerëzimi të mos e mundonte veten për të mbajtur mend.

Ironia e dukshme është se Platoni e bëri këtë ankesë me shkrim. Forma letrare të cilës ai i hapi rrugën—dialogu filozofik—është një mënyrë për ta përdorur tekstin për një qëllim tjetër nga ai i ruajtjes së thjeshtë të informacionit. Dialogët ishin mënyra e Platonit për të rikrijuar, në formë të shkruar, përvojën e bisedës dhe shkëmbimit intelektual. Ti hyn në një *marrëdhënie* me librin dhe personazhet e

Tani që Inteligjenca Artificiale është e aftë të përmbledhë me shpejtësi gjithçka, nga librat e vetëndihmës e deri te romanet e mëdhenj, ne duhet t’i kujtojmë vetes pse lexojmë në radhë të parë.

ÇFARË NDODH NËSE ASKUSH NUK LEXON

Nga Spencer Klavan, “The Free Press”

tij. Përvoja—e leximit të tij, e të vuarit të mendjes për të, e rikthimit tek ai pas një dite, një viti apo një jete të tërë reflektimi—bëhet thelbi i çështjes.

Kur Platoni ishte i ri, komediografi Aristofani vuri në skenë komedinë e tij *Bretkosat*, ku perëndia Dionis përmend kalimthi se dikur e kishte kaluar kohën, kur supozohej të ishte në shërbim detar, duke lexuar tekstin e një drame tjetër, *Andromedën* e Euripidit. Kjo është ndoshta një nga paraqitjet tona më të hershme në letërsinë perëndimore të dikujt që lexon i vetëm për kënaqësi, duke imagjinuar personazhet teksa përpigën, vuajnë dhe flasin në imagjinatën e tij. Është diçka krejtësisht tjetër nga përdorimi i librave si depo të dhënash.

Ky lloj tjetër leximi—si një mjet lidhjeje njerëzore në vend të një sistemi për shpërndarjen e informacionit—disa njerëzve u është dukur gjithmonë diçka joserioze. Edhe në kulmin e romanit europian në shekullin e 19-të, letërsia artistike shpesh hidhej poshtë si një kalim kohe i thjeshtë, që të kujtonte më shumë Dionisin duke përtuar në anijen e tij sesa oratorët e rinj që stërviteshin në artin e qeverisjes. Ka një skenë në romanin *Middlemarch* të George Eliot, ku Fred Vincy, vëllai ëndërrimtar i Rosamond-ës disi sipërfaqësore, rri ulur duke lexuar, ndërsa e ëma llomotit për “studimet” e tij. “Studimet e Fredit nuk janë shumë të thella”, ndërhyr Rosamond-a, “ai thjesht po lexon një roman”.

Sigurisht, duke e futur këtë batutë në romanin e saj, Eliot po u bën lexuesve të

saj të njëjtën shkelje syri që Platoni na bëri neve te *Phaedrus*. Në njëfarë mënyre, romani ishte trashëgimtari modern i dialogut filozofik: ai lloj shkrimi, i gjithë thelbi i të cilit ishte të kaloje kohë me personazhet, ai lloj që këmbëngulte të jetohej dhe të imagjinohej, në vend që të rrëmohej për fakte apo këshilla jete. Njerëzit që lexojnë letërsi të madhe thjesht për hir të saj, shkroi C.S. Lewis, zbulojnë se “e gjithë vetëdija e tyre ndryshon. Ata janë bërë diçka që nuk ishin më parë”.

Dhe ky mund të jetë i vetmi lloj leximi, vlara e të cilit nuk po zëvendësohet dot nga makineritë. Këshillat praktike për vetëzhvillim mund të përmbledhen, të merren shkurt dhe pastaj të lihen mënjanë. Romani jo.

Kur nisa t’i shkruaja paragrafët e mësipërm, u zgjova me atë ndjesinë ngulmuese të një kujtimi që e njeh çdo lexues i përjetshëm. Diku—a ishte te *Middlemarch*? Tek *David Copperfield*?—kishte një skenë ku një personazh thoshte diçka të ngjashme me “ajo (ose ai) thjesht po lexon një roman”. Por nuk e gjeja dot saktësisht se ku. Prandaj pyeta Grok-un. Rasti ideal për ta përdorur: ma vërtetoi parandjenjen dhe më çoi sërish te *Middlemarch*, ku e gjeta citimin. Kjo është lloj vlere që mund të ofrojë Inteligjenca Artificiale. Ajo mund të tejkalojë pothuajse çdo mjet tjetër aktual për të lehtësuar çdo detyrë të mbledhjes së fakteve, që dikur do të duhej ta kryeje me anë të një katalogu skedash, një enciklopedie, apo një motori kërkimi.

Ajo që Grok-u nuk do të mund ta bënte



kurrë, ama, është të nxiste kujtimin që lindi brenda meje ngaqë kisha kaluar një jetë të tërë me libra si *Middlemarch*—aludimi im se ky mendim ishte një mendim që e ndaja me një grua brilante, të vdekur prej kohësh. Mbi të gjitha, Grok-u nuk do të mund të ma jepte kurrë atë që bën Eliot-i në momentin menjëherë pasi motra e Fred-it i ankohet me qortim për zakonet e tij të leximit: “Fred i afroi dorën e së ëmës te buzët, por nuk tha asgjë”. Ai gjest krejtësisht i vërtetë i pranimit të heshtur, me bezdinë e tij të mposhtur nga mëshira familjare e dashurisë së zakonshme—kjo është ajo lloj gjëje që ofrojnë romanet e që përmbledhjet nuk munden.

Këtë u them studentëve të mi kur përpigëm t’u shpjegoj pse nuk mund t’ua delegojnë kujtimet apo detyrat e tyre një programi të fuqizuar të tekstit parashikues. Ata do të nxiten dhe tundohen vazhdimisht ta bëjnë këtë gjë—OpenAI tashmë u ofron studentëve zbritje të ndryshme dhe promovime falas për shërbimin e saj premium, duke shpresuar qartësisht të inkurajojë zakonet e mbështetjes te ChatGPT për lloj-lloj gjërash. Do t’i takojë brezit të ri të vendosë se cilat detyra dëshiron t’ua delegojë makinerive. Por nëse zgjedhin leximin, do ta kenë mashtuar veten në mënyrë të tmerrshme. Arti i të përthithurit të letërsisë është një nga artet e mëdha liberale—është një akt lirie i pastër, diçka që e bën pa asnjë arsye tjetër, veçse për ta bërë.

Mund të jetë një art në zhdukje. Tani ekziston një zhanër i tërë postimesh në rrjetet sociale se si të nxjerrësh vlerën nga librat pa i lexuar ato. “Të lexosh libra tani është humbje kohe”, shkroi Davie Fogarty, biografia e të cilit në X i atribuon atij “850 milionë dollarë shitje në Shopify”. Librat janë të vjetruar, mendon Fogarty, sepse “modelet arsyetuese të AI-së mund të distilojnë idetë kryesore dhe të të tregojnë saktësisht se si t’i zbatosh ato bazuar në gjithçka që dinë për ty”. Dhe ai ka plotësisht të drejtë për atë llojin e parë të leximit—atë që kërkohet librat e vetëndihmës dhe manualët e strategjisë së biznesit, atë lloj që i trajton librat thjesht si një paketim i volitshëm për “pika veprimi”, të cilat mund të ishin po aq mirë edhe slajde në një prezantim PowerPoint. Ka pasur gjithmonë një industri të vogël përmbledhjesh dhe versionesh të shkurtuara, si SparkNotes dhe CliffsNotes, për ta shkurtuar atë lloj leximi. Tani ka aplikacione si Blinkist, të cilat bëjnë të njëjtën gjë duke përdorur AI.

Por lloji tjetër i leximit, ai lloj që konsiston në të parit e Fred-it teksa afron në heshtje dorën e së ëmës te buzët, nuk mund të përmbledhet. Ç’kuptim do të kishte? Nëse ChatGPT do të mund të të tregonte se çfarë shije ka një vakt, a nuk do ta ndieje nevojën për ta ngrënë?

Është e lehtë (dhe argëtuese) të imagjinosh se ç’lloj “idesh kyçe” mund të nxirrte një chatbot nga klasikët për të mirën e një manjati të Shopify. “*Iliada*: Përdor asetet e tua në punë.” “*Sir Gawain and the Green Knight*”. E pyeta Grok-un



për *Vëllezërit Karamazov* dhe më tha: “Të gjithë jemi një lëmsh kontradiktash”. Dhe ashtu jemi vërtet. Pse Dostojevski nuk tha thjesht këtë?

Ja pse. Relativisht herët në roman, protagonisti Alosha dëgjon një histori në të cilën një plakë e keqe vdes dhe zgjohet në ferr. Engjëlli i saj mbrojtës i përgjërohet Zotit në emër të saj dhe rrëfen të vetmen vepër të mirë që ajo kishte bërë ndonjëherë në jetë: i kishte dhënë një qepë një lypësi të uritur. Engjëlli e merr atë qepë dhe ia zgjat mëkatares së mjerë, duke i thënë të kapet pas saj në mënyrë që të mund të tërhiqet lart drejt parajsës. Dhe mu në atë çast, çdo shpirt në liqenin e zjarrit kapet pas thembrave të saj dhe fillon të ngrihet lart bashkë me të. “Por ajo ishte një grua shumë e ligë dhe nisi t’i shkelmojë ata. ‘Mua do të më tërheqin, jo juve. Është qepa ime, jo e juaja.’ Sapo e tha këtë, qepa u këput”.

Ndoshta kushdo që merr mundimin t’ia japë këtë histori ChatGPT-së mund të gjejë një moral të vogël e të gatshëm aty: Mos u bëj egoist, mendo për të tjerët, ushqe të varfrit. Por në kapitullin tjetër, Alosha sheh në ëndërr mentorin e tij, At Zosimën e shenjtë, për të cilin e ka marrë malli tmerrësisht, teksa gëzon në festën e dasmës në parajsë dhe thotë: “I dhashë një qepë një lypësi, ndaj edhe unë jam këtu. Dhe shumë këtu kanë dhënë vetëm nga një qepë secili—vetëm një qepë të vogël... Cilat janë gjitha veprat tona?” Dhe si mund ta përmbledh kuptimin e atij pasazhi, përveçse duke thënë se kur e lexova për herë të parë e lashë romanin mënjanë dhe qava, duke ndier papritur se edhe unë, ndoshta, mund të shpëtohesha?


Siç u them studentëve të mi, askush nuk mund të të detyrojë ta bësh atë lloj leximi. Nëse po largohemi nga epoka e Gutenbergut e leximit masiv, nga bota e Dostojevskit dhe Eliotit për të hyrë në një botë ku librat bëhen sërish preokupimi i një pakice të zgjedhur, unë nuk mund ta ndaloj këtë gjë. Por ne do të jemi më të varfër për shkak të kësaj, jetët tona do të jenë pak më të sheshta dhe më të zbrazëta. Pra, për çfarë do të ketë shërbyer në fund të fundit gjithë kjo efikasitet dhe optimizim? Nëse ndalojmë së e pari kuptimin e leximit, çfarë do të bëjmë me gjithë atë kohë të liruar nga pajisjet tona?

Do të ishte gjë tjetër sikur librat do të zëvendësoheshin sepse do të kishim gjetur një mënyrë akoma më të thellë për të takuar mendje të tjera dhe kohë të tjera, ose sikur po ktheheshim në kohën e shëtitjeve të gjata në agora dhe debateve mbi natyrën e genies. Por një përdorues në X shpjegoi se si e përdor AI-në për të “nxjerrë... informacionin” nga një libër, leximi i të cilit normalisht do të kërkonte një orë—“dhe pastaj pi kafe për 58 minuta”. Nëse doni një tablo të së ardhmes sonë pa libra, imagjinoni një varg influencersash që ngulin sytë nga dritaret e apartamenteve të tyre të larta, me jetën e tyre të brendshme të zëruar në një boshllëk total, duke gjerbur kafe pafundësisht.

“Nga çfarë po përpiqesh / të çlirohesh?” pyet poeti Joseph Fasano në një poezi drejtuar një “Studenti që përdori AI-në për të shkruar një ese”. A mos vallë nga “të jetuarit? Nga kjo detyrë / e mrekullueshme?” Por “dashuria është për ata që e duan punën”. Lloji i leximit që e ruan vlerën e tij në epokën e AI-së është ai lloj që nuk ka Kthim Investimi (ROI) të matshëm, nuk ka metrika të shkallëzueshme, asnjë lloj vlere të menjëhershme tregu. Është si jeta, në kuptimin që thelbi i saj është vetë historia, dhe e vetmja mënyrë për ta “kuptuar” atë është të rrosh brenda saj dhe ta lejosh të të ndryshojë.

Me fjalë të tjera, nuk ka asgjë për të ofruar, përveç bashkimit të shpirtit me shpirtin. Por nëse nuk mund ta vlerësojmë këtë, ç’vlerë ka çdo gjë tjetër?

Karikaturë nga Arben Mexi



BANANA YOSHIMOTO



Parandjenjë e trishtë

Roman